

1 E martë, 5 nëntor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
6 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju
12 faleminderit.

13 Për procesverbal, të katër të akuzuarit janë të pranishëm
14 fizikisht në sallën e gjyqit.

15 Ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

16 Do vazhdojmë sot me dëshminë e Dëshmitarin e Prokurorisë
17 W01453.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
20 uleni.

21 Vërej për procesverbal që Avokati Kujdestar i dëshmitarit
22 është i pranishëm në sallën e gjyqit.

23 Mirëmëngjes, Dëshmitar.

24 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,

1 z. Buja.

2 Dhe mirëmëngjesi Avokat.

3 Dëshmitar, ju lutem përgjigjuni qartë me fjali të
4 shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje lirisht kërkoni që
5 pyetja të përsëritet dhe do ta sqarojnë.

6 Gjithashtu, mos harroni të na thoni ku i bazoni ju
7 faktet, rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë pyetje.

8 Flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara
9 se të përgjigjeni dhe flisni ngadalë për përkthyesit.

10 Nëse keni nevojë për pushim, na thoni dhe do të bëjmë
11 organizimin përkatës.

12 Je ende nën betim për të thënë të vërtetën. Këtë e thatë
13 vetë përmes betimit solemn. Edhe ju rikujtoj se vlejné ende
14 garancitë që ju ka dhënë dje Trupi Gjykues dhe në rast se
15 refuzoni të jepni dëshmi mund të merret masë ndaj jush me
16 gjobë.

17 DËSHMITARI: SHUKRI BUJA [Vijon]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të
19 vijojmë e pyetjet e Prokurorit. Dëgjojini me vëmendje.

20 Z. Pace, fjala është për ju.

21 Pyetje nga z. Pace: [Vazhdim]

22 Z. PACE: [Përkthim]

23 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Përpara se të përfundonim seancën
24 dje - e kam fjalën për faqen 1141, rreshti 16-18 - ju thatë se
25 nuk ju kujtohet të keni pasur ndonjë thirrje telefonike me

1 Hashim Thaçin në 1998. Dhe në faqen 142, rreshti 10, faqja
2 143, rreshti 1, keni thënë që në prill ose në maj të 1998, nuk
3 e keni njohur Shtabin e Përgjithshëm, kështu që nuk kishte
4 sesi t'ju jepnin ata urdhër ju apo ndonjë detyrë për t'u
5 kujdesur për furnizimin me armatime.

6 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me lejen tuaj
7 tani do të doja t'i tregoja një dokument dëshmitarit në bazë
8 të rregullës 143(2)(c).

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

10 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem vendosni në ekran materialin
11 IT-03-66 T3761-T3827 të Paredaktuar *Interp* dhe do të lexoj
12 rreshtin 6 deri në 16, në faqen 14, përfshirë dhe korrigjimin
13 në faqen 15. Ju lutem të shfaqet përbri edhe shqipja me numër
14 IT-03-66 4 mars 2005-TR-AT Pjesa 1 E Paredaktuar, faqe 14,
15 rreshtat 3 deri në 20.

16 PY. Dëshmitar, në ekran do të shihni një pjesë të dëshmisë
17 suaj të 4 marsit 2005 në çështjen Limaj në TPNJ. Do t'ju lexoj
18 një pjesë dhe pastaj do t'ju bëj një pyetje.

19 "PY. Dhe një herë, do t'ju pyes për të njëjtën, do t'ju
20 bëj të njëjtën pyetje që ju kam bërë edhe më parë kur po
21 flisnim për marsin dhe prillin. Tani po flasim për majin dhe
22 po flasim për komunat të tjera. A keni bashkërenduar ju
23 veprimtaritë tuaj organizative në këto komuna me këta të
24 tjerë, me këta të tjerë me Fatmir Limajn në Kleçkë?

25 "PË. Bashkërendimi i veprimtarisë nuk ka qenë deri në

1 maj, por në maj, unë kam qenë, e kam thënë edhe më herët dje
2 në deklaratë, pas kontaktit me Hashim Thaçin përmes telefonit
3 kam marrë përsipër rregullimin e vijës së armatimit, do të
4 thotë, të depërtimit të armatimit nga Shqipëria në Kosovë. Që
5 ishte logjistika që ekzistonte apo siç thuhej që ekzistonte në
6 Shqipëri. Ndërsa unë kam marrë përsipër të koordinoj.”

7 Dhe pastaj thotë:

8 “Bëhet fjalë për vijën e armatimeve dhe depërtimit të
9 armatimeve. Ma kishte kërkuar këtë Shtabi i Përgjithshëm, më
10 kishte ngarkuar Shtabi i Përgjithshëm dhe më është përcjellë
11 nga Hashim Thaçi.”

12 Dëshmitar, kjo që keni thënë ju a është e saktë?

13 PË. Më falni. Realisht e thamë më lart se e kam marrë për
14 detyrë, do të thotë, e kam marrë unë për detyrë. Ndërsa në
15 telefon që kam mund të bisedoj që, s’po më kujtohet, kam mujt
16 me e konfirmu z. Thaçi, se në rregull është. Po nuk ka qenë
17 urdhër.

18 PY. Kjo që lexova unë në dëshminë tuaj, që ta sqarojmë, ju
19 keni thënë:

20 “... kjo është detyrë që më është ngarkuat nga Shtabi i
21 Përgjithshëm, që më është përcjellë nga Hashim Thaçi.”

22 Tani, ju lutem, i thoni Trupit Gjykses deklarata që keni
23 dhënë nën betim këtu a është e saktë apo jo?

24 PË. Po nuk mund ta konfirmoj se është e saktë sepse rrethanat
25 në të cilën e kam dhënë këtë dëshmi edhe realisht gjithmonë

1 jemi thirr Shtabi i Përgjithshëm, po unë nuk e kam ditë në maj
2 nëse është Hashim Thaçi anëtar i Shtabit të Përgjithshëm apo
3 jo.

4 PY. Dëshmitar, po atëherë pse në çështjen Limaj keni thënë që
5 këtë detyrë ua ka ngarkuar Shtabi i Përgjithshëm dhe që ta ka
6 përcjellë Hashim Thaçi?

7 PË. Por ne kemi supozuar, e kam thënë edhe në herët, kemi
8 supozuar se kush mund të jetë anëtar i Shtabit të
9 Përgjithshëm. Dhe nuk e kemi dit. Por ne kemi supozu që mund
10 të jetë Hashim Thaçi apo dikush tjetër. Se kur e kam thënë
11 këtë e kam pasur në aspektin e supozimit se ka mund të jetë
12 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm.

13 PY. Fokusohemi tek fjalia e fundit, keni thënë më është
14 përcjellë detyra nga Hashim Thaçi, nuk ka rëndësi a e keni
15 ditur ju çfarë roli ka pasu ai. Po ju kujtohet që ta këtë
16 përcjellë Hashim Thaçi këtë detyrë?

17 PË. Nuk më kujtohet saktë, do të thotë, a ka qenë Hashim
18 Thaçi apo vëllai im, Agush Buja, sepse përmes tina kemi fol në
19 telefon.

20 PY. Çfarë deshët të thonit me këtë që ishte nëpërmjet tij kur
21 folët në telefon?

22 PË. Pse telefonin ku kam nejt unë në Mollopolc, do të thotë,
23 ke me mujt me kontakti vetëm përmes telefonit të Agush Bujës,
24 i cili ka thirr në fshatin Mollopolc.

25 PY. Pra, keni përdorur telefonin e Agush Bujës për të

1 kontaktuar me Hashim Thaçin në maj të 1998?

2 PË. Kam përdorur telefonin e shtëpisë ku kam nejt aty në
3 Mollopolc, të Ahmet Mujotës, për të kontaktuar me Zvicrën ku
4 ka qenë vëllau im Agush Buja, do të thotë, kur ka qenë
5 mundësia kontaktuese e imja me Zvicrën.

6 PY. S'e kam fjalën për Zvicrën. E kam fjalën konkretisht për
7 Hashim Thaçin sepse vetë në këtë dëshmi keni thënë që keni
8 kontaktuar me Hashim Thaçin përmes telefonit. A ju kujtohet ky
9 kontakt?

10 PË. Për momentin s'është tuj mu kujtu. Po unë kam kontaktu
11 edhe me vëllaun edhe me Hashim Thaçin kur ka qenë në Zvicër
12 edhe me Azem Sylën, të cilin në atë kohë kam supozu se është
13 komandanti i përgjithshëm.

14 Z. PACE: [Përkthim] Qëndrojmë në të njëjtin dokument, por
15 kalojmë në faqen 16, rreshti 18 dhe më pas në faqen 17, në
16 rreshtin 16, përfshirë dhe korrigjimin që është bërë në faqen
17 18, në shqip në të njëjtin dokument, kalojmë në faqen 16,
18 rreshti 1 dhe unë do lexoj deri në faqen 17, rreshti 7.

19 PY. Dëshmitar, kjo është e njëjta dëshmi më 4 mars 2005 në
20 çështjen Limaj. Përsëri do të lexoj një pjesë dhe më pas do
21 t'ju bëj pyetjet përkatëse.

22 "PY. Keni dhënë dëshmi dje, sikur ju dëshmuat dje se kur
23 i dhanë detyrë, kur Hashim Thaçi ju dha detyrën në mars të
24 1998 në Drenicë, pra, që ju do kishit në përgjegjësi Lipjanin
25 dhe Shtimën. A ka ardhur një moment më vonë kur detyra juaj u

1 shtua dhe Kaçanik e Ferizaj u përfshinë në përgjegjësinë tuaj,
2 a gjykon se në një moment të caktuar se detyra juaj ishte më e
3 madhe e do të përfshinte dhe Kaçanikun dhe Ferizajn?

4 "PË. Po, shtetimi i detyrës ishte që, do të thotë, kjo
5 ishte detyrë specifike për të koordinuar veprimin e njësitit
6 të Kaçanikut, Ferizajt, Shtimes e Lipjanit për të krijuar
7 vijën e furnizimit ne armë. Do të thotë, vetë kjo ishte një
8 shtim i përgjegjësisë.

9 "PY. Kur mësuat për këtë përgjegjësi shtesë që ju dhanë?

10 "PË. Ju thashë më herët ka qenë në maj gjatë vizitës
11 sime në Kaçanik.

12 "PY. A e morët përsipër këtë përgjegjësi vetë ju apo ua
13 dhanë këtë në përgjegjësi?

14 "PË. Po, sigurisht, pa pasur dëshirë që ta marr unë këtë
15 përgjegjësi, nuk ka mundur të më jepej. Por unë isha i gatshëm
16 të veproja sipas urdhëresave të Shtabit të Përgjithshëm që
17 kishte filluar t'i lëshonte më vonë.

18 "PY. Dhe kush ua komunikoi, kush ju tha se do të kishit
19 këtë përgjegjësi shtesë?

20 "PË. Paksa i çuditshëm insistimi. Unë thashë shumë qartë
21 që komunikimi u bë me Hashim Thaçin përmes telefonit për këtë
22 punë shtesë.

23 "PY. Në rregull. E kuptoj tani. Dhe se komunikimi -- në
24 rregull, mendoj se e kuptova. Ky komunikim ka ndodhur në maj
25 të 1998-s kur ju keni qenë në Kaçanik ose -- më falni, kur

1 keni qenë ju në Kaçanik?

2 "PË. Kam qenë në maj."

3 Dëshmitar, dëshmia që keni dhënë dhe që sapo u lexuam dhe
4 që e keni dhënë nën betim, a është e saktë?

5 PË. Po, e saktë është. Realisht unë e kam koordinu veprimet
6 në Shtime, Ferizaj, Kaçanik. Dhe në atë kohë e kemi marrë si
7 urdhëresa të Shtabit të Përgjithshëm edhe pse e nuk kanë qenë
8 urdhëresa. Kanë qenë komunikime normale si dy shokë.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Prokuror, më duket sikur
10 ka një mospërputhje mes transkriptit që kemi ne në ekran dhe
11 asaj që po lexoni ju. Në ekran thuhet që:

12 "Unë isha i gatshëm të punoja sipas urdhrave që më kishte
13 lëshuar Shtabi i Përgjithshëm."

14 Z. PACE: [Përkthim] Po ta shihni tek anglishtja me të
15 verdhë do të thotë që është bërë korrigjimi i transkriptit,
16 prandaj unë do të lexoj dhe faqen tjetër. Ky është versioni i
17 korrigjuar i asaj fjalie që patë ju me të verdhë. Para se të
18 fillonte dëshmia ne kemi ngarkuar shumë dokumente që do
19 përdreshin për këtë dëshmi dhe menduam që më e thjeshtë ishte
20 që t'i nënvijëzonim me të verdhë fjalitë dhe më pas të kishim
21 një faqe veçmasi ku reflektonim korrigjimin që i është bërë
22 transkriptit.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] E kuptova. Faleminderit.

24 Z. PACE: [Përkthim]

25 PY. Dëshmitar, pra, keni thënë, keni folur për komunikimin që

1 keni marrë për këtë detyrë. A është e saktë kjo që keni thënë
2 këtu, a mund të na e konfirmoni që këtë mesazh ua ka
3 përcjellë, pra, këtë porosi ua ka përcjellë Hashim Thaçi?
4 PË. I nderuar Prokuror, unë e kam sqaruar edhe në atë gjykim,
5 edhe siç shihet edhe në transkript, se unë i kam marrë me
6 dëshirë detyrat e mia. Sepse askush s'ka mujt me më detyru me
7 i marrë detyrat. Dhe atë e them shumë qartë dhe këtu unë kam
8 fillu me bë bartjen e armatimit dhe në komunikim, sigurisht,
9 me anëtarët që kanë supozu të Shtabit të Përgjithshëm, ju kam
10 tregu se jam duke bërë bartjen e furnizimit dhe e kam marrë me
11 dëshirë këtë detyrë. Ju kam thënë që po e bëj bartjen, po i
12 siguroj këto vija të furnizimit sepse, nëse nuk gaboj, në maj
13 kanë filluar luftimet në Llapushnik.

14 PY. Dëshmitar, në përgjigjen e 2005 ke thënë:

15 "Kam qenë i qartë kur ju thashë që komunikimin e kam
16 pasur me Hashim Thaçi përmes telefonit për këtë punë shtesë."

17 A është e saktë, apo jo, kjo pjesë?

18 PË. Po, nuk mund ta kujtoj a e kam pas komunikim. Po këtu e
19 kam thënë që kam komunikuar me Hashim Thaçi. Dhe sigurisht që
20 kam komunikuar me Hashim Thaçin sepse komunikimet tona kanë qenë
21 të vazhdueshme.

22 PY. Atëherë mos keni dhënë dëshmi të pavërtetë në këtë rast?

23 PË. Unë po e përshkruaj si ka qenë rasti. Do të thotë dhe unë
24 e i kam dhënë një dëshmi e cila kam qenë shumë -- në atë kohë
25 derisa kam mujt me e kujtu edhe me e dit. Keni parasysh që

1 rrethanat në atë kohë kanë qenë shumë të rënda dhe zhvillimet
2 në atë kohë kanë qenë shumë ditore, të shpejta. Dhe është
3 shumë vështirë edhe sot me u kujtu dhe atëherë me i kujtu çdo
4 imtësi rreth organizimit.

5 PY. Dëshmitar, me gjithë respektin, nuk ju përgjigjët pyetjes
6 sime. Pyetja ime ishte kjo: Në 2005, kur keni dhënë dëshmi nën
7 betim në çështjen Limaj, i takon që informacioni që keni dhënë
8 nuk ka qenë i vërtetë?

9 PË. Nuk e them që s'ka qenë i vërtetë, sepse e kam dhënë nën
10 betim dhe ato që më janë kujtuar dhe aq sa i kam dit, do të
11 thotë, dhe i kam dhënë në dëshmi.

12 Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë në një ditë tjetër po të së
13 njëjtës dëshmi, është 7 marsi 2005. Dhe numri i referencën
14 është IT-03-66 T3915-T4001_Corr Interp dhe do lexoj nga faqja
15 72, rreshtat 7 deri në 9. Në shqip, është materiali IT-03-66 8
16 mars 2005 Shukri Buja Pjesa 2-TR-AT, faqja 24, rreshtat 11
17 deri në 15.

18 PY. Dëshmitar, kjo është një faqe e dëshmisë suaj po për të
19 njëjtën lëndë gjyqësore dhe do t'ju lexoj një pjesë të
20 përgjigjes suaj dhe pastaj do t'ju bëj pyetje.

21 "PË. Mua nuk më kujtohet në qershor nëse kam, do të
22 thotë, nëse kam kontaktuar me Shtabin e Përgjithshëm edhe pse
23 e di që në maj, do të thotë, kam kontaktuar me anëtarin e
24 Shtabit të Përgjithshëm që e kam kuptuar më vonë, Hashim Thaçi
25 që ishte anëtarë i Shtabit të Përgjithshëm."

1 A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

2 PË. Po, për Hashim Thaçin kam marrë vesh më vonë që është
3 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm.

4 PY. Por për faktin që e keni kontaktuar në maj a është kjo e
5 vërtetë?

6 PË. Po mesa më kujtohet, kam kontaktuar. Por realisht sesi,
7 çfarë kemi biseduar dhe është kohë shumë, shumë e gjatë.

8 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekрани.

9 PY. Dëshmitar, e njihni Hajrush Kurtaj?

10 PË. Po.

11 PY. Ka qenë anëtar i UÇK-së?

12 PË. Po.

13 PY. Çfarë roli ka pasur në UÇK?

14 PË. Ka qenë zëvendëskomandant i Brigadës 162.

15 PY. A ju kujtohet kur e ka marrë këtë rol a pozitë?

16 PË. Nuk më kujtohet saktë, po sigurisht ka qenë fundi i 1998.

17 Z. PACE: [Përkthim] Do të doja të shfaqej në ekran
18 materiali 036622-036837, faqja e parë dhe përbri shqipen me
19 numër 077039-077258, sërish dhe në këtë rast faqja e parë.

20 PY. Dëshmitar, në ekran është ballina e një dokumenti në
21 shqip e në të djathtë në anglisht. E njihni dokumentin që
22 shihni në shqip në të majtën e ekranit?

23 PË. Po.

24 Z. PACE: [Përkthim] Në të njëjtin material shkojmë në
25 faqen që mban numrin 36624 në anglisht dhe numër 077041 në

1 shqip.

2 PY. Në këtë faqe shohim dhe emrin tuaj si redaktor, "Shukri
3 Buja", domethënë, recensues më saktë, është e saktë kjo?

4 PË. Po.

5 PY. Si recensues i këtij libri, ma merr mendja ju e keni
6 lexuar përpara se të botohej, apo jo?

7 PË. Në fakt, s'e kam lexuar.

8 PY. Asnjëherë s'e keni lexuar?

9 PË. Pasi që është botu. E kam lexu shumë vonë. Por Hajrush
10 Kurtajt ka kërku që të jetë edhe emri im meqë është dhe
11 Profesor Dr. Selim Daci që të jetë emri im si recensent dhe
12 unë e kam respektu këtë kërkesë të tij.

13 PY. Kur thoni që e keni lexuar më pas librin, Hajrush Kurtajt
14 i bëre ndonjë koment lidhur me përmbajtjen e këtij libri?

15 PË. Po, i kam bërë koment.

16 PY. Ju kujtohet çfarë komenti?

17 PË. Nuk e di saktë se s'më kujtohet saktë se çfarë komenti,
18 po e di që kam bërë koment.

19 PY. Pra, po thoni që i keni dhënë komentet pasi ishte botuar
20 libri, kështu?

21 PË. I kam dhënë komente për librin që ta marrë si koment
22 pjesë e këtij libri sepse ashtu ka kërkuar vetë autori.

23 PY. Pra, komentet i keni dhënë përpara se të botohej libri,
24 apo jo?

25 PË. Po, sepse për t'u botuar ai koment duhej përpara t'ia

1 jepja për librin.

2 Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë në anglisht tek faqja 036631,
3 në shqip 0770148.

4 PY. Dëshmitar, këto janë faqe të të njëjtit libër. Shohim
5 titullin: "Disa fjalë për madhësinë e UÇK-së të ZON".

6 Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër, ju lutem.

7 PY. Këtu në fund thuhet se e keni shkruar ju, "Shukri Buja,
8 gjeneral-major". A ju kujtohet ju që të keni bërë komente, një
9 parathënie mbase prej një faqe e gjysëm siç po e shohim?

10 PË. Po.

11 Z. PACE: [Përkthim] Kthehemi tek faqja pararendëse.

12 PY. Dëshmitar, lexoni përmbajtjen dhe do të shihni se jep
13 disa, në këtë faqe jepen disa hollësi të librit, apo jo?

14 PË. Po, i nderuar.

15 Z. PACE: [Përkthim] Në anglisht shkojmë në faqen, ju
16 lutem, 036445. Në shqip do shkojmë në faqen 077063 dhe do
17 shohim paragrafin e parë.

18 PY. Do t'ju lexoj një pjesë, pastaj do t'ju bëj një pyetje,
19 Dëshmitar.

20 "Me urdhër të Shtabit të UÇK-së, Shukri Buja rikthehet në
21 Kaçanik për të komunikuar vendimin e shtabit për emërimin e
22 Agim Bajramit komandant për njësitin e Kaçanikut."

23 Ka një poshtëshënim këtu, numër 21.

24 Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë në fund që të lexojmë çfarë
25 thotë.

1 PY. Dhe këtu shohim që thotë intervistë me gjeneral major
2 Shukri Buja, 23/5/2007, Lipjan. Dëshmitar, a do të thotë kjo
3 që në 2007 këtë informacion ia keni dhënë ju autorit të
4 librit?

5 PË. Nuk më kujtohet. Po e di se jam intervistuar nga autori i
6 librit sepse ka qenë në magjistraturë apo në shkallën e tretë
7 të studimeve të tij për të magjistru me këtë temë.

8 PY. Shohim fjalinë edhe një herë thotë:

9 "Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së Shukri
10 Buja rikthehet në Kaçanik për të komunikuar vendimin e shtabit
11 për emërimin e Agim Bajramit, komandant për njësitin e
12 Kaçanikut."

13 Ju kujtohet të keni shkuar sërish në Kaçanik për ta
14 komunikuar këtë vendim?

15 PË. Kam shkuar dhe për punë tjera, po edhe për caktimin e
16 Agim Bajramit si komandant i njësitit.

17 PY. Këtu thuhet që vendimi është i Shtabit të Përgjithshëm që
18 Agim Bajrami të caktohet si komandant i njësitit. A mund të na
19 thoni që SHP-ja kujt i referohet këtu kur thuhet që SHP-ja e
20 ka nxjerrë këtë urdhër?

21 PË. Po kështu e kemi thënë në atë kohë. Dhe kur kemi emëru
22 dikën i kemi thënë je i emëru nga Shtabi i Përgjithshëm në
23 mënyrë që të kemi hapësirën që të mos keqinterpretohen këto
24 vendime, po në fakt, Agim Bajramin e kam përcaktu si komandant
25 të njësitit gueril atje dhe jam thirr në emër të Shtabit të

1 Përgjithshëm.

2 PY. Kush të ka thirr ty në emër të Shtabit të Përgjithshëm?

3 PË. Nuk më kujtohet koha, po e di që kam komunikuar me Azem

4 Sylën edhe, në atë kohë s'e kemi ditur se është komandant i

5 përgjithshëm. Po unë në kthimin në Kaçanik, realisht i kam

6 thënë para njësitit a para tre-katër personave të njësitit,

7 Agim Bajrami që je i përcaktuar nga Shtabi i Përgjithshëm për

8 ta udhëheqë njësitin. Në fakt nuk ka pas ndonjë emërim me

9 shkrim, nuk ka pas ndonjë urdhër, po ka qenë komunikim.

10 PY. Mendoj që thate që nuk ju kujtohet koha, po afërsisht a

11 ju kujtohet në çfarë muaji ose në çfarë viti ka ndodhur kjo,

12 domethënë, kur ia keni komunikuar këtë vendim për emërimin e

13 Agim Bajramit si komandant?

14 PË. Kjo mund të jetë në fund të qershorit ose në korrik,

15 sepse herën e parë duhet të kem qenë në prill-maj ndërsa në

16 herën e dytë duhet të jetë në korrik.

17 PY. A mund të na e thoni vitin kur?

18 PË. Vitin 1998.

19 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pjesa e më e

20 madhe e fletëve që unë i tregova janë pranuar si prova

21 gjyqësore, megjithatë kërkoj që të pranohen provat në faqet

22 përkatëse të librit 036631 deri në 32 në versionin në anglisht

23 që përkojnë me 077048-49 në shqip. Dhe ato duhet që të shtohen

24 në provën P01015 që është dokument i cili është pranuar. Për

25 të qenë të qarta, dy faqet që kërkoj që të pranohen përfshijnë

1 komentet hyrëse nga dëshmitari.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka komente?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

4 PËRKTHYESJA: Ekipet e tjera: Nuk kemi kundërshtim.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Fletët që u
6 përcaktuan nga Prokurori do t'i shtohen provës ekzistuese
7 gjyqësore P01015.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
9 këto dy faqe në shqip dhe në anglisht do t'i shtohen provës
10 P01015. Aktualisht libri është klasifikuar si konfidencial.
11 Duhet të ruajmë të njëjtin klasifikim?

12 Z. PACE: [Përkthim] Duhet të riklasifikohet si publik.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
14 riklasifikoheni si publik.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

16 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim nga ekrani dokumentin.

17 PY. Dëshmitar, a jeni takuar me Jakup Krasniqin në vitin
18 1998?

19 PË. Po.

20 PY. Kur në 1998 jeni takuar me të për herë të parë?

21 PË. Nuk e di saktë, po sigurisht ka qenë muaji korrik,
22 qershor, korrik.

23 PY. A ju kujtohet se ku është zhvilluar ky takim në çfarë
24 vendi?

25 PË. Saktë nuk më kujtohet po sigurisht në rrethinat e

1 Kleçkës.

2 PY. Me çfarë rasti ose për çfarë arsye u takuat ju të dy
3 bashkë?

4 PË. Për herë të parë jam taku gjatë kohës kur e ka dhënë
5 intervistën e parë si zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të
6 Kosovës.

7 PY. Çfarë ju tha ai juve gjatë asaj interviste?

8 PË. Po ai kishte konferencë për gazetarët dhe realisht jemi
9 takuar në atë kohë që të jemi, të jemi krah tina.

10 PY. Kush ju kërkoi ju dhe personave të tjerë që të merrnit
11 pjesë në atë intervistë përkrah tina?

12 PË. Realisht unë kam shku aty. Nuk më ka kërkë kërrkush. Po
13 kam qenë prezent. Edhe ka pas nevojë që dikush t'i rrijë në
14 krah Jakup Krasniqit gjatë intervistimit dhe ne kemi nejt krah
15 tij.

16 PY. A po ju kuptoj drejt që ju keni qenë i pranishëm
17 fizikisht vetë, pra, keni qenë i pranishëm së bashku me Jakup
18 Krasniqin gjatë intervistës së tij të parë, këtë po thoni,
19 Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Gjatë asaj kohe ku keni marrë pjesë edhe jeni paraqitë
22 bashkë me të në intervistën e parë a keni biseduar ndonjë gjë
23 lidhur me organizimin e UÇK-së me Jakup Krasniqin, Dëshmitar?

24 PË. Realisht nuk më kujtohet saktë, po sigurisht kanë bisedu
25 meqë ishte personi i parë publik nga Shtabi i Përgjithshëm e

1 kam bisedu për rrjedhat e organizimeve të njësiteve guerile,
2 po nuk e kujtoj që e kam -- a e kam bisedu a jo.

3 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se më
4 lejoni, dëshiroj që t'i tregoj një pjesë të dëshmisë së
5 mëparshme të dëshmitarit sipas rregullës 143(2)(b) dhe (c).

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
7 vazhdoni.

8 Z. PACE: [Përkthim] Për këtë arsye kërkoj që të paraqitet
9 në ekran dokumenti IT-03-66 T6761_Interpretim i korrigjuar dhe
10 në këtë gamë faqesh dua që të paraqitet faqja 25, rreshtat 10
11 deri në faqen 26, rreshti 15 në shqip dhe në versionin në
12 anglisht ky dokument mban numrin e identifikimit IT-03-66 data
13 4 mars 2005-TR-AT Pjesa 1 E Paredaktuar, faqja 25, rreshti 2
14 deri në faqen 26, rreshti 19.

15 PY. Dëshmitar, dhe një herë kjo është një prej faqeve të
16 dëshmisë që keni dhënë në mars të vitit 2005 në gjykimin
17 kundër Limajt. Do t'ju lexoj një pjesë pastaj do ju bëj një
18 pyetje lidhur të.

19 "PË. Pas kthimit tim në Krojmir, veç ndodh ajo që ne e
20 pritshim prej shumë kohësh, ndodh dalja publike e zëdhënësit
21 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i cili jep intervistën e
22 parë. Kjo përveç gëzimit e haresë na shtynte që të jemi shumë
23 më të kujdesshëm dhe të kemi mundësinë për të konsultuar me
24 Shtabin e Përgjithshëm përmes Jakup Krasniqit, i cili ishte
25 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm publik, do të thotë, kjo ka

1 ndodhur diku nga mesi i qershorit. Unë normalisht atë kohë kam
2 qenë në Krojmir, po pas daljes së Jakup Krasniqit unë kam
3 insistuar që të takoj zëdhënësin e Ushtrisë Çlirimtare të
4 Kosovës.

5 "PY. A e takuat atë?

6 "PË. Po. Jam takuar pas datës 15 apo 16. Kjo datë më
7 kujtohet për shkak të angazhimit të vëllait tim, Ramë Bujës,
8 në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Unë jam takuar me
9 Jakup Krasniqin në Kleçkë, ku kishte qenë për intervistë aty.
10 Dhe kemi biseduar me Jakup Krasniqin për mundësitë e
11 organizimit më të mirë në pjesën ku unë kisha kontakte apo
12 edhe lëvizje.

13 "Thjesht, nga Jakup Krasniqi në atë kohë jam njoftuar se
14 ka filluar përcaktimi i nënzonave të UÇK-së ku ato ditë ishin
15 emëruar një apo dy komandantë nënzonash. Jam njoftuar po ashtu
16 se po mendohej që të organizohej dhe të emërohej një komandant
17 i nënzonës, emri i të cilit -- emri i së cilës nuk dihej. Në
18 atëkohë dilema ishte komuna e Kaçanikut. Dhe ky informacion
19 përveçse më gëzoi sigurisht që më dha dhe motiv për të punuar
20 shumë më shumë dhe në atë periudhë Jakup Krasniqi, po atë ditë
21 Jakup Krasniqi kishte një intervistim nga gazetarët. Dhe unë
22 bashkë me Jakup Krasniqin do të dalim në atë intervistë.
23 Intervistën, kuptohet, e ka dhënë zëdhënësi i Ushtrisë
24 Çlirimtare të Kosovës ndërsa unë po qëndroja pranë.

25 "PY. Ju thatë që kjo ka ndodhur në 15 apo 16. Bëhet

1 fjalë për datën 15, 16 qershor të 1998?

2 "PË. Unë thashë që kjo ka ndodhur pas 15, 16 qershorit.
3 Këtë datë më kujtohet për shkak të angazhimit të vëllait tim.
4 Që mesa më kujtohet, më 16 qershor në UÇK u angazhua me armë
5 dhe kjo ka ndodhur pas kësaj date. Nuk e di saktë sesa ka qenë
6 data, por data e përafërt është rreth 20, 20 qershorit. Po
7 them është e përafërt se nuk e di saktë."

8 Përgjigjet që unë ju lexova, Dëshmitar, a janë të sakta?

9 PË. Po.

10 Z. PACE: [Përkthim] Ta heqim këtë dokument nga ekрани.

11 PY. Sikurse e konfirmuat dhe sikurse e pamë edhe në këtë
12 pjesë që ju lexova, Jakup Krasniqi ju ka përmendur krijimin e
13 nënzoneve kur jeni takuar me të në 1998-n. A mund të na thoni
14 në qoftë se është caktuar ndonjë person përgjegjës për
15 nënzonat ose në atë kohë ose më vonë sesa atë?

16 PË. Më vonë e di se jam përcaktuar si komandant i Nënzoneve
17 Operative të Nerodimës.

18 PY. Për ta sqaruar, Dëshmitar, personi që u caktua si
19 zëvendëskomandant i nënzoneve të Nerodimës ishte vetë ti?

20 PË. Unë u caktova komandant i Nënzoneve Operative të
21 Nerodimës.

22 PY. Kush e bëri këtë caktim, këtë emërim?

23 PË. Po në përcaktim thuhej nga Shtabi i Përgjithshëm i
24 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

25 PY. A ju kujtohet se kohë kishte kaluar nga momenti kur ju

1 ishit paraqitur së bashku me Jakup Krasniqin në qershor të
2 1998 kur ju komunikua ky emërim, sa kohë kishte kaluar që prej
3 atëherë?

4 PË. Mund të kenë kaluar 20 deri 30 ditë kështu.

5 PY. Domethënë, i takon që do ketë qenë pak a shumë nga
6 korriku i vitit 1998?

7 PË. Në korrik të 1998.

8 PY. A ju kujtohet se kush ishte përgjegjës për nënzonën e
9 Pashtrikut?

10 PË. Edhe një herë se s'e kuptova?

11 PË. Kush ishte përgjegjës për nënzonën e Pashtrikut, a ju
12 kujtohet?

13 PË. Nuk di a e kam dit në korrik apo jo. Po në fund të
14 korriku sigurisht ka qenë, nëse nuk gaboj, Musa Jashari.

15 PY. Kur u caktuat, u emëruat si komandant i nënzonës a keni
16 bashkërenduar punët ose a keni pasur ndonjë takim
17 bashkërendimi me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së për sa i
18 takon veprimtarive të nënzonës tuaj?

19 PË. Jo, realisht unë u emërova komandant i nënzonës dhe nuk e
20 dija qartë se çfarë stafi duhet të ketë dhe cilat do të jenë
21 territori i përgjegjësisë. Realisht në atë kohë vetëm emërimin
22 e kam marrë.

23 PY. A keni kërkuar sqarime sa i takon territorit që kishit ju
24 nën përgjegjësinë tuaj?

25 PË. Nuk ishte e qartë territori, po si komuna më thanë që të

1 duhet të veprohet në komunën e Kaçanikut, Lipjanit dhe të

2 Shtimes dhe Ferizajt. Po Kaçaniku ishte me dilemë.

3 PY. Kur filluat që të krijoni njësi të tilla ose të bëni

4 bashkërendim, koordinim, a keni folur me ndokënd në Shtabin e

5 Përgjithshëm sa i takon punës që po bënit ju?

6 PË. Realisht tani e kishim një adresë. E kishim zëdhënësin e

7 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe e kemi njoftu për

8 zhvillimet që kanë ndodhur në terren. Për shkak edhe të

9 intervistave të tij që u dashtë të njoftohet për gjatë

10 intervistimit në pyetjet e gazetarëve. Po dhe në të njëjtën

11 kohë që ne në atë kohë mendonim se ai duhet ta njoftojë

12 Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

13 Kështu e kemi konceptuar në atë kohë.

14 PY. Për të qenë të qartë, a mund të na e thoni emrin e

15 zëdhënësit për të cilin e keni fjalën?

16 PË. Fjala është për zëdhënësin e Ushtrisë Çlirimtare të

17 Kosovës, të respektuarin z. Jakup Krasniqi.

18 PY. Thatë se e keni informuar atë lidhur për zhvillimet në

19 terren. A mund të na thoni sesi e keni informuar atë? E keni

20 informuar gjatë takimeve personale që keni pasur me të? Përmes

21 telefonit, në mënyrë tjetër? Na e shpjegoni pak ju lutem?

22 PË. Jo, mundësitë përmes telefonit nuk kemi pas në atë kohë,

23 por kemi pas mundësi me kontakt drejtpërdrejt.

24 PY. Kur e takonit ju drejtpërdrejt atë?

25 PË. Nëse nuk gaboj, në muajin korrik, ka mujt me e taku një

1 herë në Javor.

2 PY. Në çfarë vendi e keni takuar ose në çfarë vendesh jeni
3 takuar me të?

4 PË. E thashë, i nderuar, në Javor. Është fshat Javor.

5 PY. Në rregull. Pati një problem përkthimi, tani e kuptoj
6 përgjigjen që ju thatë që jeni takuar me Jakup Krasniqin një
7 herë në Javor. Është e saktë kjo, Dëshmitar?

8 PË. Po.

9 PY. Çfarë keni biseduar me të kur jeni takuar me Jakup
10 Krasniqi në Javor?

11 PË. Po kemi biseduar për rrjedhën e organizimit që kam bërë
12 në pjesën e Kaçanikut, të Shtimes dhe të Lipjanit dhe
13 problemet që kam pasur për ta njoftuar i kam thënë që
14 "Njoftoje Shtabin e Përgjithshëm sepse kam bukur shumë
15 probleme" të cilat kanë qenë në atë kohë dhe ka qenë ofensiva
16 bukur e ashpër.

17 PY. Çfarë lloj problemesh i keni përmendur Jakup Krasniqit në
18 atë kohë?

19 PË. Po kanë qenë shumë probleme dhe propagandë bukur e
20 fuqishme që është ngjallur apo është intensifikuar nga
21 pushtuesit nga Serbia dhe të cilin e kanë propagandu pa
22 vetëdije një pjesë e ushtarëve të UÇK-së dhe popullata civile.

23 PY. Dua që të kthehem pas në kohë për një çast. Përpara
24 krijimit të nënzonave a ka pasur ndonjë person apo ndonjë grup
25 me të cilin duhet të kontaktonit sa i takon organizimit të

1 njësiveve të UÇK-së në zonën tuaj?

2 PË. Në nënzonë apo me njësitet guerile me të cilat jam
3 takuar, ka qenë njësiti gueril në Kaçanik ku ka qenë Agim
4 Bajrami. Në Ferizaj, njësiti ku e ka udhëheq Imri Ilazi,
5 komandant Ferri. Në Shtime, kam qenë në pjesën më të madhe
6 vetë. Në Lipjan, ka pas disa njësive. Po njësiti më i fuqishëm
7 ka qenë i udhëhequr nga Ramiz Qeriqi.

8 PY. Në këtë kohë, domethënë, përpara krijimit në nënzonave a
9 e kishit ndjesinë që duhet që të mbanit kontakte edhe me
10 Shtabin e Përgjithshëm sa i takon zhvillimeve dhe sa i takon
11 veprimtarive që ndodhnin në terren?

12 PË. Ndjesinë e kishim. Po kishim vështirësi se nuk e dinim
13 kush është anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Vetëm mund të
14 supozonim. Prandaj edhe organizimi ka qenë me përgjegjësi
15 kryesisht të njësiveve guerile të cilat kanë vepru, do të
16 thotë edhe territorialisht kanë qenë shumë të shkëputuna, kanë
17 vepru secili në territorin e vet.

18 PY. A duhej që të mbanit kontakte me Hashim Thaçin sa i takon
19 këtyre njësiveve, Dëshmitar?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj. Është orientuese.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
22 vazhdoni.

23 Z. PACE: [Përkthim]

24 PY. Do ta përsëris edhe një herë pyetjen, Dëshmitar. A ju
25 duhet që të mbanit kontakte me Hashim Thaçin lidhur me

1 njësitet në atë kohë, domethënë, përpara krijimit të
2 nënzonave?

3 PË. Po nevojën u në e kam pas me kontaktu me secilin, me u
4 konsultu me secilin, po nuk di që kemi kontaktu me Hashim
5 Thaçin në atëkohë.

6 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se më
7 lejoni që t'i tregoj një pjesë që një deklaratë të mëhershme
8 dëshmitarit sipas rregullës 143(2) (c).

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
10 vazhdoni.

11 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të paraqesë
12 në ekran dokumentin IT-03-66 T3686-T3760_Përkthim i
13 Korrigjuar.

14 Do lexoj nga faqja 83, rreshtat 3 deri në 7 që në shqip
15 është IT-03-66 20050303 Pjesa 3-TR-AT faqja 21, rreshtat 24,
16 në faqen 22, rreshti 4.

17 PY. Edhe një herë për sqarimin tuaj, Dëshmitar, unë do t'ju
18 lexoj një pjesë nga dëshmia që ju keni dhënë në gjykimin
19 kundër Limajt në vitin 2005, e keni dhënë më datën 3 mars.

20 "PË. Forma e organizimit së UÇK-së në atë kohë, mënyrën
21 se si e kam parë unë, ishte Shtabi i Përgjithshëm dhe njësitet
22 guerile. Si person që më duhej të organizoja njësitet guerile
23 unë duhej që të mbaja kontakte me Shtabin e Përgjithshëm
24 përmes Hashim Thaçit. Ky ishte qëllimi i udhëtimit tim atje."

25 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

1 PË. Po, kështu e kam thënë.

2 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

3 PY. Dëshmitar, mesa dini ju krijimi i nënzoneve a solli
4 ndonjë ndryshim sa i takon bashkërendimit të njësiveve në
5 zonën tuaj?

6 PË. Ndryshimi ndodhi në korrik kur doli zëdhënësi i Ushtrisë
7 Çlirimtare të Kosovës publikisht, do të thotë, si zëdhënësi i
8 Ushtrisë Çlirimtare ishte adresa publike për të gjithë ne dhe
9 për popullatën civile.

10 PY. A mund të na shpjegoni se si paraqitja publike e
11 zëdhënësit të UÇK-së i ndryshoi gjërat në korrik?

12 PË. Po i ndryshoi sepse dhe ne si ushtarë të Ushtrisë
13 Çlirimtare të Kosovës dhe komandantë të njësiveve guerile
14 kishim mundësi me kontakt me zëdhënësin, me njoftu për
15 zhvillimet, me kërk diçka nga Shtabi i Përgjithshëm përmes
16 zëdhënësit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe kjo ka qenë
17 një periudhë, periudhë bukur e shkurtë sepse, nëse nuk gaboj,
18 në gusht veç është komandantët e nënzoneve e kanë dit emrin e
19 shefit të shtabit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

20 PY. Si e dinin këtë emër komandantët e nënzoneve, nga e
21 kishin mësuar këtë emër?

22 PË. Po realisht përmes zëdhënësit jemi njoftu se tashmë është
23 shefi i Shtabit të Përgjithshëm z. Bislum Zyrapi dhe
24 kontaktet është dashtë t'i mbajmë përmes shefit të Shtabi të
25 Përgjithshëm.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, për procesverbal
2 më duhet të them që kundërshtoj pyetjen që ju bë dëshmitarit,
3 megjithatë nuk doja që ta ndërprisja Prokurorin për këtë arsye
4 nuk e thashë që e kundërshtoja pyetjen, por dua ta them këtë
5 gjë për procesverbal.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

7 Z. PACE: [Përkthim]

8 PY. Dëshmitar, mesa dini ju gjatë kohës kur janë krijuar
9 nënzonat a ka pasur urdhra apo udhëzime lidhur me krijimin e
10 brigadave?

11 PË. I nderuar Prokuror, krijimi i nënzoneve dhe emërimi i
12 komandantëve të nënzoneve janë dy çështje bukur të gjera.
13 Sepse ne jemi emru komandantë nënzone. Por për krijimin e
14 nënzoneve që nënkupton një nënzone të ketë disa brigada deri
15 në divizion, sipas strukturave ushtarake të sotme, kërkon
16 tepër shumë kohë. Madje në disa shtete dhe ku s'ka luftë
17 kërkon vite.

18 Do të thotë, është fjala për një periudhë në të cilën ne
19 jemi emru komandantë të nënzoneve dhe kemi filluar punën për
20 të organizuar një komandë, e cila ka qenë bukur shumë e
21 kufizuar. Dhe në tetor dikund kur ka kalu në organizimin e
22 zonave, atëherë kemi filluar me, së paku, në zonën time, kemi
23 filluar edhe me krijimin e strukturave të komandave të
24 brigadave.

25 PY. Në verën e 1998-s ose më vonë, Shtabi i Përgjithshëm a

1 lëshoi ndonjë urdhër ose udhëzim që duhej të krijoheshin
2 brigadat ose njësitë luftarake a ka ndodhur kjo gjë,
3 Dëshmitar?
4 PË. Kjo, sa e di unë, jo, për mua jo, sepse unë deri në diku
5 ka mesi i gushtit kam qenë në Kosovë, pastaj qartësimi i
6 organizimit ka ndodhur pas kthimit tim në Kosovë dhe marrjen e
7 udhëheqjes dhe organizimit të zonës apo ristrukturimit të
8 nënzonës dhe kalimit në zona operative dhe, do të thotë, ku ka
9 qenë diku tetori i 1988.

10 PY. Kush e ka bërë të qartë organizimin pasi u kthyet ju në
11 Kosovë?

12 PË. Po qartë është bërë organizimi, pasi kthimi në Kosovë,
13 veç e kemi pas dhe shefin e shtabit i cili ka qenë përgjegjës
14 për operimet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ka qenë
15 përgjegjës edhe për kontaktin dhe urdhrat për komandantët e
16 zonave.

17 PY. Për të qenë të qartë, a mund të na thoni për kë shef të
18 shtabit e keni fjalën?

19 PË. Shefi i shtabit ka qenë Bislime Zyrapit.

20 PY. Ajo kujtohet ndonjë urdhër apo udhëzim i Bislime Zyrapit
21 që duhet të krijoheshin brigada si dhe njësitë luftarake?

22 PË. Nëse nuk gabo, në atë kohë është -- na është dhënë një
23 formë e strukturimit të zonave operative të cilat kanë
24 operuar.

25 PY. Për të qenë të qartë sa i takon kohës, bëhet fjalë

1 përpara sesa zonat të bëheshin nënzona apo mbrapa, na e

2 përcaktoni pak kohën?

3 PË. Një faqes -- po ka zhurma shumë. A bën me e përsërit

4 pyetjen?

5 PY. Thatë që në qoftë se nuk e keni gabim, në atë kohë juve

6 ju dha një lloj strukture e zonës operative. A e kuptoj drejt

7 që kjo ka ndodhur kur keni pasur nënzona, domethënë, përpara

8 sesa të bëhej krijimi i zonave kjo ka ndodhur në kohën kur ju

9 ishit organizuar në nënzona?

10 PË. Jo. Unë e thashë kur jemi organizuar në zona dhe kjo ka

11 ndodhë diku në fund të tetorit, nëse s'gaboj, fillim të

12 nëntorit të 1998.

13 PY. Do kalojmë dhe tek kjo për pak. Përmendët që jeni takuar

14 me Jakup Krasniqin në 1998 në Kleçkë dhe në Javor po ashtu. A

15 ju kujtohet që ta keni takuar atë dhe në një rast tjetër,

16 Dëshmitar?

17 PË. Për momentin nuk po më kujtohet.

18 PY. Rreth qershorit apo korrikut të 1998-s, a jeni takuar apo

19 a keni pasur kontakt ndryshe me ndonjë anëtar tjetër të

20 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së përveç Jakup Krasniqit?

21 PË. S'po i kam dit që janë anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm

22 nuk e besoj, po ma vonë i kam kuptu ata që i kam takuar se

23 kane qenë ndoshta anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm. Po si

24 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, në korrik, që e kemi ditur

25 ka qenë Jakup Krasniqi, zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të

1 Kosovës.

2 PY. Në qershor ose në korrik të 1998, a jeni takuar me ndonjë
3 person për të cilin mësuar më vonë që ka qenë anëtar i Shtabit
4 të Përgjithshëm të UÇK-së?

5 PË. I nderuar Prokuror, unë në atë kohë kam mendu apo kam
6 supozu që anëtar i Shtabit të Përgjithshëm është edhe Fatmir
7 Limaj. Po në fund të korrikut kam kuptu se Fatmir Limaj nuk
8 është anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe e kam kuptu edhe
9 kur është emëru në tetor apo nëntor. Do të thotë, gabimet kanë
10 qenë shumë njerëzore në atë kohë sepse s'i kemi dit anëtarët e
11 Shtabit të Përgjithshëm. Dhe ne i kemi supozu. Edhe në
12 deklarata kam mujt me bë ndonjë lëshim të tillë me thënë që me
13 filanin apo fistekun.

14 Po, në fakt, ne kemi takuar zëdhënësin e Ushtrisë
15 Çlirimtare të Kosovës i cili publikisht ka qenë anëtar i
16 Shtabit të Përgjithshëm dhe zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të
17 Kosovës. Për të tjerët kemi mujt veç me supozu.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace,
19 duhet të bëjmë pushim dhjetë minuta tani.

20 Dëshmitar, do bëjmë dhjetë minuta pushim tani dhe do
21 kthehemi në sallën e gjyqit pas dhjetë minutash. Tani mund të
22 dilni nga salla.

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në seancë
25 publike apo private?

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Në publik. I nderuar Kryegjykatës,
2 dua të kundërshtoj pyetjen. Unë e kam bërë kundërshtimin dhe
3 thashë që pyetja është sugjestionuese, po më lejoni të vendos
4 pak pyetjen në ekran. Faqja 23, rreshti 7:

5 “A keni mbajtur kontakte me Hashim Thaçin për njësitet në
6 këtë kohë?”

7 Pse them unë që është kjo sugjestionuese, sepse ky aspekt
8 ka qenë pjesë e parashtrimeve që ka bërë Alex Whitting në
9 gjykimin Fatmir Limaj, e ka përdorur këtë si bazë për ta
10 deklaruar Fatmir Limajn armiqësor. Dhe ai ka thënë në 2003 se
11 ai ka mbajtur kontakte me Shtabin e Përgjithshëm përmes Fatmir
12 Limaj. Dhe më pas unë do t’ju lexoj çfarë ka thënë Alex
13 Whiting.

14 Z. PACE: [Përkthim] Kjo është e papërshtatshme. Avokati
15 le t’i bëjë pyetjet gjatë pyetjeve të veta. Nuk është ky
16 momenti për të interpretuar dëshminë e dëshmitarit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 Z. MISETIC: [Përkthim] E vlerësoj. Dhe ju lutem mos më
19 ndërprisni. Nuk është ky kundërshtimi im. Prokuroria ka për
20 detyrë këtu të vendosë se cila është e vërteta, cili është
21 versioni i saktë. Ky është kundërshtimi im.

22 Z. Pace duhet të thotë cili prej këtyre versioneve të
23 dëshmisë së këtij dëshmitari do përdoret nga ZPS-ja. I 2003-
24 shit që Alex Whiting ka thënë dëshmia e vërtetë apo është
25 dëshmia e 2005-s së këtij dëshmitari si dëshmia e vërtetë? Po

1 Alex Whiting ka thënë që ta deklarojmë këtë armiqësor, këtë
2 person armiqësor. Po ju lexoj një transkript të TPNJ-së, ai ka
3 thënë:

4 "Pra, ai, qysh në fillim të marsit të 1998-s ka thënë që
5 plani ishte përcaktuar. Përpara se të largoheshin, do të
6 mbërrinin në Drenicë dhe plani ishte të shkojmë të
7 organizohemi në këtë zonë dhe struktura do të jetë si në
8 vijim: Fatmir Limaj do të jetë pika e kontaktit me Shtabin e
9 Përgjithshëm, ju do të koordinoheni me Fatmir Limajn dhe më
10 pas ai do të koordinoj me Shtabin e Përgjithshëm. Ju do ta
11 shihni, që intervista vijon dhe më poshtë dhe pikërisht kështu
12 u krijuan struktura në muajt maj, prill të 1998. Dje
13 përshkrimi i tij, i Fatmir Limajt, ka qenë krejt ndryshe. Edhe
14 sot në faqen 83 ka thënë që nuk mund ta them me siguri a ka
15 pasur ndonjë detyrë Fatmir Limaj në atë kohë. Unë nuk e di
16 nëse në mars e në prill të 1998 në Drenicë ka pasur ndonjë
17 detyrë Fatmir Limaj. Dhe tha kur ka shkuar në Mollopolc
18 kontakti i tij i vetëm ka qenë që u pajtua me Fatmir Limaj se
19 do të kontaktonte me të por më shumë se do ta shoqëronte gjatë
20 udhëtimit, por nëse do të duhet të udhëtonte për të takuar
21 Hashim Thaçin atëherë do të duhet të kontaktonte me Fatmir
22 Limaj që t'i tregonte rrugën se si të takohet me Hashim
23 Thaçin."

24 Tani kundërshtimi është ky: Prokuroria e ka për detyrë
25 ndaj Trupit Gjykses sipas rregullores të përcaktojë të

1 vërtetën. Mënyra se si është formuluar dhe pse them unë që kjo
2 është sugjestionuese është pikërisht pika kontestuese për mua.
3 Prokuroria duhet ta pyesë dëshmitarin: Përmes cilit person
4 keni mbajtur kontakte me Shtabin e Përgjithshëm?

5 Por në vend të kësaj i thanë a u kontaktuat ju me Hashim
6 Thaçin? Dëshmitari nuk u përgjigj dhe ata i treguan një dëshmi
7 të 2005-s.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ku doni të
9 dilni?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua që t'i kërkon Prokurorisë a
11 do ndjekim versionin e 2003-shit apo do ndjekim versionin e
12 2005-s?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju thatë që
14 pyetja është sugjestionuese. Unë e rrëzoja. Nuk mu duk
15 sugjestionuese. Nuk na dhatë asnjë shpjegim dhe tani jemi pas
16 faktit. Unë nuk mund ta kundërshtoj Prokurorinë tani për këtë.
17 Ju mund të bëni të gjitha pyetjet që dëshironi gjatë radhës
18 suaj të pyetjeve, po Prokuroria nuk merr udhëzim nga Trupi
19 Gjykues për barrën e provës.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë e thashë atëherë për
21 procesverbal këtë, po unë do të vijoj të kundërshtoj për
22 faktin se Prokuroria duhet të përdorë një version përfundimtar
23 për këtë dëshmitar. Nëse do të nxjerrin 2005-n, për të cilën
24 TPNJ-ja ka dalë në përfundimin se ka qenë e pavërtetë, atëherë
25 duhet të jetë e qartë Prokuroria.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo është
2 një, për ne, një pikë shumë e paqartë. Këtu nuk kemi një
3 argument, nuk i themi dot ne se cili material do të
4 prezantojë.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Po problemi është me parashtrimin
6 sipas rregullës 154 sepse ata kërkojnë që të dyja deklaratat
7 të pranohen për vërtetësinë e përmbajtjes së tyre, mirëpo ka
8 mospërputhje.

9 Dhe mesa kam kuptuar unë nga vendimi sipas rregullës 154,
10 disa nga këto aspekte duhet t'i trajtojmë në sallën e gjyqit
11 për të kuptuar ku janë mospërputhjet. Tani jemi në atë pikë ne
12 që kur të bëjmë kundërpjetet tona do të duhet të kuptojmë se
13 cili është versioni i vërtetë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po atëherë
15 bëni pyetje ju për këtë.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Po do të bëj unë pyetje për këtë,
17 po unë do të vijoj të kundërshtoj që pyetjet janë
18 sugjestionuese.

19 Z. DIXON: [Përkthim] A mund të shtoj dhe unë diçka sepse
20 kjo është shumë e rëndësishme?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

22 Z. DIXON: [Përkthim] Është e rëndësishme kjo parimisht.
23 Pra, Prokuroria po ndjek dy pista. Sepse po përdorin edhe
24 rregullën për të fajësuar dëshmitarin, por dhe po përpigën të
25 marrin të vërtetën nga dëshmitari. Ne si Mbrojtje duhet të

1 kuptojmë për kundërpyetjet tona a po mbështeten në këtë
2 dëshmitar dhe nëse po, në cilat pjesë po mbështeten. Dhe nëse
3 duan të tregojnë se ka mospërputhje dhe duan të dalin në
4 përfundimin që ai ishte armiqësor si dëshmitar, atëherë ta
5 dimë se cilat janë pjesët përkatëse.

6 Nuk jemi këtu për të bërë argumentet përmbyllëse. Po ne
7 si Mbrojtje duhet të kuptojmë për të orientuar kundërpyetjet
8 tona ku po mbështetet Prokuroria e ku nuk po mbështetet, ku ka
9 mospërputhje, për cilat fjalë bëhet fjalë që nuk ka
10 mospërputhje.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Do bëjmë dhjetë minuta pushim duke filluar që tani.

13 --- Seanca ndërpritet në orën 10.08

14 --- Seanca rifillon në orën 10.21

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem

16 sillni dëshmitarin.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Më jepni një çast.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mos e sillni

19 dëshmitarin.

20 [Mikrofoni çaktivizuar].

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua të njoftoj Trupin Gjykses edhe

22 palët se do kërkojmë një verifikim përkthimi në faqen 14,

23 rreshtat 15 dhe 16, sepse sipas transkriptit thuhet që:

24 "Agim Bajrami u caktua komandant dhe unë u thirra në emër
25 të Shtabit të Përgjithshëm."

1 Mua më thanë që në shqip është thënë, të paktën siç e
2 kemi dëgjuar ne, është thënë që ai ka thënë që:

3 "Unë e emërova Agim Bajramin komandant dhe u ka thënë
4 atyre se emërimi ka qenë nga Shtabi i Përgjithshëm".

5 Po e them për procesverbal që të jenë të gjithë informuar
6 që kemi një pikëpyetje për këtë pjesë të përkthimit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
8 Faleminderit.

9 [Dëshmitari vijon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
11 vazhdojmë me pyetjet nga ana e Prokurorisë.

12 Z. Pace, fjala është për ju.

13 Z. PACE: [Përkthim]

14 PY. Dëshmitar, përpara pushimit, po diskutonim nëse keni
15 pasur kontakte me ndokënd nga Shtabi i Përgjithshëm rreth
16 qershorit, korrikut 1998 përveç Jakup Krasniqit. Dhe ju thatë
17 se keni mësuar identitetin e disa anëtarëve të Shtabit të
18 Përgjithshëm ose që mund të kenë qenë në Shtabin e
19 Përgjithshëm kohë më pas.

20 Unë dua t'ju pyes më konkretisht, nga qershori, korriku
21 1998 me Sokol Bashotën keni pasur ndonjë kontakt?

22 PË. Nuk më kujtohet.

23 PY. Të kujtohet të kesh ditur nga qershori, korriku i 1998
24 apo ta kesh mësuar dhe më vonë se Sokol Bashota ka qenë anëtar
25 i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

1 PË. Për Sokol Bashotën kam marrë vesh në përfundim të luftës.

2 PY. Çfarë ke marrë vesh saktësisht në fund të luftës?

3 PË. Por në fund të luftës veç janë bërë publik emrat e
4 Shtabit të Përgjithshëm.

5 PY. Të fokusohemi në verën e 1998-s, çfarë dije për rolin e
6 Sokol Bashotës në UÇK në verën e 1998 nëse dije ndonjë gjë?

7 PË. Unë në atë kohë s'kam dit për Sokol Bashotën.

8 PY. Mban mend ta kesh takuar ndonjëherë në 1998?

9 PË. Ka mundësi ta kem takuar kur jam hyrë në Kosovë.

10 PY. Po më pas e ke takuar?

11 PË. Nuk më kujtohet që e kam takuar.

12 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të doja t'i
13 tregoja një deklaratë të mëparshme dëshmitarit në bazë të
14 rregullës 143(2)(b) dhe (c).

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

16 Z. PACE: [Përkthim] Bëhet fjalë për materialin IT-03-66
17 T4002-T4087 I Paredaktuar_Me korrigjim përkthimi, dhe do lexoj
18 nga faqja 19, rreshti 9 deri në faqen 21, rreshti 5. Në shqip
19 është IT-03066 9 mars 2005-TR-AT Pjesa 1 E Paredaktuar, faqja
20 23, rreshti 11 deri në faqen 25, rreshti 25.

21 PY. Dëshmitar, këto janë pjesë të dëshmisë në gjykimin Limaj
22 data 9 mars 2005. Do t'ju lexoj disa pjesë dhe më pas do t'ju
23 bëj pyetje.

24 "PY. Jo, po na tha që Jakup Krasniqi nuk transmetoi
25 asnjëherë urdhra ose udhëzime lidhur me ndihmën njësit-njësit.

1 Pyetja është: Kush, në qoftë se nuk ishte Jakup Krasniqi dhe
2 nuk ishte Fatmir Limaj, kush ishte atëherë ai që i
3 transmetonte udhëzimet nga Kleçka gjatë korrikut 1998 për
4 ndihmën njësit-njësit?

5 "PË. Në atë kohë do të thotë unë i njihja dhe ata
6 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm që merreshin edhe me
7 organizimin, do të thotë, organizimin e kësaj forme të luftës.
8 Njihja dhe Azen Sylën, që më vonë, shumë më vonë do ta njoh si
9 komandant të përgjithshëm. Njihja dhe Sokol Bashotën si anëtar
10 të Shtabit të Përgjithshëm, i cili po ashtu mërej me
11 organizimin. Dhe normalisht udhëzimet i kam marrë nga këta.
12 Dhe kjo ka qenë forma, një formë e organizimit që ka qenë në
13 atë kohë.

14 "PY. Çfarë udhëzimesh keni marrë prej këtyre në atë
15 kohë, a mund të jeni më specifik, ju lutem?

16 "PË. Unë në korrik, do të thotë, kam marrë edhe udhëzime
17 thashë edhe urdhëresat, kam marrë edhe urdhëresa të cilat kanë
18 qenë për nënzonën operative të Nerodimës, kam marrë urdhëresa
19 po formën e strukturimit të njësiteve sesi do të mund të dukej
20 komanda e nënzonës dhe njësitet, si mund të funksiononin më
21 vonë. Thjesht udhëzimet, urdhëresat janë marrë nga Shtabi i
22 Përgjithshëm sepse unë isha komandanti i nënzonës operative.

23 "PY. Po në korrik gjatë asaj që ju përshkruat si një
24 ofensivë shumë të ashpër, Sokol Bashota apo Azem Sylja ishin të
25 përfshirë në koordinimin e njësiteve gjatë këtyre luftimeve,

1 pra?

2 "PË. Sigurisht që ishin të përfshirë, sepse kishim një
3 ofensivë me një rreze të gjerë veprimi dhe ata lëviznin në
4 territorin e komunës së Malishevës. Kjo do të thotë ka pas
5 veprim të Shtabit të Përgjithshëm në atë periudhë në atë
6 terren."

7 Po e ndërpres për një çast. Dëshmitar, kjo që u lexova
8 unë deri tani që është dëshmia juaj, a është e saktë?

9 PË. Mund të jetë e saktë sepse realisht unë s'mund ta kujtoj
10 tash të gjithë dëshminë.

11 PY. Vijojejmë me leximin:

12 "PY. Kur ata e bënë këtë në fund, në fund të korrikut
13 gjatë ofensivës, a ishin ndonjëri prej tyre në Kleçkë?

14 "PË. Kanë qenë në periudha të ndryshme të korrikut, do
15 të thotë, ka pas vizita të shpeshta të anëtarëve të Shtabit të
16 Përgjithshëm në Kleçkë por unë i kam takuar edhe në fshatra të
17 tjerë, veçanërisht me Sokol Bashotën jemi takuar në Malishevë
18 kur duhet të dërgonim disa ushtarë të nënzonës për të marrë
19 armatim në Shqipëri. Thjesht kam kontaktuar mjaft shpesh me
20 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm."

21 Po ndërpres prapë fjalën, Dëshmitar. Ju kujtohet ta keni
22 takuar Sokol Bashotën në Malishevë kur duhet të dërgonit
23 ushtarë nga nënzona juaj për të marrë armatime në Shqipëri, ju
24 kujtohet që keni folur për këtë?

25 PË. Po, por në atë kohë s'e kam njoft me emër e mbiemër, po

1 pas lufte e kam njoft se ka qenë Sokol Bashota. Ne kemi
2 përcjellë bukur shumë civilë për t'u armatosur dhe për t'u
3 kyçur në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Do të thotë,
4 sigurisht që e kam takue dhe Sokol Bashotën. Po në periudhën
5 kur flas, në periudhën e luftës, unë s'e kam njoft me emër e
6 mbiemër. E kam njoft, do të thotë, pas luftës se ka qenë Sokol
7 Bashota.

8 PY. Po gjatë luftës, sipas teje, çfarë ishte ai?

9 PË. Unë e kam parë në veprim dhe realisht unë kam kontaktuar
10 me të për t'i përcjellë njerëzit për në Shqipëri për armatim.
11 Kam kontaktuar dhe me njerëz të tjerë, po me Sokol Bashotën,
12 do të thotë, kemi pas pjesën e përcjelljes deri në Dukagjin, i
13 kam sugjeru që të jenë të kujdesshëm sepse janë pjesë e
14 civilëve të cilët janë nga nënzona ku isha përgjegjës për t'u
15 armatosur për në Shqipëri.

16 PY. Nëse po e kuptoj saktë, ju po thoni që gjatë kohës që e
17 keni kontaktuar, pra, kur keni pasur këtë kontakt, ju nuk e
18 dinit që ai e kishte emrin Sokol Bashota, këtë e keni mësu më
19 vonë. Po kur e keni kontaktuar ju, kur e takuat me çfarë emri
20 e keni njohur ose nofke, pseudonimi?

21 PË. Nuk më kujtohet pseudonimi, po e di që pas luftës e kam
22 kuptu se ka qenë Sokol Bashota.

23 PY. Po vazhdoj të lexoj:

24 "PY. Pyetja ime është më specifike. Gjatë fundit të
25 korrikut gjatë ofensivës kur ju thoni që Sokol Bashota dhe

1 Azen Syla ishin të përfshirë në koordinimin e njësiveve qoftë
2 njëri apo tjetri, a kanë qenë të vendosur në Kleçkë kur e
3 bënë këtë?

4 "PË. Unë thashë se kanë qëndruar në periudha të
5 caktuara, do të thotë, kanë mundur të jenë dy-tre ditë në
6 Kleçkë dhe ditëve të tjera të jenë në fshatra afër Kleçkës si
7 ç' është Javor, Tërpezë, fshatra afër Kleçkës ose në Malishevë
8 dy-tri ditë. Unë kam pas mundësi ta kontaktoj me këta njerëz
9 dhe më shpesh kam kontaktuar me ta në Kleçkë.

10 "PY. E kuptoj përgjigjen tuaj, po a mund t'i përgjigjeni
11 pyetjes sime: A e dini ju nëse ndonjëri prej tyre ka qenë në
12 Kleçkë gjatë ofensivës së parë në fund të korrikut 1998?

13 "PË. Thashë që kanë qëndruar në Kleçkë në periudha të
14 caktuara dhe në korrik unë i kam kontaktuar ata shpesh. Nuk
15 mund ta di nëse kanë qenë çdo ditë në Kleçkë, por unë kam
16 kontaktuar me ta në Kleçkë, në Javor dhe në Tërpezë."

17 Është e saktë kjo, Dëshmitar?

18 PË. Po, sa më kujtohet kështu ka qenë.

19 PY. Sa i takon Azem Sylës a mund të na sqaroni me përafërsi
20 kur e keni takuar?

21 PË. Po ka qenë muaji korrik, nëse s'gaboj, po realisht është
22 një periudhë e ofensivës shumë të ashpër dhe nuk e di dot
23 saktë kur ka qenë korrik apo fundi i korrikut apo gushtit.

24 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

25 PY. Dëshmitar, jeni takuar ndonjëherë me Hashim Thaçin në

1 Kleçkë në 1998 ose 1999?

2 PË. Nëse s'gaboj, jam takuar në korrik.

3 PY. Me ç'rast?

4 PË. Po ka pas një takim me ndërkombëtarët, nëse s'gaboj dhe
5 në atë kohë jam takuar.

6 PY. A të kujtohet ose a të kujtohen temat që keni diskutuar
7 në atë takim?

8 PË. Nëse nuk gaboj, pas takimit me ndërkombëtarët, ne kemi
9 shkuar me u taku me popullatën civile në Grykë të Shalës.

10 PY. Të fokusohemi fillimisht tek takimi me ndërkombëtarët.

11 Nëse ju kujtohet për çfarë ishte ky takim?

12 PË. Nuk kam qenë pjesë e takimit, po realisht ka qenë një
13 takim që më vonë është bë publik dhe e di që janë taku për
14 çështjen e përfaqësimit politik edhe të ideve të Ushtrisë
15 Çlirimtare të Kosovës politike.

16 PY. Të jemi të qartë, ke qenë personalisht në këtë takim me
17 ndërkombëtarët në Kleçkë në 1998 bashkë me Hashim Thaçin apo
18 thjesht ke mësuar për këtë takim?

19 PË. Unë nuk besoj që është mbajt në Kleçkë, po ashtu nuk kam
20 qenë pjesë e këtij takimi. Po e thashë në publik, pastaj në
21 media ka dalë se është mbajt një takim i përfaqësuesve të UÇK-
22 së me ndërkombëtarët.

23 PY. Pak më herët the "pas takimit me ndërkombëtarët shkua të
24 takoheshim me popullatën civile në Grykën e Shalës". Kur thua
25 "ne" për cilin e ke fjalën, kush ishte me ju?

1 PË. Po isha unë, Jakup Krasniqi dhe Hashim Thaçi.

2 PY. Po pse shkuat t'i takonit popullatën civile në atë rast?

3 PË. Po, pas ofensivës së fuqishme të forcave serbe dhe
4 luftimeve të ashpra që kemi zhvilluar njësitet e Ushtrisë
5 Çlirimtare të Kosovës në atë pjesë, pamundësisë për t'i
6 rezistuar gjithë atij operacioni, popullata civile është
7 zhvendosur nëpër gryka. Në Grykën e Shalës ka pas një pjesë
8 shumë të madhe të popullatës civile e në të cilën filluan të
9 propagandonin shumë keq si duket e lansuar kjo propaganda nga
10 forcat serbe. Dhe ishte një shqetësim shumë i madh i
11 popullatës civile.

12 Qëllimi i këtij kontakti me popullatën civile ishte që të
13 shohin zëdhënësin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Jakup
14 Krasniqi dhe t'i shohin se janë eprorët, si unë, që isha
15 komandant i nënzonës i emëruar, jemi në atë territor sepse
16 ishte përhapë propagandë shumë e fuqishme se komandantët e
17 UÇK-së kanë ikur për në Shqipëri.

18 Ky ishte qëllimi i takimit me popullatën civile.

19 PY. Mesa dini ju, në çfarë cilësie ka qenë në këtë takim
20 Hashim Thaçi?

21 PË. Ka qenë bashkë me ne, po unë kam supozuar se është një
22 prej njerëzve që, pas takimit nga ndërkombëtarët, është një
23 njeri i përgatitun politikisht. Ndërsa Jakup Krasniqi ishte se
24 ishte figurë publike e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës dhe unë
25 si komandant i nënzonës që isha në tanë kohën në operim në atë

1 kohë në atë pjesë, do të thotë, u takuam me popullatën civile.
2 PY. Çfarë do të thuash kur thatë Hashim Thaçi ishte "i
3 përgatitur nga pikëpamja politike"? Çfarë nënkupton kjo?
4 PË. Po meqë ishte takuar me ndërkombëtarët dhe ishte -- ishin
5 takuar për çështje politike me ndërkombëtarët për aspektin e
6 synimeve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës thjesht në
7 popullatë mirrej se ishte politikan bukur i fuqishëm i
8 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Po ashtu edhe Jakup Krasniqi
9 njihej bukur shumë nga popullata civile sepse ka qenë edhe ish
10 i burgosun politik edhe një njeri i cili ka qenë tanë kohën në
11 organizimin e strukturave të asaj kohe, pra, ka qenë pjesë e
12 strukturave të LDK-së dhe është njoftun mjaft mirë si një
13 njeri, një njeri i aftë politikisht dhe i zgjuar në aspektin
14 politik.
15 PY. Mund të na tregoni për këtë takim me popullatën civile?
16 Ka qenë një takim apo kanë qenë më shumë? Si ishte ky takim në
17 ç'formë?
18 PË. Po në grykën e Shalës ka pas dikund rreth 20 a 30,000 a
19 më shumë civilë të cilët ishin vendosun në tenda, ishin
20 vendosur ishin mundu me i rregullu tendat. Ishin në fushë të
21 hapur. Edhe bukur shumë të shqetësuar. Ne kemi takuar shumë
22 qytetarë, kemi ecur nëpër ta, kemi biseduar ndërkohë me
23 civilë. Dhe, në një moment, do të thotë, janë grumbulluar
24 bukur shumë civilë ku ju ka drejtuar me fjalë Jakup Krasniqi
25 për të mos shqetësohen sepse njësitet tona janë këtu. Ne si

1 udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare jemi këtu. Do të thotë, kjo
2 ka qenë ma shumë që të mos të shqetësohen popullata civile.

3 PY. Po ju personalisht në këtë takim folët me këtë grupin e
4 civilëve aty ku foli Jakup Krasniqi?

5 PË. Po, kam folur edhe unë me shumë civilë sepse takimet tona
6 ishin të aty për atyshme sa në një grup në grupin tjetër.

7 Sepse është një grykë bukur e madhe ku kishte shumë civilë dhe
8 normalisht që kemi kontaktue dhe njerëz që ishin aty.

9 PY. A ju kujtohet të paktën në përgjithësi se çfarë i keni
10 thënë civilëve me të cilët jeni takuar në këtë rast?

11 PË. Nëse nuk gabo, nëse më kujtohet, unë asaj popullate që
12 ishte grumbulluar ju kam drejtu tu e ditë se ishte përhapë një
13 propagandë shumë e fuqishme se zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare
14 të Kosovë ka marrë 100,000 marka dhe ka ik për në Shqipëri e
15 ju kam drejtuar popullatës që ta ndëgjojnë njërin i cili e din
16 më mirë se a ka ik Jakup Krasniqi apo s'ka ik Jakup Krasniqi
17 nga lufta. Le t'i drejtohet vetë Jakup Krasniqit, do të thotë,
18 që në kuptimin që më e liru popullatën nga ajo propagandë e
19 fuqishme që ishte. Dhe Jakup Krasniqi nuk më kujtohet se çka
20 ju ka drejtu qytetarëve po kjo ka qenë poenta kryesore e
21 gjithë fjalëve tona.

22 PY. A ju kujtohet në qoftë se Hashim Thaçi ka folur me një
23 apo më shumë civilë në këtë rast?

24 PË. Ka folur me civilë. Po nuk më kujtohet që ka mbajtur ndonjë
25 fjalë në atë rast.

1 PY. A jeni takuar ndonjëherë në Blinajë me Hashim Thaçi në
2 1998 apo 1999?

3 PË. Nëse nuk gaboj, po.

4 PY. Përafërsisht kur ka ndodhur kjo, nëse ju kujtohet?

5 PË. Nuk mund ta kujtoj kohën e saktë.

6 PY. A kujtohet ka ndodhur në 1998 apo 1999?

7 PË. 1998-n ka ndodh.

8 PY. Me ç'rast u takuat me Hashim Thaçin në Blinajë në 1998?

9 PË. Ka qenë vizitë shokësh, asgjë tjetër. Më ka vizitu si
10 shok që kemi qenë bashkë në Zvicër dhe kemi hyrë bashkë në
11 luftën në Kosovë.

12 PY. A ju kujtohet në qoftë se në këtë rast, pra, kur jeni
13 takuar me Hashim Thaçin a ka qenë i pranishëm ndonjë person
14 atje ku e ai ka ardhë te ju, ju ka vizituar juve?

15 PË. Kemi qenë një pjesë e ushtarëve. Nuk e di nëse ka qenë
16 dikush tjetër apo jo.

17 PY. A ju kujtohet se çfarë keni diskutuar me Hashim Thaçin
18 gjatë kësaj vizite, nëse ju kujtohet?

19 PË. Jo, s'mund ta kujtoj.

20 PY. Të ndryshojmë pak temë, Dëshmitar. Besoj se këtë temë e
21 cekët, megjithatë për të sqaruar, në 1998 a ka pasur një
22 periudhë që ka pasur pretendime ose ka pasur fjalë që
23 qarkullonin lidhur me ty brenda UÇK-së?

24 PË. Përsëriteni se s'e kuptova?

25 PY. Pyetja ishte kjo: Në 1998, a ka pasur thashetheme, a ka

1 pasur fjalë apo pretendime kundër jush në UÇK?

2 PË. Nuk po e di kundër meje apo kundër Ushtrisë Çlirimtare të
3 Kosovës?

4 PË. Kundër jush. A ju kujtohet në ndonjë periudhë kohe kur
5 ndokush ka bërë ndonjë akuzë apo ndonjë -- ka thënë ndonjë
6 fjalë sa i takon mënyrës sesi jeni sjellë ose zgjedhjeve të
7 caktuara që keni bërë në atë periudhë?

8 PË. Po. Përveç njerëzve tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të
9 Kosovës, unë jam goditur fillimisht me propagandën më të
10 fuqishme kundër meje, do të thotë, se një udhëheqës ushtarak
11 që i cili ka ik prej vijave të frontit, nuk po merr pjesë në
12 luftime e tjerë e tjerë, do të thotë, kjo ka qenë propaganda.

13 PY. A keni folur me ndokënd veçanërisht lidhur me këtë
14 propagandë ndaj jush, Dëshmitar?

15 PË. Po kur e kam parë që kjo ka marrë përmasa shqetësuese
16 sepse filloi të propagandohej dhe në mesin e ushtarëve të
17 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nëse nuk gabo, kam shkuar në
18 korrik kjo qenë, në e më kujtohet saktë, kam shkuar te
19 zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për t'ia treguar
20 shqetësimin sepse po bëhet një propagandë shumë e fuqishme dhe
21 rrezikshmëria për mua si individ ishte shumë e madhe për shkak
22 të propagandës që ishte përhapë.

23 PY. A kujtohet se çfarë i keni thënë zëdhënësit në atë kohë?

24 PË. Edhe një herë të lutem

25 PY. Çfarë i keni thënë zëdhënësit në atë kohë ju kujtohet?

1 Atëherë çfarë keni biseduar me zëdhënësin kur jeni takuar me
2 të lidhur me këtë temë?

3 PË. Po nëse më kujtohet, kanë qenë këto shqetësime që
4 njerëzit kanë përhap shumë propagandë kundër meje dhe pjesë e
5 këtyre propagandës, pjesë e kësaj propagande është edhe
6 udhëheqësi i njësitit gueril në atë pjesë dhe kam kërku që ose
7 të mirren masa në qoftë se unë paskam dezertuar, sipas fjalëve
8 të tyre ose të mirren masa ndaj atyre të cilën po përhapin
9 propaganda të tilla në mesin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

10 PY. Për çfarë masash e kishit fjalën, pra, çfarë masash mund
11 të merreshin kundër jush ose personave të tjerë?

12 PË. Po unë kam shpresu se kam mundësi me pas ndonjë mekanizëm
13 që do të mirren masat, po më vonë kur s'janë marrë këto masa,
14 do të thotë, e kam pa se nuk ka ndonjë mekanizëm i cili do të
15 kishte mund me e stopu këtë formë të propagandës apo të
16 marrjes së masave ndaj atyre të cilët kishin ngritur apo po e
17 përkrahnin këtë propagandë. Në veçanti, ndaj njërit i cili
18 ishte dhe udhëheqës i njësitit.

19 Dhe për një periudhë dhe kam pritur të veprohet, po s'ka
20 pas ndonjë veprim.

21 PY. Pse i ngritët këto çështje ose këto tema me Jakup
22 Krasniqin në atë kohë?

23 PË. Po pjesën korrikut, do të thotë, i vetmi njeri publik
24 ishte Jakup Krasniqi nga Shtabi i Përgjithshëm dhe unë kam
25 shpresuar që zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mund

1 ta përcjellë në Shtab të Përgjithshëm sepse në atëkohë ishte i
2 vetmi person publik i Shtabit të Përgjithshëm.

3 PY. Nëse ju kuptova drejt, ju e thatë që e keni kuptuar që
4 nuk mund -- nuk kishte masa që mund të merreshin, megjithatë
5 pas bisedës që keni pasur me Jakup Krasniqin a ka ndodhur
6 diçka, a ka ndryshuar diçka lidhur me situatën tënde ose
7 propagandën ndaj jush?

8 PË. Në fakt, pas bisedës me Jakup Krasniqin unë kam prit për
9 disa ditë, nëse nuk gaboj, apo mund të jenë edhe javë, që të
10 mirret ndonjë masë ndaj meje apo ndaj atyre që kishin përhapur
11 propagandë të tillë. Por nuk është ndërmarrë asnjë masë. Dhe
12 diku ka mesazhi i gushtit më është thënë që të shkoj të rregulloj
13 vijën furnizuese për nënzonën operative në të cilën unë isha
14 përcaktuar si komandant i nënzonës dhe të filloj të organizoj
15 dhe strukturoj nënzonën operative të Nerodimës.

16 PY. Kush të tha ty ta bëje këtë gjë?

17 PË. Edhe një herë të lutem.

18 PY. Kush ta tha për ta bërë këtë gjë?

19 PË. Në rregull. Unë kam qenë në Javor kur kam njoftuar se në
20 qoftë se mirret asnjë masë ndaj këtyre, do të thotë, që kam
21 pritur bukur gjatë, atëherë në koordinim me Ismet Jasharin i
22 cili ishte komandant i një njësitit gueril, kemi vendosur që të
23 shkojmë për në Shqipëri. Dhe e kemi njoftuar Jakup Krasniqin
24 se po udhëtojmë për në Shqipëri, atëherë na kanë thënë "Mirë.
25 Rregulloje dhe çështjen e furnizimit me armë dhe strukturën

1 aty".

2 Nëse nuk gaboj, ka qenë edhe Azem Syla, të cilin unë në
3 periudhën e korrikut kam supozuar, ashtu dhe flitej, se është
4 komandant i përgjithshëm.

5 PY. A keni marrë ndonjë urdhër lidhur me furnizimet edhe me
6 faktin që do të shkonit në Shqipëri?

7 PË. Jo, nuk kishte nevojë për ndonjë urdhër sepse unë isha
8 komandant i nënzonës dhe veç më është thënë që mund të shkosh
9 për Shqipëri që të rregullosh vijën e furnizimit dhe
10 strukturën sepse një pjesë e ushtarëve, eprorëve ishte dhe në
11 Shqipëri.

12 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më
13 thonë që ka një problem me transkriptin. Është në faqen 45,
14 rreshti 25. Dhe aty duhet të shkruhet:

15 "Azem Syla ishte aty."

16 Ndërkohë që në transkript thuhet që:

17 "Azem Syla nuk ishte aty."

18 A mund ta sqaroni pak këtë me dëshmitarin ju lutem?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj që
20 është e thjeshtë për ta sqaruar.

21 Z. Pace, ju lutem sqaroheni.

22 Z. PACE: [Përkthim]

23 PY. Dëshmitar, në një përgjigje që keni dhënë më përpara në
24 transkript thuhet që:

25 "Ne e informuam Jakup Krasniqin se po shkonim në

1 Shqipëri. Rast në të cilin ai na tha që, 'Rregulloni
2 gjithashtu edhe linjën e furnizimit të armëve dhe
3 strukturën.'"

4 Më poshtë në transkript thuhet:

5 "Azem Syla nuk ka qenë atje."

6 Cili është versioni i saktë Dëshmitar, që Azem Syla ka
7 qenë aty apo nuk ka qenë aty?

8 PË. Jo, unë e thashë Azem Syla ishte aty.

9 PY. Për të qenë i qartë, Azem Syla ishte aty, ku? Në Shqipëri
10 e keni fjalën?

11 PË. Jo, ishte bashkë me Jakup Krasniqin kur kam bisedu se po
12 shkoj për Shqipëri dhe e thashë që në atë kohë -- më falni,
13 Azem Sylën ka pas fjalë dhe unë kam supozuar se Azem Syla
14 është komandant i përgjithshëm, po asgjë zyrtare nuk ka pas në
15 atë kohë.

16 PY. Kjo ka ndodhur në gusht përsëri kur jeni takuar me Jakup
17 Krasniqin dhe Azem Sylën?

18 PË. Po, gushti ka qenë sepse në gusht unë kam udhëtu për në
19 Shqipëri.

20 PY. Thatë gjithashtu në një përgjigje tjetër që:

21 "... nuk ishte e nevojshme të merreshin urdhra se unë
22 isha komandant i nënzonës dhe mua thjesht më thanë që të
23 shkoja në Shqipëri që të trajtoja vijën e furnizimit dhe
24 strukturën."

25 A mund të na e sqaroni se kush të tha ty të shkoje në

1 Shqipëri që të mirreshe me linjën e furnizimit dhe me
2 strukturën?

3 PË. Si komandant nënzone e kam pas të drejtën me marr vendime
4 vetë. Dhe unë e kam njoftuar zëdhënësin e Ushtrisë Çlirimtare
5 të Kosovës për me njoftu Shtabin e Përgjithshëm se unë po
6 udhëtoj për në Shqipëri me synimet që të kontaktoj atje me një
7 pjesë të eprorëve që ishin në Shqipëri dhe për të rregullu
8 vijën e furnizimit. Kjo ka qenë forma në atë kohë sepse unë
9 kam qenë komandant i nënzonës i emërum, pavarësisht asaj
10 propagande që u zhvillu në atë kohë.

11 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se më
12 lejoni dua t'i tregoj një deklaratë të mëhershme dëshmitarit
13 sipas rregullës 143(2)(c).

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
15 Mund të vazhdoni.

16 Z. PACE: [Përkthim] Dua të paraqitet në ekran dokumenti
17 IT-03-66 P160-TR-ET dhe do lexoj nga faqja 61, rreshti 20 deri
18 në faqen 62, rreshti 2. Në shqip është dokument IT-03, faqja
19 66, rreshtat nga 10 deri në 24.

20 PY. Dëshmitar, ajo çfarë paraqitet tani në ekran janë
21 përgjigjet që ju keni dhënë në intervistën e 2003 për TPNJ-në.
22 Do të lexoj një pjesë të dëshmisë tuaj të përgjigjes që keni
23 dhënë dhe pastaj do ju bëj një pyetje.

24 "PË. Duhet të ketë qenë nga fillimi i gushtit ose në mes
25 të gushtit kur më ka urdhëruar Shtabi Qendror që të shkoj në

1 Shqipëri --

2 "Më kanë urdhëruar që të largohesha në Shqipëri u
3 ngarkova me detyrën për të konsoliduar nënzonës e Nerodimës
4 dhe që të zgjidhja çështjen e vijës së furnizimit."

5 A është e saktë kjo që sapo ju lexova, Dëshmitar?

6 PË. Kjo që duket është një deklaratë para hetuesve të
7 Tribunalit të Hagës të cilën unë e kam kontestuar në gjykimin
8 e z. Limaj për arsyet që i kam thënë në atë kohë gjatë
9 gjykimit.

10 PY. Unë po ju pyes në veçanti për dy përgjigjet që
11 regjistrohen këtu që keni dhënë ju, domethënë, në këtë
12 transkript. Ky është transkripti i asaj çfarë keni thënë. A
13 mund t'i thoni Trupit Gjykses që përgjigja që keni dhënë këtu
14 është e saktë që në mes të gushtit ju ka urdhëruar shtabi
15 kryesor që të shkonit në Shqipëri, a është e saktë kjo,
16 Dëshmitar?

17 PË. Jo, nuk ka pas urdhëresa ende në atë kohë sepse s'është
18 njof Shtabi i Përgjithshëm dhe kjo deklaratë që duket është
19 dhënë gjatë hetimeve që unë kam mund të gaboja.

20 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

21 PY. Dëshmitar, mesa dini ju çfarë roli apo çfarë rolesh ka
22 luajtur Fatmir Limaj në UÇK në vitin 1998?

23 PË. Po e kam -- e spjegova. Realisht unë e kam llogarit si
24 komandantin tim të parë edhe pse askush s'e ka emëruar si
25 komandant të njësisë, po e kam llogarit që komandantin tim të

1 parë për shkak se ai na ka përcjellë nga territori i Drenicës
2 deri në territorin e Llapushës, siç e quanim në atë kohë, do
3 të thotë, në Malishevë. Dhe Fatmir Limaj kam supozuar tërë
4 kohën se është anëtar i Shtabit të Përgjithshëm edhe ky
5 supozim ka ardhë dhe si pasojë se ai ka qenë i ndjekur dhe
6 nëse s'gaboje edhe i dënuar nga Serbia si ushtar i Ushtrisë
7 Çlirimtare të Kosovës para se të hynim në Kosovë.

8 Dhe kjo bindje sigurisht më ka shtyrë që të supozoj se ai
9 është anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. E më vonë është
10 kuptuar se nuk ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm a
11 periudha kur kanë fillu të kuptohet se kush janë anëtarë të
12 Shtabi i Përgjithshëm.

13 Fatmir Limaj ka qenë një nga kolegët e mi të luftës me të
14 cilin kam vepruar si njësite guerile po të një territori i
15 cili ka qenë bukur i gjanë. Unë periudhën më të madhe, do të
16 thotë, pavarësisht dëshirës për të qenë bashkë me Fatmirin dhe
17 me Agimin, po secili kishim territoret tona dhe ishim të
18 shpërndarë në territor. Fatmiri deri në periudhën e fund
19 korrikut, nëse s'gaboje, ka qenë në Kleçkë dhe kanë qenë me një
20 njësit aty në Kleçkë.

21 PY. Edhe një pyetje të fundit përpara se të shkojmë për
22 pushim. Mesa keni njohuri ju, Dëshmitar, a ka ndodhur
23 ndonjëherë gjatë 1998-s kur Fatmir Limaj ka qenë ndërmjetësi
24 midis jush dhe personave të tjerë në Shtabin e Përgjithshëm të
25 UÇK-së?

1 PË. Ka qenë një periudhë në të cilën Fatmir Limaj ka pas, apo
2 kështu jemi marrë vesh sepse s'ka pas, që Fatmir Limaj kur të
3 ka mundësi me më përcjellë mue deri në Drenicë, do të thotë,
4 me më përcjellë Fatmir Limaj. Dhe kjo ka qenë ajo pjesa e
5 përgjegjësisë që kam mendu që duhet ta ketë Fatmiri. Po
6 gjithmonë kjo ka qenë në marrëveshje me Fatmirin, ka qenë
7 marrëveshje me Agimin sesi të koordinohemi në raste se kemi
8 luftime të ashpra sepse ishim njësite guerile apo sapo kishim
9 filluar organizimin.

10 Dhe një periudhë, do të thotë, është menduar në këtë
11 formë. Por nuk kemi pas nevojë sepse në momentin kur është
12 dashur të kontaktoja në Drenicë me ndonjë që supozonim që
13 është anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, realisht, në korrik ka
14 dalë -- në qershor, më falni, në fund të qershorit ka dalë
15 zëdhënësi i Ushtrisë çlirimtare të Kosovës dhe nuk kemi pas
16 domosdoshmërinë për një punë të tillë.

17 Z. PACE: [Përkthim] Është momenti i përshtatshëm për të
18 bërë pushimin.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
20 bëjmë pushim gjysmë ore. Mund të largoheni nga salla së bashku
21 me asistenten. Ju lutem mos flisni me askënd lidhur me
22 dëshminë me dikënd jashtë sallës së gjyqit. Do shihemi përsëri
23 në sallë në orën 11.30.

24 DËSHMITARI: Faleminderit.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
2 pushim deri në orën 11.30.

3 --- Pauza fillon në orën 11.02

4 --- Seanca rifillon në orën 11.32

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace,
6 përpara se të vijojmë, dhe sa orë ju kanë ngelur?

7 Z. PACE: [Përkthim] Pak e vështirë t'ua them me saktësi,
8 po do më nevojitet e gjithë kjo seancë edhe seanca e pasdites,
9 madje ka mundësi të më nevojitet seanca nesër paradite,
10 sidoqoftë të jemi brenda nëntë orarëshit që kishim kërkuar.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e
12 numëruam, nuk e llogaritëm fare paraditen e djeshme, por po ju
13 pyes se duhet ta dijë dhe Njësia për Administrimin e
14 Dëshmitarëve për dëshmitarin rezervë që kemi për të enjten.

15 Z. PACE: [Përkthim] Nga vlerësimi që kemi bërë ne,
16 përfshirë kohën që kemi nevojë ne, kohën që ka kërkuar
17 Mbrojtja, përfshirë dhe Gjykatësit, besoj se nuk do të
18 përdoret dëshmitari rezervë për këtë javë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe unë në
20 fakt mendoj që është më mirë që dëshmitarin rezervë të mos e
21 kemi këtë javë.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua të them dhe unë diçka. Unë
23 kisha kërkuar dy orë, por unë këtë e kisha llogaritur kur
24 kisha menduar që do jepte dëshminë sipas rregullës 154, por ka
25 pasur zhvillime të reja, kështu që unë do kem nevojë për më

1 shumë se dy orë. Kështu që pajtohem dhe me Prokurorin që nuk
2 besoj që do kemi mundësi ta kemi dëshmitarin rezervë këtë
3 javë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe ne
5 kështu e kemi llogaritur.

6 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Ne kishim kërkuar katër
7 orë, ka mundësi që më pak do të përdor. Dy, dy orë e gjysmë,
8 për momentin.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
10 Do të ishte mirë që të paktën ta përfundonim këtë javë
11 dëshmitarin sepse do ketë shkëputje përndryshe. Nuk është
12 përfundimtare, por do e parapëlqenim diçka të tillë. Urojmë që
13 të ndodhë kështu.

14 Në rregull. Tani mund të sillni dëshmitarin.

15 Z. ROBERTS: [Përkthim] A mund të bëj një kërkesë, ju
16 lutem? E di që kemi një javë shkëputje përpara se të fillojmë
17 me dëshmitarët e radhës. Si rregull, brenda të enjtes
18 Prokuroria na jep një listë. A ka mundësi të na japin nesër
19 listën e dëshmitarëve të radhës, se do na ndihmonte shumë me
20 përgatitjen duke marrë parasysh që vetëm një javë kemi pushim
21 këtë radhë.

22 [Dëshmitari vijon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është e
24 mundshme?

25 Z. PACE: [Përkthim] Do të pyes dhe do t'ju them.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
2 pyesni dhe na thoni.

3 Mirë, z. Buja. Do vazhdojmë me pyetjet e Prokurorisë.
4 Dëgjojini me vëmendje.

5 Z. Pace, fjala është për ju.

6 Z. PACE: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, sot na treguat për ristrukturimin e nënzoneve
8 në zona operative, dhe se kjo ka ndodhur dikund nga tetori i
9 1998, dhe se organizimi është bërë i qartë pas kthimit tuaj në
10 Kosovë dhe kishte një shef shtabi, që na thatë se ishte Bislim
11 Zyrapi, dhe se ai ishte përgjegjës për kontaktet dhe
12 urdhëresat ndaj komandantëve të zonave.

13 Tani, a mund të na thoni pse u mor vendimi për t'i kthyer
14 nënzonat në zona?

15 PË. Po ka qenë një ndryshim politik fillimisht, sepse në
16 fillim ne si Ushtri Çlirimtare e Kosovës kemi pas synime
17 çlirimin e territoreve të pushtuara të Shqipërisë. Pas disa
18 kontakteve me politikanë ndërkombëtarë, është marrë një
19 qëndrim që të mos shkaktojmë një luftë ballkanike apo edhe të
20 marrë përmasa edhe më të mëdha. Dhe pjesa politike e Ushtrisë
21 Çlirimtare të Kosovës ka sugjeru që qëllimi i çlirimit tonë si
22 Ushtri Çlirimtare e Kosovës të jetë Kosova në kufijtë
23 administrativë që janë njoft në atë kohë, dhe meqë Kosova
24 bëhej vetëm një zonë, atëherë -- më fal, bëhej territor, i
25 cili do të çlirohej, nënzonat kaluan në emërtimin e zonave dhe

1 u ndanë në zona operative.

2 Pra, ishte një ndryshim politik fillimisht, pastaj edhe
3 ushtarak.

4 PY. Zona e Nerodimës, kishte të njëjtën zonë përgjegjësie që
5 kishin pasur më parë nënzonat e Nerodimës?

6 PË. Po e sqarova më herët se si nënzonë nuk kemi pas qartësi
7 e territorit të cilin e kemi në përgjegjësi, ndërsa si zona
8 është qartësuar shumë më mirë, dhe si zona kemi pas nga gryka
9 e Carralevës deri në kufi me Maqedoninë.

10 PY. Me përfaqësi, sa ushtarë të UÇK-së kishte zona juaj kur u
11 kthye në një zonë operative?

12 PË. Si zonë operative, ka variu numri sepse fillet e saj ka
13 pas shumë pak ushtarë. Në kohën e riorganizimit kemi pas dy
14 brigada të cilat kanë qenë të lehta. Në kuptimin operativ,
15 sepse nuk kanë pas shumë ushtarë, kanë pas diku rreth 700 deri
16 në 800 ushtarë në brigadë. Edhe në përfundim të luftës, është
17 zgjeruar me katër brigada të cilat kanë pas po ashtu numër të
18 lehtë të ushtarëve, por përfaqësisht rreth 3000 ushtarë. Në
19 fund të luftës.

20 PY. Me sa dini ju, zonat e tjera operative a kishin më pak a
21 më shumë ushtarë se sa zona juaj?

22 PË. Po, ka pas zona që kanë qenë më të mëdha se sa zona
23 operative e Nerodimës, por ka pas edhe zona të cilat kanë pas
24 më pak ushtarë, apo më të vogël.

25 PY. A të kujtohen zonat më të mëdha, cilat ishin?

1 PË. Po zonat ma të mëdha kanë qenë zona e Pashtrikut, edhe
2 zona e Drenicës.

3 PY. Keni pasur zëvendës kur ishit komandant zone?

4 PË. Po, kam pas zëvendës.

5 PY. Kush ishte?

6 PË. Ishte Imri Ilazi që njifej me nofkën komandant Fehri.

7 PY. Ai ishte zëvendësi juaj deri në fund të luftës?

8 PË. Po, deri në fund të luftës.

9 PY. A ju kujtohet kush ishin, domethënë, kush ishte në
10 pozicionet e tjera brenda zonës operative të Nerodimës, në
11 organigramë, kush ishte, kush i mbulonte pozicionet e tjera?

12 PË. Po. Pas zëvendëskomandantit ishte shefi i shtabit, apo
13 shefi i shtabit të zonës operative të Nerodimës. Pastaj kishim
14 sektorët, apo G-të, të cilat ishin të emëruar shefat e
15 sektorëve, edhe në një periudhë kemi pas dy brigada, e në fund
16 të luftës janë përcaktuar katër brigada dhe pse numri i
17 ushtarëve ka qenë i vogël për të lehtësuar gjithë strukturën e
18 katër brigadave.

19 PY. Fillojmë me shefin e shtabit, kush ka qenë shef shtabi?

20 PË. Shef shtabi ka qenë Hysen Shahini, i cili ka ardh nga
21 Shqipëria. Ka qenë pjesë e forcave të organizuara nga ish-
22 kryeministri në atë kohë që quhej z. Bujar Bukoshi.

23 PY. A të kujtohet kur e ka marrë rolin Hysen Shahini si shef
24 shtabi i zonës së Nerodimës?

25 PË. Nëse nuk gabo, në nëntor apo në dhjetor të 1998-s.

1 PY. Ti the që ka pasur dhe shef sektori. Ju lutem, na thoni
2 fillimisht çfarë sektorësh ishin dhe kush i mbulonte secilin
3 sektor?

4 PË. Po ishte sektori i personelit, të cilin fillimisht e ka
5 udhëheq një epror me emrin, me mbiemrin Hajrullahu. Më vonë
6 është emëruar Naim Imeri. Sektori i dytë ka qenë sektori i
7 zbulimit edhe kundërzbulimit që e ka mbuluar Elmi Reqica. Ka
8 qenë sektori i logjistikës, në kuadër të të cilit ka qenë edhe
9 spitali ushtarak, të cilin e ka mbuluar po ashtu një epror me
10 mbiemrin Hajrullahu. Sektorin e ndërlidhjes të cilin e ka
11 mbuluar, i njoftur me pseudonimin Rrapi, Ekrem Metushi.
12 Sektorin për politikë dhe moral e ka mbulu z. Fehmi Mujota një
13 periudhë. Dhe sektorin për ndërlidhje me popullatën civile, e
14 ka udhëhequr z. Ruzhdi Jashari.

15 PY. Përmende dy persona me mbiemrin Hajrullahu. Një ishte i
16 drejtorisë kadrovike. Si e kishte emrin ky Hajrullahu i
17 drejtorisë kadrovike?

18 PË. Nuk është tu mu kujtu, ndërsa sektorin e logjistikës emri
19 i tij ka qenë Fehmi, Fehmi Hajrullahu.

20 PY. Personat që përmende, the te drejtoria kadrovike ishte
21 Hajrullahu dhe një person tjetër. Po sa u takon shefave të
22 sektorëve, këta shefa sektorësh ishin që nga fillimi i
23 krijimit të zonës e deri në fund, apo pati ndryshime ndërkohë?

24 PË. Nga tetori, dikund apo nga fillimi i nëntorit, kanë qenë
25 këta shefa të sektorëve, por ka pas ndryshime. Në sektorin e

1 personelit ka pas ndryshime, sepse z. Hajrullahu ka kalu në
2 sektorin -- në kuadër të zyrës së komandantit të zonës, zyrën
3 ligjore si është qujt, ndërsa është emëru z. Naim Imeri. Në
4 sektorin për politikë dhe moral nëse nuk gaboj është ndërru,
5 ka qenë Fehmi Mujota, është ndërru me Ruzhdi Jashari. Dhe
6 Ruzhdi Jashari ka marrë dhe rolin e zëdhënësit, të një farë
7 forme, të zonës operative të Nerodimës.

8 PY. Ka pasur njësi të policisë ushtarake apo ndonjë kompani
9 të policisë ushtarake në zonën operative të Nerodimës?

10 PË. Po, ka qenë kompania e policisë ushtarake deri në fund të
11 luftës. Në fund të luftës, ka kalu në batalion të policisë
12 ushtarake.

13 PY. Kush ishte përgjegjës -- kush ishte fillimisht përgjegjës
14 për këtë kompaninë?

15 PË. Komandant i kompanisë së policisë ushtarake ka qenë Isak
16 Musliu.

17 PY. Kishte ndonjë nofkë a pseudonim asokohe?

18 PË. Po, komandant Çerçizi.

19 PY. Ishte deri në fund të luftës në këtë pozicion?

20 PË. Po, me sa më kujtohet, po, deri në fund të luftës.

21 PY. Më falni, se mbase e keni thënë emrin dhe unë s'e
22 dëgjova. Po Daut Ilazi, ka qenë pjesë e shtabit tuaj?

23 PË. Jo, sa kam qenë unë. Ka qenë në pjesën e parë të
24 luftimeve në Jezercë, që njihet si epopeja e Jezercit. Ka qenë
25 Daut Ilazi si pjesë e strukturave në Jezercë.

1 PY. Për cilën periudhë kohore kanë qenë luftimet e Jezercës?

2 PË. Flas për shtatorin e 1998, ku dhe është plagos dhe është
3 deportuar në Shqipëri.

4 PY. Flasim për dy brigadat. Thatë që ka pasur dy brigada. A
5 mund të na thoni emrat e komandantëve të secilës prej
6 brigadave?

7 PË. Po, Brigada 161 ka pas për komandant Ahmet Kaçikun,
8 ndërsa Brigada 162 ka pas për komandant Qamil Ilazin.

9 PY. Ahmet Kaçiku ka qenë brigadë -- komandant i Brigadës 161
10 deri në fund apo pati ndryshim?

11 PË. Edhe një herë se s'e kuptova.

12 PY. Sa kohë ishte Ahmet Kaçiku komandant i Brigadës 161? Deri
13 në fund apo u ndryshua në ndonjë moment?

14 PË. Komandant Ahmet Kaçiku ka qenë komandant i brigadës deri
15 në ramjen e tij në fushëbetejë, ramjes të tij dëshmor në janar
16 të 1999-s.

17 PY. E zëvendësoi ndonjë person tjetër atëherë si komandant
18 brigade në këtë moment?

19 PË. Po. Është zëvendësuar nga Komandant Graniti, apo siç, me
20 emër e mbiemër, nëse s'gaboje është Ilmi Ramusholli.

21 PY. The që komandanti i 162 ishte Qamil Ilazi. Dhe për këtë,
22 kam të njëjtën pyetje, a ishte ai komandant brigade deri në
23 fund të luftës?

24 PË. Qamil Ilazi ishte po ashtu komandant brigade deri në
25 ramjen e tij në fushëbetejë në Kaçanik, në ofensivën e fundit.

1 Deri në atë kohë ishte komandant i brigadës.

2 PY. Në cilën ofensivë ka rënë?

3 PË. Në ofensivën e majit të -- nëse nuk gaboj, prillit ose
4 majit të 1999.

5 PY. Që të jemi të qartë, përpara Qamil Ilazit, ka pasur
6 ndonjë komandant tjetër Brigada 162?

7 PË. Komandant brigade nuk ka pasur, por ka pas komandant të
8 njësitit për Kaçanik, i cili ka qenë Agim Bajrami.

9 PY. Qamil Ilazi a kishte ndonjë emër tjetër, a ndonjë nofkë a
10 pseudonim?

11 PË. Po, Qamil Ilazin e thirrnim komandant Bardhi për shkak të
12 thinjave të tij në flokë, i kishte flokët e zbardhura dhe
13 nofka e tij ishte komandant Bardhi.

14 PY. Po Rafi Sejdiun, e njihni?

15 PË. Edhe një herë, se si emër, ose është thënë gabim ose ...

16 PY. Mbase e kam shqiptuar gabim. Rafiz Sejdiu.

17 PË. Po. Ka qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare në zonën
18 operative të Nerodimës.

19 PY. Çfarë roli kishte ai në zonë, të kujtohet?

20 PË. Nuk më kujtohet roli i tij, por tani është kryetari
21 organizatës së veteranëve në Ferizaj.

22 PY. A të kujtohet, a ka qenë pjesë e shtabit të zonës, apo ka
23 qenë pjesë e ndonjë brigade?

24 PË. Nuk besoj që ka qenë pjesë e shtabit të zonës, ka mundur
25 të jetë pjesë e njësiteve të Brigadës 161, të Ahmet Kaçikut.

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 65

1 PY. A kishte ndonjë nofkë apo pseudonim në atë periudhë, në
2 1998-1999?

3 PË. Në 1999, nuk di që ka pas nofkë Rafiz Sejdiu.

4 PY. Po Inxhinieri, ke dëgjuar t'i thërrasin ndonjëherë?
5 Inxhinieri.

6 PË. Po, e kanë thirr ndonjëherë Inxhinieri, sepse ka qenë me
7 profesion inxhinier.

8 PY. A të kujtohet nga cili fshat vinte?

9 PË. Jo, nuk më kujtohet.

10 PY. Po nga cila komunë?

11 PË. Po, komuna e Ferizajt.

12 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem të vendosni në ekran provën
13 P01508, dhe P01508-ET, përbri njëri-tjetrës. Është një
14 dokument vetëm me një faqe.

15 PY. Dëshmitar, në ekran keni dy dokumente, në anglisht dhe në
16 shqip. Në të majtë të ekranit. E njihni këtë dokument?
17 Dokumentin që është në shqip?

18 PË. Po më duket si gazetë.

19 PY. Si kush të duket ky personi në fotografi?

20 PË. Në fotografi jam unë.

21 Z. PACE: [Përkthim] Domethënë, në fakt, i lutem
22 Sekretarisë ta zmadhojmë pak dokumentin.

23 PY. Kjo është gazeta Zëri i Kosovës, data 1 tetor 1998.

24 Z. PACE: [Përkthim] Do lexoj nga pyetja dhe përgjigjja e
25 tretë. Në shqip është kolona e dytë dhe kalon pastaj në

1 kolonën e tretë. Në shqip, ju lutem, në krye të faqes.

2 PY. Përpara se ta lexoj, Dëshmitar, a ju kujtohet që t'i keni
3 dhënë ndonjë intervistë Zërit të Kosovës në periudhën kur
4 është botuar ky artikull në 1998?

5 PË. Jo, s'më kujtohet.

6 PY. Po ju lexoj pyetjet dhe përgjigjet dhe pastaj kam unë një
7 pyetje për ju:

8 "Zëri i Kosovës: Fillimisht UÇK-ja njihej për njësitet e
9 veta. Kurse sot flitet për nivele më të larta organizimi.
10 Çfarë e ndikoi këtë organizim? Çfarë e influençoi këtë
11 organizim?

12 "Komandant Sokoli: Në fillim UÇK-ja filloi me grupe të
13 vogla guerile, sepse operonte në rrethana më të vështira dhe
14 të ndryshme. Sepse edhe okupatori edhe njerëzit tanë na
15 akuzonin si persona që ishim në shërbim të shërbimit sekret
16 serb, Arkanit. Na thërrisnin terroristë e çka të tjera.

17 "Sidoqoftë, pas daljes publike të ushtarëve të UÇK-së
18 gjatë varrimit të mësuesit Halit Geci dhe ofensivës dhe
19 masakrës serbe në Prekaz -- më falni, rrethanat ndryshuan.
20 Njerëzit filluan ta shihnin më qartë. Ne mbështet -- filloi
21 përkrahjen për UÇK-në edhe përmes protestave, paraqitjeve, për
22 kyçjen në radhët e ushtrisë, për ta ndihmuar atë, strehuar
23 ushtarë e të tjerë. Këto bënë që të rritej UÇK-ja me një
24 shpejtësi që as ne nuk e kishim parashikuar.

25 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës pas zgjerimit të saj filloi

1 të mendojë krahas luftimeve edhe për një organizim të ri të
2 cilin e kërkonte momenti. Pra, u bë një organizim i rregullt
3 ushtarak duke filluar nga skuadra, togu, kompania, batalioni,
4 brigada e të tjerë.”

5 Dëshmitar, a ju kujtohet t'ia keni thënë këto Zërit të
6 Kosovës?

7 PË. Jo, s'më kujtohet. Por keni parasysh që këto deklarime
8 kanë mujt me qenë deklarime për të bërë një propagandë më të
9 fuqishme se jemi të organizuar, jemi të fuqishëm e të tjerë.
10 Në çdo luftë ushtritë nuk pranojnë se kanë shumë humbje, por
11 gjithmonë i ekzagjerojnë fitoret e veta. Dhe gjithë, edhe ne
12 si Ushtri Çlirimtare e Kosovës jemi munduar që t'i japim zë ma
13 shumë se sa që kemi pas forcën, ushtrisë tonë, sepse ka pas
14 nevojë për propagandë ma të fuqishme.

15 PY. Po, dakord. Ne thamë që në këtë artikull është fotografia
16 jua. Shohim dhe përgjigjet, janë përgjigjet e një komandant
17 Sokoli. Jeni ju ky?

18 PË. Në fotografi jam unë, por intervista s'po më kujtohet.

19 PY. Po. Por, më duket se na the që Sokoli ka qenë një prej
20 pseudonimeve që keni pas gjatë luftës, apo jo?

21 PË. Kam pas edhe pseudonime Sokoli, edhe pseudonime të tjera,
22 siç ka qenë pseudonimi Gazetari. Por shumicën e kohës unë kam
23 qenë me emër e mbiemër. Sidomos në periudhën që po shkruhet
24 këtu në Zërit të Kosovës, unë kam qenë me emër e mbiemër.

25 PY. Zëri i Kosovës është gazeta ku keni qenë ju në redaksi,

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 68

1 apo jo? Keni qenë në redaksinë e kësaj gazete?

2 PË. Po, por jo në këtë periudhë. Kam punuar një vit ma herët.

3 PY. Nga sa dini ju, duke e njohur si gazetë ata nuk do të të
4 -- nuk do të të nxirrnin fjalë të pasakta tuajat.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

7 DËSHMITARI: Po, fjalë të pasakta ka mujt me nxjerrë sepse
8 ne kemi bërë propagandë edhe në kohën kur unë kam qenë në
9 redaksi, kemi bërë propagandë në shërbim të Ushtrisë
10 Çlirimtare të Kosovës. Por aty ka mujt ta nxjerr një deklaram
11 i cili ka mujt të ekzagjerohet nga anëtari i redaksisë ose
12 anëtarët e redaksisë.

13 Z. PACE: [Përkthim]

14 PY. Të jemi të qartë, po thoni që dikush mund t'i përdorte
15 fjalët si propagandë dhe këto i botonte gazeta Zëri, a po
16 përpiqesh të thuash diçka tjetër?

17 PË. Po, kanë mujt me i përdor, i nderuar Prokuror. Kanë mujt
18 me e përdor dhe me nxjerr një artikull i cili ka qenë në
19 shërbim të luftës dhe të propagandës pro luftës.

20 PY. Me sa dini ju, dhe sipas përvojës që keni pasur si pjesë
21 e bordit editorial të Zërit të Kosovës, ata, domethënë, në
22 Zërin e Kosovës, pavarësisht nëse bëhej fjalë për propagandë
23 apo jo, edhe në qoftë se ti nuk e thojë fjalë të caktuara, ata
24 prapë se prapë do t'ju botonin, si mendoni, qëndronte kështu,
25 apo jo?

1 PË. Nuk e kuptova drejt se po më kërcet ndëgjuesja.

2 PY. Nuk ka problem, po ta përsëris dhe një herë. Thatë që
3 keni qenë pjesë e bordit editorial të Zërit të Kosovës,
4 përpara tetorit të 1998-s. A është e saktë kjo?

5 PË. Po.

6 PY. Mbështetur në atë çfarë di ti, dhe duke marrë parasysh
7 përfshirjen tuaj me Zërin e Kosovës, juve a mendoni që Zëri i
8 Kosovës do bonte një artikull ku thoshte që komandant Sokoli
9 ka thënë "X" gjë, ndërkohë që komandant Sokoli nuk e kishte
10 thënë atë gjë? A mund ta bënte diçka të tillë Zëri i Kosovës,
11 Dëshmitar?

12 PË. Po kryesisht neve na kanë ardh shkrimet me pseudonime
13 edhe në Zërin e Kosovës janë botue me pseudonime. Kështu ka
14 qenë politika e redaksisë së Zërit të Kosovës, dhe ne i kemi
15 botuar me pseudonime. Flas për periudhën kur unë kam qenë në
16 redaksi.

17 PY. Do të vazhdoj që të lexoj nga pjesa tjetër e pyetjeve dhe
18 përgjigjeve:

19 "Zëri i Kosovës: Përderisa përmendët brigadën, a keni
20 dëgjuar për Brigadën -- 131?

21 "Komandant Sokoli: Po. Kam dëgjuar nga drejtorja
22 informative e ministrisë së mbrojtjes. Një ministri që e ka
23 selinë diku në Hënë dhe drejtorinë e saj diku në ndonjë
24 satelit.

25 "Të them të vërtetën, tendencat e 'institucionalistëve'

1 nuk kanë pushuar dhe pas deklarimeve të kryetarit të tyre se
2 nuk ekziston forcat e 'FARK-ut' dhe se 'FARK-u' ka qenë
3 krijesë serbe. Ata vepronin si 'FARK' përmes një shtabi të
4 vendosur diku në Shqipëri duke marrë direktiva për t'u futur
5 kontrabandë nën uniformën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që
6 ta dëmtojnë atë dhe luftën e popullit tonë për liri. Tendencat
7 e tilla dalin në shesh sidomos gjatë ofensivës së pushtuesit
8 serb. Brigada apo komandanti i Zonës 3, siç ka dëshirë ta
9 quajë veten Tahir Zemaj, një ish-i burgosur ordiner, ish-major
10 i KOS-it, njeriu që ka komanduar operacionin për vrasjen e
11 Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës, do të marrë përgjegje për të
12 gjitha ato që ka bërë dhe i bën, ashtu siç paralajmërohet edhe
13 në komunikatën numër 53 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të
14 cilën mjetet e informimit publik e censuruan ose nuk e botuan
15 fare, që nuk është hera e parë, duke i bërë shërbim të mirë
16 pikërisht këtyre tendencave."

17 A ju kujtohet t'ia keni dhënë këtë informacion Zërit të
18 Kosovës, ndonjëherë, dëshmitar?

19 Z. HODAJ: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës,
20 besoj që dëshmitari duhet që të informohet për parashikimet e
21 rregullës 151 përpara se sa t'i përgjigjet kësaj pyetjeje.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
23 çaktivizuar]. Thojeni dhe një herë, Avokat.

24 Z. HODAJ: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
25 Dëshmitari duhet që të informohet për të drejtat që

1 parashikohen sipas rregullës 151 përpara se sa t'i përgjigjet
2 pyetjes së bërë nga Prokurori. Thjesht për ta informuar atë
3 lidhur me të drejtat e tij. E kundërshtoj pyetjen dhe në emër
4 të klientit dua që të informohet ai.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kujtuam atë
6 lidhur me të drejtat që ka që në fillim të ditës.

7 Z. HODAJ: [Përkthim] Në rregull. Megjithatë, mendoj që
8 duhet të informohet përsëri dhe të kujtohet për të drejtat që
9 ka. Faleminderit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
11 vazhdoni.

12 Z. PACE: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, ju pyeta në qoftë se këtë informacion ia keni
14 dhënë në një kohë të caktuar Zërit të Kosovës apo jo?

15 PË. Nuk më kujtohet që i kam dhanë një informacion të tillë.

16 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

17 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet një armëpushim rreth tetorit ose
18 nëntorit të vitit 1998?

19 PË. Jo, s'më kujtohet.

20 PY. A ju kujtohet të keni marrë ndonjë urdhër apo udhëzim për
21 të mos shkuar në luftime në 1998, në tetor ose nëntor të 1998?
22 Për të mos vazhduar luftimet?

23 PË. Nuk e kuptova pyetjen.

24 PY. Në tetor ose në nëntor të 1998, a ju kujtohet që ka
25 ndodhur ndonjë moment kur dikush të ka thënë që të ndalosh

1 luftimet?

2 PË. Nuk po më kujtohet.

3 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se më
4 lejoni, në pajtim me rregullin 142, 143(2)(c) [Sipas
5 përkthimit] kërkoj që t'i referohem një deklaratë të mëhershme
6 të dëshmitarit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

8 Z. PACE: [Përkthim] Për këtë kërkoj që të paraqitet në
9 ekran dokumenti SITF00223935-00223961, do të vazhdojmë nga
10 paragrafi i parafundit në faqen që përfundon me 223944 deri në
11 fundin e paragrafit të dytë në faqen vijuese. Në versionin në
12 shqip numri ERN i dokumentit është e njëjta, dhe referenca e
13 faqes është e njëjta siç ishte në versionin në anglisht.

14 PY. Dëshmitar, në këtë rast, në të majtë do të kesh
15 dokumentin në shqip dhe në të djathtë dokumentin në anglisht.
16 Këto janë dokumente që ju, që lidhen me dëshminë që keni dhënë
17 në 2001 në TPNJ. Jua lexuam dhe dje, megjithatë do lexoj një
18 pjesë të asaj çfarë keni thënë aty dhe pastaj do ju bëj disa
19 pyetje. E qartë?

20 "Ata i mbajtën këto pozicione deri në armëpushimin e
21 fillimit të nëntorit 1998, pastaj u kthyen te repartet e veta.
22 Ne u angazhuam të mos e sulmonim njëri-tjetrin. Marrëveshja
23 ishte që të mos bëhej ndonjë lëvizje nga VJ-ja apo UÇK-ja.
24 Serbët e përdorën këtë kohë për t'u pozicionuar, veçanërisht
25 përgjatë grykës së Caralevës, që do të thotë se armëpushimi u

1 prish. Ne ia dhamë të gjitha pozicionet OSBE-së veçanërisht në
2 zonën e Nerodimës, sepse këtu ata i kishin përdorur pozicionet
3 për të sulmuar Reçakun. Këto pozicione të reja ata i morën
4 diku nga fundi i dhjetorit.

5 "Gjatë kësaj kohe, 36 nga afro 100 ushtarë të UÇK-së u
6 vranë, ndërkohë që të tjerët u kapën në zonën e Pashtrikut. Në
7 këtë numër përfshihen edhe tre nga zona e Nerodimës. E gjithë
8 kjo ndodhi gjatë armëpushimit. Unë e di këtë gjë sepse ka
9 pasur persona të cilët kanë mbijetuar që më kanë treguar se
10 çfarë kishte ndodhur. Serbët i qëlluan në një pritë në
11 rrethinat e Prizrenit sepse po importonin armët nga Shqipëria.
12 Serbët morën një pjesë të madhe të armëve. Grupi i parë kishte
13 një pararojë dhe të tjerët ishin në grupe të vogla e jo shumë
14 larg njëri-tjetrit. Ishte errësirë dhe ata ishin në këmbë duke
15 transportuar armë. Në marrëveshje thuhej se nuk mund të
16 lëviznim nga pozicionet tona apo të hynim në konflikt të
17 armatosur. Por aty nuk thuhej asgjë që të mos armatoseshim. Ne
18 kishim të drejtën e vetëmbrojtjes.

19 "Të shoqëruar nga OSBE-ja serbët mund të lëviznin nga
20 vendi në vend por jo të zinin pozicione. Ne kishim urdhër nga
21 shtabi qendror i UÇK-së për të mos e prishur marrëveshjen,
22 sepse ne besonim se e ardhmja e Kosovës mund të avanconte dhe
23 se situata mund të zgjidhej përmes dialogut. Nuk pati ndonjë
24 hakmarrje për 36 ushtarët e vrarë të UÇK-së."

25 Dëshmitar, a e është e saktë kjo që sapo ju lexova?

1 PË. Po, edhe pse në një vend po e shoh që është një gabim. Në
2 atë kohë s'ka pas Shtab Qendror por Shtabi i Përgjithshëm i
3 UÇK-së.

4 PY. Dëshmitar, për të qenë i qartë, në shqip thuhet që neve
5 kemi marrë urdhër nga Shtabi Qendror i UÇK-së për të mos e
6 prishur marrëveshjen. A ka ndonjë gjë që doni të sqaroni apo
7 të korrigjoni lidhur me këtë?

8 PË. Po, ne kemi pasur urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm që të
9 mos ketë luftime, që të mos i sulmojmë forcat, të respektojmë
10 marrëveshjen Holbrooke-Milloshëviq.

11 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin nga ekrani.

12 PY. Dëshmitar, përpara pak çastesh na thatë që Isak Musliu,
13 Çerçizi, ishte komandant në zonën e Nerodimës, a është e saktë
14 kjo? Pra komandant i policisë ushtarake.

15 PË. Po, ishte -- po ishte komandant i kompanisë së policisë
16 ushtarake.

17 Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj t'i kërkoj Sekretares të
18 paraqesë në ekran tani dokumentin U017-3163-U017-3194.

19 Versioni në anglisht ka të njëjtin numër ERN, por përfundon me
20 ET në fund. Ju lutem shikojmë faqen e parë. Faleminderit. Ju
21 lutem zmadhoni dhe tekstin në -- zvogëlioni tekstin dhe në
22 shqip, në mënyrë që të shikoni dhe kokën.

23 PY. Dëshmitar, në të majtë keni një dokument në shqip dhe në
24 të djathtë një dokument në anglisht.

25 Z. PACE: [Përkthim] Tani do ju kërkoja Sekretares që ta

1 zmadhojë tekstin në mënyrë që ta lexojmë sa më lehtë.

2 Faleminderit.

3 PY. Dëshmitar, do t'ju jap një minutë që të shikoni
4 dokumentin që keni në ekran, në të majtë të ekranit. A e dini
5 në qoftë se e keni parë këtë dokument më përpara, Dëshmitar?

6 PË. Nuk e kam pa këtë dokument. Së paku s'më kujtohet.

7 PY. Mund ta shohim që flitet për një kërkesë të kompanisë së
8 policisë ushtarake nga Çerçizi ku thuhet si më poshtë:

9 "Pra, duhet që policia ushtarake të ketë një depo për
10 nevojat e veta, dhe thuhet që gjithashtu pretendohet që të
11 bëhet një zgjidhje e tillë në përputhje me rregullat e Shtabit
12 të Përgjithshëm."

13 A ju kujtohet ndonjë urdhër, apo ndonjë kërkesë që ka të
14 bëjë me një depo, Dëshmitar?

15 PË. Nuk po më kujtohet si kërkesë.

16 PY. Për të qenë të qartë, ajo çfarë po ju pyes është që në
17 qoftë se ju kujtohet diçka që përmendet në këtë kërkesë, që
18 është një urdhër nga zona e Nerodimës, për të mbyllur një
19 depo? A ju kujtohet kjo?

20 PË. Nuk po më kujtohet, por ne kemi pas shumë kërkesa dhe nga
21 policia ushtarake, dhe nga brigadat, sepse kemi pas mungesë të
22 madhe të municionit dhe armatimit, madje kemi pas edhe mungesë
23 të uniformave ushtarake. Kemi pas dhe mungesë të ushqimeve,
24 edhe ka pas kërkesa të cilat i janë drejtuar sektorëve të
25 zonës operative të Nerodimës.

1 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani,
2 dhe në vend të tij do kërkoja që të paraqitet dokumenti
3 P00784. Të shohim faqen e parë të këtij dokumenti.
4 Faleminderit.

5 PY. Në ekran keni një fotografi, Dëshmitar. A mund të na
6 thoni në qoftë se e njihni këtë fotografi?

7 PË. Po, e njof si foto.

8 PY. A mund të na thoni se kush është në këtë fotografi dhe me
9 ç'rast është bërë kjo fotografi?

10 PË. Në fotografi jam unë, është Fatmir Limaj dhe z. Hashim
11 Thaçi. Ndërsa personat të tjerë nuk po i njoh. Kohën kur është
12 bërë nuk e di.

13 PY. Për të qenë të qartë, ju jeni personi i parë në të majtë
14 në fotografi?

15 PË. Po.

16 PY. Po ngjitur me ty, është Fatmir Limaj?

17 PË. Kështu po më duket, sepse qenka me syze dhe pak problem
18 me e identifiku.

19 Z. PACE: [Përkthim] Mbase mund ta zmadhojmë pak
20 fotografinë. Faleminderit.

21 PY. Pastaj përmendët Hashim Thaçin. Hashim Thaçi është
22 personi që është ngjitur me këtë personin tjetër që mund të
23 jetë Fatmir Limaj?

24 PË. Kështu po duket, edhe pse fotografia është bukur e dobët,
25 por duket se është Hashim Thaçi.

1 PY. Pra, ky është personi i tretë nga e majta, kështu?

2 PË. Po.

3 PY. A keni ndonjë ide se ku është bërë kjo fotografi, apo në
4 çfarë kohe është bërë ajo?

5 PË. Jo, nuk kam ide se ku është.

6 PY. Nuk pyeta se kush e ka bërë fotografinë, por po pyesja në
7 çfarë vendi është bërë fotografia, ose në çfarë kohe është
8 bërë fotografia.

9 PË. Po e thashë që nuk kam idenë se ku është bërë, dhe në
10 cilën kohë është bërë. Nuk po mund ta kujtoj.

11 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se më
12 lejoni, kërkoj që t'i paraqes dëshmitarit një deklaratë të
13 mëhershme të tij sipas rregullës 143(2)(b) dhe (c).

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

15 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin që kemi në
16 ekran dhe në vend të tij të paraqesim dokumentin IT-03-66
17 P160a-TR-ET. Do të lexojmë nga faqja 42, rreshti 16 deri në
18 faqen 44, rreshti 7. Në versionin në shqip dokumenti mban të
19 njëjtin ERN, por në vend të ET është AT, dhe do lexojmë nga
20 rreshti 1 në faqen 43 deri në rreshtin 16 në faqen 44.

21 PY. Dëshmitar, kjo është pjesë e deklaratës që keni dhënë ju
22 në vitin 2003. Do të lexoj disa pyetje dhe përgjigje dhe
23 pastaj do t'ju bëj një pyetje. Atëherë, këtu bëhet, domethënë
24 ju është bërë juve pyetje lidhur me të njëjtin dokument që ju
25 bëra unë pak pyetje më herët, pra është kjo fotografia që ju

1 patë më përpara:

2 "Dua t'ju tregoj disa fotografi.

3 "Personi ose fotografia është e numërtuar U0033239.

4 "A e mbani mend se ku është bërë kjo foto?

5 Ju përgjigjeni si më poshtë:

6 "Jo, nuk e mbaj mend. Nuk e di se në çfarë rrethanash

7 është bërë kjo fotografi. Është bërë sigurisht ose në Shtabi i

8 Përgjithshëm ose në vizitën që kanë bërë disa anëtarë të

9 Shtabi i Përgjithshëm në zonën time.

10 "PË. Unë kam pas mjekër, nuk e kam pas si komandant

11 zone.

12 "PY. Pra, ju thoni këtu që mund të ketë qenë në shtab

13 apo jo? Ose apo në Krojmirë -- është bërë në Krojmirë?

14 Ju thoni:

15 "PË. Jo, kjo s'mund të jetë në Krojmirë, s'mund të jetë

16 në Krojmirë kjo. Mund të jetë një periudhë, do të thotë, pas

17 nëntorit, pra të 1998, ose në atë periudhë kur dhe unë jam

18 kthyer nga Shqipëri."

19 Pastaj vazhdon me deklaratën tuaj që ju identifikoni të

20 njëjtët persona që identifikuat dhe sot.

21 Ju thoni këtu që fotografia është bërë në Shtabin Qendror

22 ose gjatë vizitës që anëtarët e Shtabit Qendror ose Shtabit të

23 Përgjithshëm ju kanë bërë juve. A është përshkrim i saktë ky?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] E kundërshtoj pyetjen e

25 Prokurorit, kërkoj që të lexohet e gjithë pjesa, në veçanti

1 rreshti 22 dhe 23.

2 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund ta lexoj të
3 gjithë pjesën, por nuk e pashë me vend këtë gjë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
5 Ju lutem, lexojeni dhe pjesën tjetër.

6 Z. PACE: [Përkthim]

7 PY. E ndalova këtu:

8 "A mund të na thoni se cilët janë personat që ju njihni
9 në këto fotografi?

10 Ju thoni që:

11 "Jam unë, pas meje është Fatmir Limaj dhe në mes është
12 Hashim Thaçi. Çfarë pozite ka pas Fatmir Limaj në atë kohë?

13 Ju përgjigjeni që:

14 "Mendoj që të ketë qenë pjesëtar i Shtabit të
15 Përgjithshëm në atë kohë.

16 "PY. Çfarë periudhe ka qenë?"

17 Ti përgjigjesh:

18 "Ka qenë diku nga nëntori.

19 "PY. Çfarë pozite mendoni ju se ka pasur Fatmir Limaj në
20 atë kohë?

21 "PË. Ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm.

22 "PY. Po Hashim Thaçi?

23 "PË. Në atë kohë sigurisht në drejtorinë politike.

24 "PY. Ju a e mbani mend vendin ku është bërë fotoja?"

25 Thoni:

1 "PË. Jo, s'mundem. Për arsye të incizimit numërtimi i
2 fotografisë është U003-3250."

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Kjo është pjesa që unë kundërshtoj
4 që të perifrazohet kjo pjesë e t'i thuhet dëshmitarit ashtu
5 siç është, e perifrazoi Prokurori. Pra, e kam fjalën për faqen
6 43, rreshtat 22 deri 25, sepse Prokurori e kaloi pa lexuar
7 fjalinë e parë dhe kaloi te fjalia tjetër, ndërkohë që unë
8 kërkoj që të lexohet plotësisht ashtu siç është shkruar, dhe
9 të mos bëhet perifrazim nga Prokurori.

10 Z. PACE: [Përkthim] Unë e lexova të gjithë pjesën. Pasi e
11 lexova të gjithë pjesën, unë u përqendrova te diçka që
12 përmendi Prokurori dhe i bëra pyetje atij. Në këtë pikë jemi.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendova që
14 këtë bëri.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund ta lexoj unë, mund të lexohet
16 përpara --

17 Z. PACE: [Përkthim] Pse duhet ta bësh ti këtë gjë?

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta bësh
19 më vonë, në qoftë se dëshiron, gjatë pyetjeve të dëshmitarit,
20 por tani nuk e kuptoj se çfarë kundërshtimi keni ju.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Një gjë kryesore që ai e përmendi
22 nuk u përmend, nuk u lexua nga Prokurori.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
24 lexojeni Prokuror.

25 Z. PACE: [Përkthim] Nuk e kam idenë se çfarë nuk u

1 përmend.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund ta lexoj unë, apo mund t'i
3 kërkoj dëshmitarit?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm thjesht
5 na thuaj cili është rreshti që mendoni ju që nuk është lexuar
6 i plotë.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Duhet të jetë në faqen 42, duke
8 filluar nga rreshti 22. Pra, rreshti 22 dhe 23. Ndërkohë
9 pyetja u bë për rreshtin 24 dhe 25, pa 22 dhe 23.

10 Z. PACE: [Përkthim] Mbase nuk e dëgjoi z. Misetiç, por
11 unë e lexova të plotë.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë e dëgjova. Por, mund ta
13 rilexojmë dhe njëherë pyetjen që bëtë. Ju thatë që: Ju keni
14 thënë që fotografia është bërë në Shtabin Qendror ose gjatë
15 vizitës. Këtë thatë, Prokuror.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
17 lexoni të gjithë pjesën, përfshirë dhe rreshtat, dhe pastaj
18 vazhdojmë më tej.

19 Z. PACE: [Përkthim] Unë e lexova një herë, megjithatë po
20 e lexoj dhe një herë tjetër.

21 PY. Dëshmitar, do filloj dhe një herë te kjo pjesa. Në këtë
22 pjesë, thuhet:

23 "Dua që t'ju tregoj disa fotografi për arsye të
24 incizimit. Fotografia është e numërtuar U0033239.

25 "A e mbani mend se ku është bërë kjo fotografi?"

1 Ju përgjigjeni:

2 "Nuk e mbaj mend se ku është bërë kjo fotografi. Mbase
3 është bërë në Shtab të Përgjithshëm ose në vizitën që kanë
4 bërë disa anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm në zonën time."

5 Pyetja që ju bëj unë tani, Dëshmitar, është kjo: Pasi e
6 lexova këtë pjesë, a mendoni se është e saktë që fotografia
7 mund të jetë bërë në Shtab të Përgjithshëm ose në vizitën që
8 kanë bërë disa anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm në zonën
9 tënde?

10 PË. Realisht nuk më kujtohet kjo se ku është bërë, edhe në
11 këtë deklaram që kam dhënë nuk kam qenë i sigurt se ku është
12 bërë.

13 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim deklaratën.

14 PY. Dëshmitar, a mund të na thoni se ku keni qenë i
15 stacionuar juve në janar të vitit 1999? Ku e keni pas bazën,
16 ku keni qenë i stacionuar në janar të 1999, Dëshmitar?

17 PË. Në janar 1999, a po?

18 PY. Po.

19 PË. Në fshatin Mullapolc.

20 PY. Me sa ju kujtohet, në Mullapolc ju keni qenë gjatë gjithë
21 janarit të 1999?

22 PË. Po, bazën e kam pas aty. Komandën e kam pas aty, ndërsa
23 kam lëviz, normal, nëpër territor të luftës.

24 PY. A ju kujtohet se ku keni shkuar në janar të 1999,
25 domethënë në qoftë se nuk ke në Mullapolc, në çfarë zone

1 tjetër keni shkuar në janar të 1999?

2 PË. Po unë kam lëviz në atë pjesë të territorit, dhe nuk mund
3 ta kujtoj në cilat pjesë saktësisht kam shkuar, por normalisht
4 që kam pas njësitet apo batalione kam pas në komandën në
5 Jezercë. Nji pjesë, nji batalion tjetër ka qenë në Rancë,
6 Reçak, Petrovë. Kam lëviz në këto territore të cilat janë
7 komanduar nga Brigada 161, dhe ka qenë e vendosur dhe komanda
8 e zonës operative të Nerodimës.

9 PY. Për të qenë të qartë, kur thoni që aty e ka pas bazën
10 zona operative e Nerodimës, e keni fjalën për Jezercën për
11 Petrovcin, apo për ndonjë vend tjetër? Na e thoni konkretisht,
12 Dëshmitar.

13 PË. Në janar po flas, ka qenë në Mullapolc komanda e zonës
14 operative të Nerodimës. Të njëjtën kohë ka qenë edhe komanda e
15 Brigadës 161, Ahmet Kaçiku. Në fakt 161 sepse Ahmet Kaçiku ka
16 qenë ende komandant i saj.

17 PY. Me sa dini ju, a ka pas ndonjë person nga Shtabi i
18 Përgjithshëm i UÇK-së që ka ardhur për të vizituar zonën
19 operative të Nerodimës në janar të 1999, ose rreth kësaj
20 periudhe?

21 PË. Tash nuk më kujtohet.

22 Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj të paraqitet në ekran prova
23 1D00033, përbri dokumentit 1D00033 me ET në fund. Do fillojmë
24 në të dyja dokumentet me faqen SPOE00226336. Të kalojmë deri
25 në fund në versionin në shqip për të parë fillimin dhe fundin

1 e faqes.

2 PY. Dëshmitar, dokumenti që është i shkruar me shkrim dore në
3 të majtë është dokumenti në shqip. A e njihni faqen në të
4 majtë të ekranit, që është dokumenti i shkruar me shkrim dore
5 në shqip, Dëshmitar?

6 PË. Si shkrim po e shoh që është në shqip, por i kujt është
7 çfarë shkrimi, s'po e di.

8 PY. Po nënshkrimin në fund, a e njihni, Dëshmitar?

9 PË. Jo.

10 PY. Pak sipër nënshkrimit, shohim përmendjen e faktit që:

11 "Misioni i ekipit të SHP-së të UÇK-së të zonës së
12 Nerodimës, kreu punën e vet treditore në 08.01.1999 në
13 komandën e zonës operative të Nerodimës në Mullapolc."

14 A ju kujtohet të ketë ndodhur kjo, Dëshmitar.

15 PË. Më kujtohet që kanë qenë një pjesë e eprorëve në
16 ceremoninë që e kemi pas të betimit, por nuk besoj që ka qenë
17 në janar. Duhet të ketë qenë dhjetor.

18 PY. Për cilën ceremoni betimi e keni fjalën?

19 PË. Por në Jezercë është realizu një ceremoni e betimit të
20 disa ushtarëve të ri të cilët kanë qenë në kuadër të
21 batalionit të Jezercit.

22 PY. Ju thatë që ka pasur oficerë në atë ceremoni, kush, ju
23 kujtohet ndonjë prej këtyre oficerëve?

24 PË. Më kujtohet se ka qenë, nëse nuk gaboj, Sali Veseli ka
25 qenë emri i tij. Ka qenë Rexhep Selimi, dhe nuk e di të tjerë.

1 PY. Në kohën kur është kryer kjo ceremonia e betimit, Salih
2 Veseli çfarë roli ka pasur?

3 PË. Nuk e kam ditur saktë, por e di që ka qenë dikund në
4 operativen, të cilën e ka udhëheqë Bislum Zyrapit.

5 PY. Ka qenë brenda Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së kjo
6 operativja?

7 PË. Me sa di unë, po.

8 PY. Çfarë tha Sali Veseli gjatë ceremonisë së betimit, nëse
9 tha ndonjë gjë?

10 PË. Nuk di nëse ka mbajtur fjalim apo jo dikush, por e di që
11 unë iu kam drejtuar ushtarëve të kësaj Kompanie dhe kam lexuar
12 tekstin e betimit. Edhe pastaj ata kanë nënshkruar dhe është
13 kryer si ceremoni.

14 PY. Me sa të kujtohet, po Rexhep Selimi a ka folur në atë rast?

15 PË. Nuk më kujtohet që ka folur, por ka qenë prezent Rexhep
16 Selimi.

17 PY. Në atë kohë kur ka qenë i pranishëm Rexhep Selimi në
18 ceremoni, ti si e kishte kuptuar rolin e tij në UÇK, domethënë
19 çfarë roli kishte ai sipas teje?

20 PË. Realisht aty është ardhur si anëtar i Shtabit të
21 Përgjithshëm.

22 Z. PACE: [Përkthim] Në të njëjtin dokument do të doja të
23 shihnim faqen që përfundon me 226336.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është e njëjta faqe që
25 është në ekran.

1 Z. PACE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, kështu është.

2 Zmadhojmë pak kryen e faqes, ju lutem.

3 PY. Dëshmitar, është e njëjta faqe. Këtu përmendet data

4 "08.01.1999 - Jezercë", dhe më poshtë thotë:

5 "Marrim pjesë në betimin solemn të ushtarëve të Kompanisë

6 2 të Batalionit 1, të Brigadës 161. Në emër të Shtabit të

7 Përgjithshëm të UÇK-së përshëndesim ushtarët e kësaj njësie.

8 "Një tog i njësisë së intervenimit të shpejtë dhe një tog

9 vëzhgues para dhënies së betimit kryen një paradë me sukses."

10 Dëshmitar, ju thatë që ceremonia e betimit në Jezercë ka

11 qenë diku nga dhjetori i 1998. Por në dokument thotë 8 janar i

12 1999. A ka mundësi që të jetë më e saktë data në dokument?

13 PË. Nuk mund ta kujtoj, por e di që fundi i dhjetorit, 8

14 janari mos është datë bukur e vonshme, dhe nuk mund të jem i

15 sigurt për këtë datë.

16 PY. Po në Jezercë, ka pasur një apo më shumë se një ceremoni

17 betimi ku ka qenë i pranishëm edhe Rexhep Selimi edhe Sali

18 Veseli?

19 PË. Po aty ka pas edhe popullatë civile. Kanë qenë ushtarët e

20 kompanisë që kanë dhanë betimin, dhe ushtarët e njësisë

21 speciale të cilët kanë performuar formën e veprimit, dy forma

22 të veprimit, nëse nuk gaboj, si pjesë e ceremonisë së betimit.

23 PY. Ju thatë që ceremonia e Jezercës që ju kujtohet ju, ka

24 qenë ajo ceremonia ku ke qenë ti, Rexhep Selimi dhe Sali

25 Veseli. Me sa mbani ju mend, Rexhep Selimi dhe Sali Veseli,

1 kanë marrë pjesë vetëm në një ceremoni betimi në Jezercë, apo
2 në shumë, në më shumë ceremoni betimi?

3 PË. Me sa e kujtoj unë, do të thotë, në këtë ceremoni betimi,
4 sepse ma vonë kemi pas luftime bukur të ashpra që janë të
5 njoftura për publikun, dhe nuk kemi pas mundësi të bëjmë
6 ceremoni të betimit të ushtarëve të tjerë.

7 PY. Të jemi të qartë, pra, Rexhep Selimi, Sali Veseli dhe ju
8 personalisht keni marrë pjesë vetëm në një ceremoni betimi në
9 Jezercë, saktë?

10 PË. Po, vetëm në një ceremoni, por nuk kemi qenë vetëm ne. Ka
11 qenë edhe zëvendësi im, edhe shefi i shtabit, edhe civilë të
12 asaj ane. Ka pas bukur shumë njerëz.

13 PY. Para një çasti në përgjigjen tuaj ju keni thënë:

14 "Po atje ka pas dhe civilë, ushtarët e kompanisë që kryen
15 betimin, si dhe ushtarët e njësitit special që ishin po ashtu
16 pjesë e ceremonisë."

17 Po këta ushtarët e njësitit special që kanë kryer dy
18 detyra atje, kush ishin?

19 PË. Po kemi pas njësitin special, i cili ka qenë i vogël. Ka
20 qenë rreth 20 ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të
21 cilët në atë periudhë trajnoheshin për të marrë përgjegjësi si
22 njësit special i cili do të kryente detyra të mëvonshme tepër
23 të rëndësishme, sepse aty ku na thehej vija frontale kjo njësi
24 speciale intervenonte dhe e kthente vijën frontale, apo
25 kthente pozicione të cilën e kishim të humbur, e kthente në

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 88

1 kontrollin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pra, detyra shumë
2 të veçanta.

3 PY. Kush ka qenë përgjegjës për këtë njësitin special që sapo
4 na përshkruat?

5 PË. Ka qenë komandant Murtaja, emri Sadik Begaj, tash është
6 dëshmor.

7 PY. Do flasim pak më vonë sërish për ceremoninë e betimit.

8 Z. PACE: [Përkthim] Por meqë jemi te ky dokument, shkojmë
9 tek faqja që përfundon me numrin 226329.

10 PY. Kjo është një faqe e të njëjtit dokument. Në krye të
11 faqes është data 06.01.1999, Mullopolc, më poshtë zona
12 operative e Nerodimës. Dëshmitar, këtu shohim disa germa që
13 janë me ngjyrë të purpurt, me ngjyrë të lejla, me ngjyrë
14 lejla, vjollcë. A mund të na thoni për çfarë janë këto germa
15 dhe këto simbolet përbri?

16 PË. Nuk i kuptoj këto.

17 Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër, ju lutem.
18 Në faqen me 330 në fund.

19 PY. Këtu tek pika numër 2 shohim:

20 "Referimi i plotë dhe raporti me hollësi i komandantit të
21 zonës së Nerodimës, Shukri Buja."

22 A m bani mend të keni pasur një referim të plotë në
23 Mullopolc në këtë periudhë pra 06.11.1999 [Sipas përkthimit]?

24 PË. Nuk më kujtohet si raport, nuk më kujtohet.

25 PY. Në të njëjtën faqe thotë:

1 "3. Problematika me Brigadën 162 ...: Nuk është
2 operacionale ndonëse e ka numrin e mjaftueshëm të ushtarëve."

3 A ju kujtohet që ka pas problematika me këtë njësi sepse
4 nuk ka pasur mjaftueshëm ushtarë?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Këto pyetje po bëhen në
6 propozimin, po e bëjmë në propozimin që dokumenti është i
7 janarit. Se as tek origjinali dhe as tek përkthimi nuk është
8 periudha janar.

9 Z. PACE: [Përkthim] Po, por në faqen pararendëse ishte
10 data 06.01.1999. Pastaj një faqe tjetër kishte datën 8 janar
11 1999, dhe për 8 janarin e 1999 është ajo ngjarja që dëshmitari
12 thotë ka ndodhur ose në dhjetor ose në janar.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po më fal, po
14 këtu është data 06.11.1999?

15 Z. PACE: [Përkthim] Po, në këtë faqe është data
16 06.11.1999, por le ta sqarojmë me dëshmitarin.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kishit diçka
18 tjetër?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shohim dhe origjinalin çfarë
20 thotë, se është e dobishme.

21 Z. PACE: [Përkthim] Po. Kthehemi në faqen që përfundon me
22 6329.

23 PY. Dhe këtu në krye të faqes, Dëshmitar, ju e shihni
24 "06.01.1999, Mullopolc", "Zona operative e Nerodimës", e
25 shihni këtë?

1 PË. Po, e shof.

2 PY. Ju na thatë që ju keni qëndruar në Mullopolc në janar të
3 1999, saktë?

4 PË. Po, e saktë është.

5 Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër që ishte
6 faqja që kishim para një çasti. Faqja 6330.

7 PY. Dëshmitar, a e shihni këtu në krye të faqes "Mullopolc
8 06.11.1999", më poshtë pastaj "Nën komandën e ZO të
9 Nerodimës", e shihni këtë?

10 PË. Po.

11 PY. Me sa mbani ju mend, komanda e zonës operative të
12 Nerodimës, në nëntor të 1999, e ka pasur bazën në Mullopolc.

13 PË. Po, e ka pas në Mullopolc.

14 PY. Në atë kohë, ka qenë pjesë e UÇK-së apo pjesë e ndonjë
15 organi tjetër?

16 PË. Pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

17 PY. A të kujtohet që Shtabi i Përgjithshëm të ketë kryer një
18 vizitë në nëntor të 1999?

19 PË. Nuk më kujtohet që ka pas vizitë në nëntor.

20 PY. Në pikën 3, shohim që thotë:

21 "Problem me Brigadën 162 ... e cila nuk është në veprim,
22 edhe pse ka potencial dhe numër të mjaftueshëm ushtarësh."

23 Dëshmitar, mund të na thoni atëherë kur e filloi
24 veprimtarinë Brigada 162?

25 PË. 162 e ka filluar njëjtë si 161, si brigada, por rreth

1 strukturimit, rreth kompletimit të komandave të ushtarëve,
2 gjithë strukturës ushtarake keni parasysh se kemi qenë në kohë
3 lufte dhe vështirësitë kanë qenë tepër të mëdha. Madje
4 vështirësitë rreth furnizimit kanë qenë edhe më të mëdha, dhe
5 strukturimi normalisht që nuk ka përfunduar i tyre, brigadave,
6 dhe i shtabit të zonës, as me përfundimin e luftës. Do të
7 thotë, kemi pas punë në vazhdimësi rreth strukturimit të
8 njësiveve tona gjatë luftës çlirimtare.

9 PY. Thatë që filloi në të njëjtën kohë me Brigadën 161. Kur i
10 bie atëherë, kur ka filluar?

11 PË. Ka fillu me organizu brigadat në fund të tetorit të vitit
12 1998, dhe kemi vazhduar pastaj me strukturimin, me
13 organizimin, e këtyre brigadave, ma vonë dikund në nëntor,
14 dhjetor. Kanë filluar organizimin me batalione, kompani, e
15 pjesë të tjera që janë të domosdoshme për funksionim. Por ka
16 qenë një proces në vazhdimësi, jo mbrenda një periudhe të
17 shkurtër kohore, por në vazhdimësi është ndërmarrë hapa për
18 strukturimin e këtyre njësiveve.

19 PY. Në këtë kontekst, kur flisni për nëntorin dhe dhjetorin,
20 të të cilit vit bëhet fjalë?

21 PË. Flitet për vitin 1998.

22 Z. PACE: [Përkthim] Shohim faqen 00226334, ju lutem.

23 Zmadhojmë shënimin e dytë në këtë faqe.

24 PY. Ky është pjesë e të njëjtit dokument që po diskutonim,

25 Dëshmitar. Këtu thotë data është "07.01.1998":

1 "Vizitë

2 "Maja mes Popozit dhe Llanishtit."

3 Pyetja ime e parë është kjo, me sa mbani ju mend, Popozi
4 dhe Llanishta janë brenda zonës operative, ishin brenda zonës
5 operative të Nerodimës apo ndonjë zone tjetër?

6 PË. Llanishiti, Topilla dhe ato fshatra ishin pjesë të zonës
7 operative të Nerodimës, por operonte një njësi e cila nuk
8 ishte në kuadër të komandës së zonës operative të Nerodimës.
9 Ishte një batalion, apo kompani, në fillim, kompani e
10 diversanto-vëzhguese, që ishte kompani e Shtabit të
11 Përgjithshëm.

12 PY. Kush ka qenë përgjegjës për këtë kompaninë që sapo
13 përmendët?

14 PË. Kompani, ma vonë batalion, kanë qenë, ne i qujshim
15 ushtarët e Gurit, apo ka qenë komandant Guri.

16 PY. Si mësuat për ekzistencën e kësaj kompanie e cila u bë më
17 pas batalion?

18 PË. Po kjo ka qenë edhe më herët, edhe në periudhën para se
19 të ristrukturohej zona operative e Nerodimës, por këta ushtarë
20 kanë insistuar të jenë pjesë e Brigadës 121, Kumanova, por për
21 shkak të ndarjes territoriale të grykës së Caralevës dhe
22 vështirësive për të komunikuar me komandën e Brigadës 121,
23 atëherë është formuar një njësi, apo është formuar kompania,
24 kompania diversanto-vëzhguese, dhe më vonë është qujt
25 batalioni diversanto-vëzhgues.

1 Z. PACE: [Përkthim] Në të njëjtin dokument shohim faqen
2 që përfundon me numër 226350.

3 PY. Dëshmitar, kjo është pjesë e të njëjtit dokument që po
4 shohim. Në krye shohim shifrat "07.01.[1999]", më poshtë "Puna
5 e komisionit për caktimin e ZO", "Nerodimës-Pashtrik", është e
6 nënvizuar.

7 Fillimisht, keni dijeni të ketë ekzistuar një komisioni
8 për caktimin e zonës operative?

9 PË. Nuk kam pas dijeni.

10 PY. Në këtë faqe, shohim disa vendndodhje, e para është
11 "Plosh-Pashtrik". Keni dijeni të ketë ekzistuar një vend që e
12 ka emrin Plosh?

13 PË. Edhe një herë, të lutem?

14 PY. Emër -- në një fshat Plosh, keni pasur dijeni? Në -- pra,
15 tek faqja që kemi përpara, shohim një emër "Plosh-Pashtrik",
16 keni dijeni ju, ka ndonjë fshat a ndonjë qytet a ndonjë vend
17 me emrin Plosh?

18 PË. Nuk po më kujtohet.

19 PY. Poshtë është "Prevallac-Pashtrik". Po ndonjë vend me
20 emrin Prevallac, njihni?

21 PË. Si Prevallë po, si Prevallac ku po e njoh.

22 PY. Të themi që është Prevalla, atëherë. Prevalla, ka qenë në
23 Pashtrik apo në ndonjë vend tjetër?

24 PË. Nuk e di saktë.

25 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

1 Shohim dokumentin me numër U001-2063-U001-2101, përbri
2 anglishtes, që ka të njëjtin numër, por me ET Revised 1. Dhe
3 në të dy dokumentet shkojmë në faqen 2085.

4 PY. Dëshmitar, ky është një dokument tjetër. Në të majtë
5 është anglishtja, në të djathtë është shqipja.

6 Z. PACE: [Përkthim] Zmadhojmë shqipen, ju lutem?

7 PY. Dëshmitar, e keni parë ndonjëherë më përpara këtë faqen
8 në shqip?

9 PË. Jo.

10 PY. Po shkrimin e dorës, kaligrafinë, e njihni?

11 PË. Jo.

12 PY. Po lexoj fillimin dhe pastaj do ju bëj një pyetje. Thotë
13 kështu:

14 "Raport ditor

15 "Më 8 janar 1999, nga ora 8.30 e mëngjesit, është ba
16 betimi ushtarak që ka marrë pjesë shumë komandantë të Shtabit
17 të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfshirë
18 komandantin e zona operative të Nerodimës në Jezercë. Që
19 mbahet ushtria ushtarake në emër të komandantit të batalionit
20 në Jezercë. Edhe ceremonia e betimit ka zgjatur deri në orën
21 13.20. Betohe mi! UÇK!"

22 Data poshtë:

23 "08.01.1999

24 Dhe poshtë është një emër:

25 "Meti."

1 Nuk e di a na e keni thënë ndonjëherë kush është Meti,
2 sepse mund ta kemi harruar. Por sidoqoftë a mund ta përsërisni
3 kush është Meti?

4 PË. Nuk e di kush është Meti. Ka mundur të jetë ndonjë
5 ushtar, nuk e di.

6 PY. Kjo përmbledhja e këtij raporti që bëra unë, a përputhet
7 me atë ceremoninë e betimit ku keni qenë i pranishëm ju,
8 Rexhep Selimi dhe Sali Veseli?

9 PË. Mund të jetë kjo në përputhje me atë që ka qenë, por nuk
10 mund me e vërtetu saktësisht.

11 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin. Dhe
12 vendosim në ekran materialin P00647 përbri materialit P00647-
13 ET. Ndërkohë që presim dhe anglishten në ekran.

14 PY. Dëshmitar, në të djathtë, e shihni një dokument në shqip
15 që është pjesërisht me shkrim dore dhe pjesërisht i shtypur?

16 PË. Po, e shoh, por nuk e kam parë ndonjëherë.

17 Z. PACE: [Përkthim] Tani do të doja të shkonim tek faqja
18 e fundit e dokumentit në anglisht dhe në shqip. Po.

19 PY. Dëshmitar, në të majtë tek shqipja, është tek faqja që
20 mban datën 20 janar 1999, dhe ka vula e nënshkrime. Njihni
21 ndonjë prej nënshkrimeve në këtë faqe?

22 PË. Po, e shoh emrin tim. Është shkrimi që besoj që është i
23 imi.

24 PY. Data 20 janar 1999, a mos është data kur e keni
25 nënshkruar këtë dokument?

1 PË. Kjo nuk më kujtohet.

2 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

3 PY. Dëshmitar, a mbani mend të keni bërë ndonjë shënim a të
4 keni shkruar ndonjë artikull gazete, kapituj, libra në 1998,
5 ose në 1999, ose më pas, por që kishin lidhje me 1998 ose
6 1999?

7 PË. Ka pas shumë libra të shkruar. Ka shumë libra. Ka shumë të
8 pavërteta, libra ka shumë, ekzagjerime, zbukurime dhe realisht
9 është një diçka që të krijon do të thotë, shumë paqartësi
10 rreth asaj, asaj periudhe.

11 PY. Po ju personalisht keni shkruar ndonjëherë ndonjë shënim,
12 ndonjë artikull, ndonjë libër, ju vetë keni shkruar ndonjëherë
13 diçka që mund të jetë botuar ose jo?

14 PË. Ka -- mund të ketë ndonjë fjalim i imi. Por, libër nuk
15 kam shkruar. Ka mund të jetë ndonjë pjesë e fjalimit tim, apo
16 ndonjë shkrim tim që ka mund të botohet, por në fakt në
17 libra jo, apo në ndonjë shkrim të gjatë, jo.

18 PY. Po a ju kujtohet t'i keni dhënë ndokujt ndonjë shkrim
19 tuajin ose në 1998 ose në 1999, ose në periudhë, në ndonjë
20 periudhë të përafërt? Ju vetë ndonjë shkrim tuajin ia keni
21 dorëzuar ndokujt?

22 PË. Nuk më kujtohet.

23 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendoj se është
24 momenti më i përshtatshëm për të bërë pushimin, që të mos kem
25 ndërprerje.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 Dëshmitar, tani kemi pushimin e drekës. Do kemi një orë e
3 tridhjetë minuta pushim. Do ktheheni në sallë në orën 14.30.
4 mos diskutoni me askënd dëshminë tuaj, mund të dilni nga
5 salla. Faleminderit.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rikthehemi në
8 orën 14.30.

9 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.58

10 --- Seanca rifillon në orën 14.30

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, a
12 mund të na përditësoni sa i takon dëshmitarëve, në qoftë se
13 mund të na përditësoni deri të enjten?

14 Z. PACE: [Përkthim] Nesër, në fakt do ju informoj. E di
15 që afati është deri të enjten, por deri nesër do ju jap një
16 përgjigje se kush do të jenë dëshmitarët për javët në vijim.
17 Pra, do ua dërgojmë nesër, në mënyrë të tillë që të gjithë
18 ekipet të kenë informacionin përkatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

20 Znj. Asistente, silleni dëshmitarin në sallë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Në orën 15.30 do bëjmë
22 10 minuta pushim, siç kemi bërë edhe ditët e tjera.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Buja, do
25 të vazhdojmë akoma. Prokurori do të vazhdojë me pyetjet e

1 veta. Ju lutem, dëgjojeni me kujdes.

2 Z. Pace, e keni ju fjalën.

3 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Do i kërkoja Sekretares
4 të paraqesë në ekran tani dokumentin SPOE00227463 deri në
5 SPOE00227503. Përbri përkthimit në anglisht, që është
6 dokumenti me të njëjtin ERN, që përfundon me ET në fund. Do të
7 fillojmë nga faqja e parë.
8 PY. Dëshmitar, në ekran përpara shikon një dokument të ri. Në
9 të majtë është shqip, ndërkohë që në të djathtë është
10 përkthimi i këtij dokumenti në anglisht. Mund të shohim që
11 titulli i dokumenti është "Cila ishte strategjia e mbylljes së
12 grykës së Carralevës, në Llapushnik".

13 Pyetja ime e parë është kjo: A e njihni dokumentin që
14 keni në shqip përpara në ekran, Dëshmitar?

15 PË. Po, është një dokument.

16 PY. A e njihni këtë dokument?

17 PË. Jo.

18 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë te faqja tjetër, 7463. Do
19 i kërkoja Sekretares që të zmadhojë rreshtat e parë, tre
20 rreshtat e parë.

21 PY. Dëshmitar, kjo është faqja e dytë e të njëjtit dokument,
22 ndërkohë që tani do ju lexon një pjesë të këtij dokumenti. Më
23 dëgjoni ju lutem. Titulli është: "Më 6 qershor emërohem
24 komandanti i nënzonës operative të Nerodimes."

25 "Më 6 qershor të vitit 1998 nga Shtabi i Përgjithshëm i

1 UÇK-së emërohem komandant i nënzonës operative të Nerodimes, e
2 cila nënzonë përfshinte territorin nga Fushtica e deri në
3 Glloboçicë."

4 A pajtoheni, Dëshmitar, që ky është një dokument që me
5 ç' duket është shkruar prej jush?

6 PË. Këtu po e shoh një gabim, se nuk ka qenë qershorit aty,
7 më 6 qershor. Ka qenë korriku, i emërimit tim, dhe ka mujt të
8 jetë një lëshim -- lëshim në atë kohë kur e kam shkruar, në
9 qoftë se është shkrimi im.

10 PY. A ju kujtohet që e keni shkruar ju këtë, Dëshmitar?

11 PË. Nuk po më kujtohet, por po e shoh si gabim sepse 6
12 qershori është gabim.

13 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë te faqja 227491. Do
14 kërkoja që të paraqesim pjesën e fundit, pjesën e -- gjysmën e
15 dytë të faqes, si në anglisht, ashtu edhe në shqip.

16 PY. Do të lexoj pesë - gjashtë faqet -- pesë-gjashtë fjalitë
17 e fundit në faqe, Dëshmitar, pastaj do të bëj një pyetje.

18 "Për herë të parë para mjeteve të informimit, jam
19 paraqitur në Kleçkë. Atëherë kur zëdhënësi i Ushtrisë
20 Çlirimtare të Kosovës, Jakup Krasniqi, së bashku me Jahi
21 Ibrahimin përmes TVSH-së dhanë intervistën e parë publike. Kjo
22 më kujtohet ishte dalja e parë edhe e përfaqësuesve të
23 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës para opinionit. Dalja e parë
24 publike për mua ishte emocionuese aq sa ishte e rrezikshme.
25 Shkak për këtë ishte se familjen e kisha në fshat, por

1 rrezikoja dhe tërë rrethi im nga -- i the -- tërë rrethi nga i
2 cili vija unë. Por rrezikun më të madh e shihja te vëllai im i
3 madh, te Rama, i cili ende gjendej në Prishtinë.”

4 A është e saktë që ju keni një vëlla të madh që quhet
5 Ramë, Dëshmitar?

6 PË. Po, është e saktë.

7 PY. Më herët sot na thatë që në fakt keni qenë i pranishëm në
8 paraqitjen e parë të Jakup Krasniqit në televizion si zëdhënës
9 i UÇK-së. A është e saktë kjo?

10 PË. Po, e saktë është.

11 PY. A ju kujtohet të keni shkruar informacionin që sapo ua
12 lexova?

13 PË. Jo, ky informacion nuk më kujtohet.

14 PY. Për të qenë të qartë, së pari, informacioni që sapo ju
15 lexova, a është sipas asaj që ju kujtohet juve. Për shembull,
16 a është në përputhje me faktin që Jakup Krasniqi doli për herë
17 të parë si zëdhënës?

18 PË. Po, Jakup Krasniqi doli si zëdhënësi i Ushtrisë
19 Çlirimtare të Kosovës për herë të parë në qershor të vitit
20 1998.

21 PY. Fragmenti që unë ju lexova fillon kështu:

22 “Për herë të parë para mjeteve të informimit jam
23 paraqitur në Kleçkë”, pra kur ju jeni paraqitur përbri Jakup
24 Krasniqit. Përveçse kjo paraqitje ishte paraqitja e parë
25 përpara medias për Jakup Krasniqin, ishte edhe paraqitja juaj

1 e parë para mjeteve të informimit, sikurse edhe për të? A mund
2 ta konfirmoni këtë, Dëshmitar?

3 PË. Po, unë jam paraqitur për herë të parë bashkë me Jakup
4 Krasniqin në Kleçkë.

5 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë te faqja që përfundon tani
6 me 220470 [Sipas përkthimit].

7 PY. Dëshmitar, kjo është një faqe tjetër nga i njëjti
8 dokument. Do shikojmë nga mesi i faqes, do t'ua lexoj këtë që
9 është e theksuar, deri në fund të faqes:

10 "Pse u tërhoq Shukri Buja nga TMK-ja."

11 "Nga TMK-ja u tërhoqa ngase nuk u pajtova me rrjedhën e
12 informacionit të saj të mëtejshëm. Ne ishim marrë vesh që do
13 të transformohej Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e jo FARK-u, e
14 shumë civilë shqiptarë dhe magjypë - me shkrim dore - shkie,
15 së bashku.

16 "Pasi që shumë ushtarë dhe komandantë të dalluar të UÇK-
17 së mbetën rrugëve të qyteteve tona. Ata merreshin me shitjen e
18 gjërave të imta, si të cigareve, e të tjerë. Unë, si ish-
19 komandant i tyre gjatë luftës, pasi s'munda të ndikoj për të
20 mirë, desha që edhe unë t'i bashkohesha fatit të tyre."

21 Dëshmitar, këtu kemi një pjesë, një titull ku përmendet
22 Shukri Buja dhe më pas në fjali që ju lexova, thuhet "unë". A
23 pajtoheni që kjo pjesë do jetë shkruar nga ju, Dëshmitar?

24 PË. Këtu nuk po duket se e kam shkruar unë, po që jam pyetur
25 unë, edhe duket sikur e k -- unë jam ai që e ka deklaruar

1 këtë.

2 PY. A ju kujtohet në qoftë se ju është bërë pyetje, dhe në
3 qoftë se ju keni dhënë një përgjigje që përkon me
4 informacionin që unë sapo ua lexova?

5 PË. Realisht, kjo intervistë nuk po më kujtohet.

6 PY. A jeni tërheq juve nga TMK-ja në ndonjë kohë?

7 PË. Po, jam tërhequr.

8 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 227473. Do i
9 kërkoja Sekretares të zmadhojë pesë rreshtat e fundit të asaj
10 faqeje.

11 PY. Dëshmitar, kjo është një faqe tjetër e të njëjtit
12 dokument. Do ju lexoj një fragment dhe pastaj do ju bëj një
13 pyetje, ose disa pyetje.

14 "Në fshatin Jezercë ngritëm edhe shkollën për përgatitjen
15 e ushtarëve dhe eprorëve. Ndërkaq, në fshatin Devetak kishim
16 edhe shkollën për njësi speciale."

17 Dëshmitar, a i keni dëgjuar ju këto shkollat ndonjëherë?
18 A jeni të njohur me këto shkolla?

19 PË. Jo, në Devetak s'kemi pas shkollë. Në Jezercë në
20 periudhën e fundit të vitit të luftës janë -- është bërë
21 trajnimi i disa ushtarëve.

22 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen që përfundon me
23 227473. Do lexoj dy rreshta e fundit të asaj faqeje dhe në tre
24 rreshta te tjerë të faqes pasardhëse.

25 PY. Përsëri, Dëshmitar, do ju lexoj një fragment nga ky

1 dokument:

2 "/Shkruhet me shkrim dore: Nga Drenica, me urdhër të
3 Shtabit të Përgjithshëm, njësie -- njësia e përbërë nga pesë
4 vetë, nga komandantët Çeliku, Kumanova, A. Bajrami, Topi dhe
5 Shukri Buja, të udhëhequr nga Çeliku, u vendos në Kleçkë.

6 "Plani ishte që të vendoseshin në Kleçkë. Në Pagarushë,
7 A. Bajrami dhe unë u ndamë nga grupi, nga njësitë, për të
8 vazhduar më tej drejtë Mallapolcitet, ku do të përcaktohej ku do
9 të krijohesh baza ku do të kryheshin detyrat me të cilat ishim
10 të ngarkuar unë dhe Agimi./"

11 Pastaj është fshirë ky teksti që po ua lexoj tani:

12 "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së -- kemi marrë detyra të
13 reja, i cili na ngarkoi mua dhe Agimin -- Bajramin që të
14 veprojmë në territorin në Suarekë-Kaçanik."

15 Pastaj është teksti i mëposhtëm:

16 "Në këtë territor jemi emëruar me detyrën për organizimin
17 e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për komunat Lipjan, Shtime,
18 Ferizaj, Kaçanik. Ndërkaq, për koordinimin e veprimeve prej
19 Kaçanikut e deri në Kleçkë, Shtabi i Përgjithshëm më ngarkoi
20 me këtë detyrë, me përgjegjësi të madhe. Me shkrim dore
21 shkruhet që "Ky territor më vonë u njoh si nënzona e
22 Nerodimes."

23 Dëshmitar, ky informacion që sapo ju lexova a përkon me
24 ngjarjet si janë shpalosur ato ngjarje atëherë?

25 PË. Jo, janë paksa të zgjeruara. Kam ndërhye, e shihni, me

1 shkrim, sepse ka shumë pasaktësi. Unë jam mundu me i përmirësu
2 disa pasuese, të cilat kanë qenë shumë gabim, dhe ka
3 ekzagjerim bukur të mëdha në këtë shkrim.

4 PY. Çfarë doni të thoni kur thoni që kam ndërhyrë për të
5 përmirësuar përmbajtjen e disa paragrafëve, për të sqaruar
6 disa paragrafë?

7 PË. Po shumë kaq -- gjithë shkrimi duket se është më shumë
8 artistik dhe jo shumë i faktum. Unë jam mundu t'i jap disa
9 fakte që çka vërtetë ka pas në atë kohë, sa më janë kujtue,
10 dhe ne do të -- kam shkruar se jemi -- kemi marrë udhëzime që
11 të zhvendosemi në Kleçkë. Kështu jam mundu me e shkruar. Dhe në
12 fakt ne kemi shku veç me Agim Bajramin në Kleçkë, edhe prej
13 Kleçkës ato që i shpjegova më herët, kemi udhëtuar me Sadik
14 Shalën, të njëjtën natë, domethënë në fshatin tim të lindjes,
15 ku na ka përcjellë deri në Ribarb Sadik Shala, dhe pastaj jam
16 vendosur në Mullapolc.

17 Po, ka qenë shkrim shumë i shkurtër dhe unë e kam -- e
18 kam shkurtuar bukur, bukur shumë, por jam mundu me ba disa
19 përmirësime.

20 PY. A ju kujtohet se kujt ja keni paraqitur këtë shkrim?

21 PË. Jo, në fakt nuk më kujtohet kush a ka ba këtë shkrim,
22 sepse është i dikujt tjetër, nuk është shkrimi jem, por disa
23 përmirësime që i kam bërë, i kam bërë -- duket se është
24 shkrimi im.

25 PY. Në rregull. Sa për ta sqaruar, ky shënimi me shkrim dore

1 që shikojmë në këtë faqe, këtë e njihni si shkrimin tuaj me
2 dorë, apo o, Dëshmitar?

3 PË. Ky shkrimi me dorë po më duket se është shkrimi jem, dhe
4 kështu po e potencoj.

5 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë më tej në faqen që
6 përfundon me 227475. Ju lutem zmadhoni dhjetë rreshtat e parë
7 të dokumentit.

8 PY. Edhe një herë, Dëshmitar, do ju lexoj një faqe tjetër të
9 të njëjtit dokument. Këtu thuhet:

10 "Sikurse e thashë që prej fillimit, ne ishim zgjedhur nga
11 Shtabi i Përgjithshëm për formimin e njërive të vogla" dhe më
12 pas shkruan "nënzona e Nerodimes, me shkrim dore."

13 A është e saktë kjo, ose me fjalë të tjera, përkon kjo me
14 atë çfarë ju kujtohet juve të ketë ndodhur në atë kohë?

15 PË. Po në atë kohë ne, kur është bërë shkrimi, sigurisht
16 është i pasluftës, dhe e kemi propaganduar më shumë se sa që
17 ka qenë organizimi. Realisht, e kemi, e kemi përshkruar
18 gjithmonë Shtabin e Përgjithshëm po në fakt organizimi i
19 nënzonës, e shpjegova edhe më herët, domethënë ka fillu nga
20 korriku dhe kemi vazhdu pa e dit shumë qartë se si do
21 strukturohet. Këtu është më shumë -- duket se është libër,
22 libër propagandistik, apo shkrim propagandistik dhe unë jam
23 munduar që ta përmirësoj, diku-diku.

24 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen që përfundon me
25 227493. Të zmadhojmë paragrafin e dytë aty.

1 PY. Dëshmitar, kjo është një faqe tjetër e të njëjtit
2 dokument. Do t'ju lexoj një pjesë e pastaj do ju bëj disa
3 pyetje.

4 "Në orët e para, në orët e hershme të 15 janarit,
5 pushtuesit e prirë nga ushtarët të angazhuar edhe njësitë me
6 [E pakuptueshme] të prirë edhe nga disa shqipfolës, së pari
7 filluan me granatime, të cilat ishin shumë të fuqishme. Reçaku
8 granatohej nga të gjitha anët, si nga Podi i Gështenjave, nga
9 Çesta, nga Pishat, e të tjera. Ishte e pamundur të mbrohej
10 popullata, sado që ne vepruam nga të gjitha drejtimet. Të
11 parët që na erdhën në ndihmë ishin komandant Guri dhe njësiti
12 i tij, i cili vepronte me batalionin diversanto-vëzhgues që
13 ishte i lidhur drejtpërdrejtë me Shtabin e Përgjithshëm."

14 Dëshmitar, më herët ju thatë që komandant Guri ishte
15 përgjegjës për një njësit që ishte nën komandën e
16 përgjithshme, që në qoftë se e kujtoj siç duhet, ju thatë që e
17 kishte bazën në Llanishte, që ishte pjesë e zonës suaj, por
18 ishte i veçantë, i ndarë. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

19 PË. Po, kështu e thashë dhe kështu ka qenë.

20 PY. Pjesa tjetër e fragmentit që sapo ju lexova flet për
21 sulmin e Reçakut në janar. Ajo çka është shkruar këtu a përkon
22 me atë çfarë ju kujtohet juve lidhur me këtë ngjarje, pra me
23 ngjarjen e Reçakut?

24 PË. Po, për afërsisht kështu ka qenë.

25 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që ky

1 dokument të pranohet në provë gjyqësorë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti me

8 numër SPOE00227464 [Sipas përkthimit] deri SPOE00227503

9 pranohet në provë.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

11 dokumenti dhe përkthimi i tij në anglisht, do të marri numrin

12 e provës P01813. Aktualisht është i klasifikuar si

13 konfidencial.

14 Z. PACE: [Përkthim] Mund të klasifikohet si publik.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,

16 klasifikoheni si publik.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, të nderuar

18 Gjykatës.

19 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

20 PY. Dëshmitar, keni dëshmuar dhe kemi parë edhe dëshmi të

21 mëparshme tuajën, që ju jeni kujdesur për furnizimet me armë.

22 Më korrigjoni në qoftë se nuk e kam të drejtë këtë, por besoj

23 që ju jeni marrë me furnizimet me armë rreth majit apo gushtit

24 të vitit 1998. A është kështu, apo jo, Dëshmitar? Është e

25 saktë kjo?

1 PË. Jam marrë edhe me organizimin e njësiteve guerile në atë
2 kohë. Shumicën e kohës jam marrë me grumbullimin dhe
3 përcjelljen e armatimit.

4 PY. A keni qenë i përfshirë në mbledhjen dhe transportimin e
5 armëve në vitin 1999 përveç kësaj që përmendët më herët,
6 pavarësisht kohës?

7 PË. Po, në vitin 1999 më shumë jam marrë me komandimin dhe
8 strukturimin e zonës, ndërsa në vitin 1999 janë marrë njësitet
9 e logjistikës, që në atë kohë veç kemi arrit me i organizu
10 deri diku.

11 PY. A ju kujtohet që të keni shkuar në Shqipëri në janar të
12 vitit 1999, sa i takon organizimeve të nevojshme për linjat e
13 furnizimeve me armë zjarri dhe municion?

14 PË. Jo, në janar ka qenë e pamundur të shkoj sepse kanë qenë
15 ngjarjet rreth Reçakut dhe ka qenë e pamundur të jem në
16 Shqipëri por kam qenë në Kosovë në atë kohë.

17 PY. A ju kujtohet të keni shkuar në Shqipëri në periudhën nga
18 janari deri në ndërhyrjen e NATO-s në vitin 1999? Në atë
19 periudhë, keni shkuar ndonjëherë në Shqipëri?

20 PË. Kam qenë një periudhë që s'po më kujtohet cila periudhë e
21 saktë, por kam qenë për katër-pesë ditë në Shqipëri, pak para
22 ndërhyrjes së NATO-s.

23 PY. A ju kujtohet që keni marrë ndonjë udhëzim apo urdhër për
24 ta bërë këtë gjë, domethënë për të shkuar në Shqipëri, për
25 arsye të marrjes së armëve?

1 PË. Nuk më kujtohet, realisht.

2 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se më
3 lejoni, dëshiroj që t'i bëj me dije atë çfarë ka thënë në një
4 deklaratë të mëhershëm Dëshmitari, sipas Rregullës 143(2) (b)
5 dhe (c).

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni më
7 tej.

8 Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj që të paraqitet në ekran
9 dokumenti SITF00223935 deri në 00223961. Të shohim faqen
10 223954, paragrafi i parafundit. Versioni në shqip ka të
11 njëjtin numër ERN, vetëm përfundon me AT në vend të ET-së në
12 fund.

13 PY. Dëshmitar, sa për t'ju orientuar, kjo është pjesë e
14 deklaratës që i keni dhënë TPNJ-së në vitin 2001. Do të lexoj
15 një pjesë, pastaj do ju bëj një pyetje ose disa pyetje lidhur
16 me të.

17 "Pas varrimit në Reçak dhe para ndërhyrjes së NATO-s, unë
18 u caktova në zonën e Karadakut. Gjilani është qyteti më i madh
19 i kësaj zone. Unë isha në një takim me komandën e kësaj zone
20 për bashkërendimin e punëve të dy zonave: zonës së Nerodimes
21 dhe të Karadakut, për bashkërendimin e veprimtarisë së dy
22 Brigadave në luftimet e së ardhmes. Ata kishin më pak pajisje
23 krahasuar me zonën time, dhe atje nuk kishin pasur ende
24 luftime, por ishte fillimi. Pastaj shkova në Shqipëri nga
25 Maqedonia, dhe nga Shtabi qendror i UÇK-së kisha urdhër të

1 përgatisja linjën e furnizimeve të armëve të zjarrit dhe të
2 municioneve, sepse kufiri shqiptar ishte bllokuar. Unë duhej
3 të krijoja rrugë të reja. Kjo nuk ishte detyrë e lehtë.”

4 Këtë e keni deklaruar më herët në një deklaratë të
5 mëparshme tuajën. A është kjo e saktë, Dëshmitar?

6 PË. Ka disa gabime. Kur thuhet “Unë u caktova në zonën e
7 Karadakut”, në fakt unë shkova përmes zonës së Karadakut.
8 Gjilani ishte qyteti më i madh i kësaj zone. Unë isha në takim
9 me komandën e kësaj zone, dhe të caktohem në zonën e Karadakut
10 dhe të kontaktoj me komandën e zonës së Karadakut nuk ka
11 logjikë, por unë kam shku në zonën e Karadakut dhe jam takuar
12 me komandën e zonës së Karadakut, e cila ishte ende e pa -- pa
13 pas luftime, dhe ishte në konsolidim e sipër. Kjo është e
14 sakta.

15 PY. Më tej ju thoni:

16 “Më pas shkova në Shqipëri e pastaj në Maqedoni dhe ne në
17 Shqipëri kishim problem blerjen e armëve”, ndërkohë që më
18 sipër në tekst thoni që “kufiri me Shqipërinë ishte i
19 bllokuar”. Kjo pjesë, a është e vërtetë, Dëshmitar?

20 PË. Po, kjo pjesë po.

21 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim këtë dokument nga
22 ekrani.

23 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet ndonjë urdhër i UÇK-së për sa i
24 takon mobilizimit? A është lëshuar ndonjë urdhër i tillë
25 lidhur me mobilizimin rreth marsit apo prillit të vitit 1999?

1 PË. Më kujtohet se ka qenë një urdhër por nuk e di kohën e
2 saktë.

3 PY. Çfarë ju kujtohet në lidhje me këtë urdhër, me çfarë
4 kishte të bënte ai, çfarë trajtonte ky urdhër?

5 PË. Po, ai urdhër ishte për të gjithë ata të cilët ishin të
6 moshës madhore, domethënë mbi 18 vjeç deri, nëse nuk gaboju,
7 deri në 60 vjeç, që t'i bashkohen Ushtrisë Çlirimtare të
8 Kosovës dhe të mobilizohen për luftimet për çlirimin e
9 Kosovës, dhe ishte një thirrje për mobilizim të përgjithshëm.

10 PY. Kush e ka lëshuar këtë thirrje për mobilizim të
11 përgjithshëm?

12 PË. Po ka qenë nga Shtabi i Përgjithshëm, po nuk e kujtoj
13 saktë nga kush është nënshkruar.

14 PY. A ju kujtohet në qoftë se ka qenë me shkrim ky urdhër apo
15 e keni mësuar ndryshe, ka qenë një trajtë, formë tjetër?

16 PË. Jo, ky urdhër ka qenë me shkrim.

17 PY. Ku e keni pasur ju bazën në mars të vitit 1999?

18 PË. Në Mullapolc, në të njëjtin vend.

19 PY. Rreth marsit të vitit 1999, a keni qenë ndonjëherë i
20 pranishëm në Pushtan [Sipas përkthimit]?

21 PË. Nuk kam dëgju.

22 PY. A ishit i pranishëm në Pushtanik në mars të vitit 1999?

23 Atëherë, e përsëris edhe një herë. Në mars, apo rreth marsit
24 të vitit 1999, a ke pas ndonjë herë bazën në Pushtanik ose e
25 ke vizituar ndonjëherë Pushtanikun?

1 PË. Bazën nuk e kam pas në Pushtanik, po kam pasur ushtarë
2 atje që të cilët kanë qenë një kompani apo një batalion. Nuk
3 më kujtohet.

4 PY. A e mban mend që ke vizituar Pustenikun, apo territorin
5 ku kishit ushtarët, në mars të vitit 1999?

6 PË. Nuk di në ka qenë mars apo në kthim nga Shqipëria, përmes
7 Maqedonisë, i kam vizituar territorin ku ka qenë në operim
8 Brigada 162, Agim Bajrami, dhe në kuadër të këtyre njësiveve,
9 kanë qenë edhe njësitet e Pustenikut.

10 PY. Nga pikëpamja kohore, the pas kthimit nga Shqipëria
11 përmes Maqedonisë. A ju kujtohet, me përafërsi, kur ka ndodhur
12 kjo?

13 PË. Kjo para -- në kohën kur ka filluar intervenimet e NATO-s
14 unë kam qenë në atë pjesë.

15 PY. Që të jemi të qartë, kur filluan ndërhyrjet e NATO-s, ju
16 ku ishit? A ishit në Shqipëri? Në Maqedoni, apo në Pustenik?

17 PË. Jo, unë kur kanë filluar në fillim, domethënë, kur kanë
18 filluar bombardimet e NATO-s unë kam qenë në Shqipëri dhe
19 menjëherë kam filluar rrugëtimin për të hyrë në Kosovë.

20 PY. Me përafërsi, të kujtohet sa ditë t'u deshën për t'u
21 kthyer në Kosovë që nga momenti i fillimit.

22 PË. Më falni, kam dëgjimin shumë të ulët. Domethënë, nuk po
23 dëgjoj mirë. Provoni --

24 PY. Na dëgjon mirë?

25 PË. Po, tash më mirë.

1 PY. Atëherë po e përsërisim edhe pyetjen, Dëshmitar. A ju
2 kujtohet me përafërsi, sa kohë t'u deshën për t'u kthyer në
3 Kosovë, pra, sa ditë t'u deshën që të ktheheshe në Kosovë, nga
4 momenti i fillimit të bombardimeve?

5 PË. Nuk e di sa kohë, mund të jenë katër-pesë ditë.

6 PY. Thatë pas kthimit keni shkuar në territorin ku ishte
7 operacionale, pra ku vepronte Brigada 162. A pate ndonjë arsye
8 konkrete pse shkuat në atë kohë atje?

9 PË. Po, unë kaloja nëpër territoret ku operonte Brigada 162,
10 për të kaluar te selia ime, apo te Shtabi ku e kisha të
11 organizume në Mullapolc.

12 PY. A e mban mend sa kohë qëndrove me Brigadën 162?

13 PË. Nuk më kujtohet saktë, po mund të jetë një natë, ose dy.

14 PY. Pas kësaj shkove në Mullapolc?

15 PË. Nuk e di saktë, po vështirësitë e kalimit kanë qenë bukur
16 të mëdha, dhe normalisht është dasht të sigurohet rruga për të
17 kaluar për në Mullapolc. Mund të jenë një, një ditë apo dy. Në
18 fakt, një natë apo dy, sepse gjatë natës kemi kaluar.

19 PY. Që të sigurohemi që po kuptohemi, atëherë, fillojnë
20 bombardimet e NATO-s. Ju futeni në Kosovë pas disa ditësh, dhe
21 shkoni në territorin ku ishte brigada 162. Një a dy ditë, ose
22 net më vonë, u ktheve sërish në Mullapolc. E kam kuptuar
23 saktë?

24 PË. Po, kështu është.

25 PY. Brigada 162 cilën kishte si zonë përgjegjësie? Pra, cilën

1 vend kishte në zonën e përgjegjësisë së vet.

2 PË. Po, kryesisht ka qenë territori i komunës së Kaçanikut
3 dhe e Elez Hanit.

4 PY. Dëgjova Kaçanik, po nuk e kuptuam vendin e dytë.

5 Përsëriteni edhe një herë ju lutem.

6 PË. Komuna e Elez Hanit, apo Hani i Elezit.

7 PY. Të kujtohet emri i ndonjë fshati që në Kaçanik?

8 PË. Po, kanë qenë shumë fshatra, nuk e di saktë, por aty ku
9 jemi shkuar ne e quanin Ndërtesa e Rambujesë. Kështu quhet.

10 PY. Po Ivaja a ka qenë briga -- në Brigadën 162, nëse ju
11 kujtohet?

12 PË. Fshati Ivajë ka qenë në kuadër të zonës së përgjegjësisë
13 së Brigadës 162.

14 PY. Kur ka qenë kjo? Nga fundi i vitit 1998, përgjatë vitit
15 1999 e deri në fund të luftës?

16 PË. Komunikata ka qenë në periudhën e vitit 1999, e po flasim
17 për kohën e bombardimeve të NATO-s dhe fundin e luftës.

18 PY. Në fillim të vitit 1999, për shembull, në janar të vitit
19 1999, Kaçaniku a ka qenë në zonën e përgjegjësisë së Brigadës
20 162?

21 PË. Po, ka qenë në zonë e përgjegjësisë, por nuk kanë operuar
22 në këtë zonë të përgjegjësisë sepse janë kenë -- kanë qenë
23 ende në përgatitje të strukturave dhe pozicionimeve.

24 PY. Kush vepronte atëherë në këtë zonë?

25 PË. Vepronin si brigadë, por në fakt nuk kishte - nuk kishte

1 operacione luftarake. Ata konsolidoheshin, mundoheshin të për
2 përcaktonin vendet ku do të qëndroni, e të organizonin
3 njësitet e Brigadës. Kjo ka qenë veprimtaria e tyre në atë
4 kohë.

5 PY. Brigada 162 a kishte ndonjë zyrë qendrore, a ndonjë seli
6 në shkurt ose mars të vitit 1999?

7 PË. Në këtë periudhë nuk po e di, në mars, por në shkurt
8 sigurisht jo. Në shkurt një pjesë e ushtarëve të Brigadës 162
9 e kanë ardhur në ndihmë njësiteve të Brigadës 162, në
10 territorin e përgjegjësisë së kësaj Brigade, dhe në komunën e
11 Shtimes.

12 PY. A të kujtohet çfarë ndërtesash apo objektesh ka përdorur
13 UÇK-ja në Ivajë në vitin 1999?

14 PË. Në Ivajë nuk i di çfarë objektesh sepse nuk i kam ditë të
15 gjithë objektet që ka mujt me përdor Brigada 162, po ka
16 përdorur shtëpia private për të vendosur komanda.

17 PY. Po ju personalisht, keni shkuar në Ivajë në vitin 1999?

18 PË. Eh, nuk e di që kam shku në Ivajë. S'e di si është
19 quajtur vendi ku jam ndalë për një natë, e po ata e quanin
20 Ndërtesa e Rambujesë, aty ku kemi fjet, ku ishin edhe ushtarët
21 ku ushqeheshin.

22 PY. Cilët ushtarë ushqeheshin atje, ushtarë të ndonjë njësiti
23 të caktuar, apo më gjerë?

24 PË. Jo, aty ishte komanda dhe ushtarët kryesisht të komandës
25 së Brigadës 162, e ku komandant ishte Qamil Iliazi.

1 PY. Në vitin 1999, a ka pasur ndonjë sulm në Ivajë me sa ju
2 kujtohet?

3 PË. Edhe një herë se s' --

4 PY. Ka pasur ndonjë sulm në Ivajë në vitin 1999? Pati ndonjë
5 moment, në ndonjë moment me sa ju kujtohet ju, në Ivajë, a
6 pati ndonjë sulm, ka ndodhur ndonjë sulm?

7 PË. S'po e kuptoj pyetjen -- atë -- ose përkthimi është i
8 dobët.

9 PY. Po e bëj pyetjen ndryshe. A ka ndodhur, a ka pasur ndonjë
10 sulm, sulm në Ivajë në mars të vitit 1999? Keni dijeni për
11 diçka të tillë?

12 PË. Eh, nuk më kujtohet.

13 PY. A është -- në vitin 1999, a është bërë ndonjë shkatërrim
14 i pronave në Ivajë? Janë dëmtuar prona në Ivajë në vitin 1999?

15 PË. Në vitin 1999 Kotline dhe në Ivajë ka ndodhur jo vetëm
16 shkatërrime të pronave por kanë ndodhur masakra edhe në civilë
17 nga forcat pushtuese serbe. Dhe në vitin 1999 ka ndodhur edhe
18 masakrat brenda qytetit të Kaçanikut dhe kemi pas bukur shumë
19 ushtarë -- ushtarë të rënë dëshmorë.

20 PY. A e mbani mend kur ka ndodhur në vitin 1999 këto masakra,
21 këto sulme, në cilët muaj?

22 PË. Po, rreth muajit prill, nuk e kujtoj dot datën e saktë,
23 por prill maj, sigurisht.

24 PY. Më herët na thatë që qendra e zonës operative të
25 Nerodimës në vitin 1999 ka qenë në Mullapolc. Kështu?

1 PË. Po.

2 PY. A ju kujtohet çfarë ndërtese apo ndërtesash ka përdorur
3 në Mullapolc zona operative e Nerodimës?

4 PË. Ka përdorur një lagje e cila ka qenë në grykë të
5 Mullapolcit, dhe ka pasur disa ndërtesa, të cilat kanë qenë
6 pronë e qytetarëve shqiptarë të Kosovës. Të fshatit Mullapolc.

7 PY. A kam kuptuar saktë që më përpara ju thatë ka qenë një
8 spital diku afër Shtabit në Mullapolc?

9 PË. Po, e kemi pas spitalin ushtarak.

10 PY. Përmende grykën e Mullapolcit. Ka pasur ndonjë emër kjo
11 grykë?

12 PË. Nuk di që ka pas ndonjë emër, por gryka e Mullapolcit,
13 kështu e kemi quajtur ne.

14 PY. Nëse ishte nevoja të kontaktonit Shtabin e Përgjithshëm
15 të UÇK-së ose të shkonit atje, nga Mullapolci, si munde -- si
16 mundeshit të shkonit?

17 PË. Realisht ne nuk kemi pas nevojë të e taku Shtabin e
18 Përgjithshëm në atë kohë sepse nëse nuk gaboj, në maj në zonën
19 time ka qenë shefi i shtabit, z. Agim Çeku, i cili ka qenë i
20 emëruar shefi i Shtabit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

21 PY. Po gryka e Luzhakut a ka qenë në zonën e përgjegjësisë së
22 Nerodimës?

23 PË. Po.

24 PY. Nga Petrova dhe -- domethënë, fillon nga tre -- Petrova,
25 më falni, dhe përfshin edhe fshatin Luzhakë, apo jo?

1 PË. Po, gryka e Luzhakut është pjesa prej Petrovës deri në
2 Luzhakë. Është një grykë e thellë e cila në periudhën e luftës
3 na ka shërby për t'i mbrojtur popullatën civile apo për t'u
4 vendosur popullatat civile. Në veçanti na ka shërbyer shumë në
5 ofensivën e fundit të verës së vitit 1999, e ku kanë qenë të
6 vendosur shumë civilë të atyre fshatrave.

7 PY. Me sa kujtoni ju, pra, sa larg ka qenë kjo gryka nga
8 kufiri me zonën e Pashtrikut?

9 PË. Zona e Pashtrikut ka qenë në pjesën e Budakovës. Ajo ka
10 përfshi fshatin Budakovë, dhe nga gryka e Luzhakut mund të
11 ketë pasur shtatë - tetë kilometra.

12 PY. A mbani mend që të keni thënë që rruga përmes grykës ka
13 qenë e rëndësishme për të mbajtur kontakte me Shtabin e
14 Përgjithshëm. Mbani mend ta keni thënë këtë?

15 PË. Po, e kam thënë sepse ka qenë gryka e cila na ka ndihmu
16 të komunikohemi. Përveç komunikimit fizik, e të komunikojmë
17 edhe përmes mjeteve tona të transportit, me zonën operative të
18 Pashtrikut e na ka ndihmu për të depërtuar në zona të tjera
19 dhe për të kontaktuar me anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm
20 apo me nevojat që kemi pas në atë kohë.

21 PY. Kush ka qenë komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-
22 së?

23 PË. Vonë e kemi kuptuar, në veçanti e kemi kuptuar në një
24 mbledhje të komandantëve të zonave ku ka qenë edhe shefi i
25 Shtabit. Komandanti i Përgjithshëm i UÇK-së ka qenë Azem Sylja,

1 që më vonë është ndërruar.

2 PY. Ky takim që sapo përmendët, kur është mbajtur?

3 PË. Është mbajtur në kohën e konferencës së Rambujesë në
4 periudhën që duhet të jetë në maj, diku.

5 PY. Me sa keni ju dijeni, ka pasur një zëvendës komandant
6 Shtabi i Përgjithshëm apo ka pasur më shumë?

7 PË. Ëh, këtë nuk e di. E di që në atë takim, domethënë është
8 potencuar që komandanti i përgjithshëm është Azem Sylja, dhe
9 komandantët e zonave kanë kërkuar që këta të jenë përgjegjës
10 për ta emëruar komandantin e përgjithshëm, meqë janë
11 drejtpërdrejtë të lidhur në kuptimin e formacioneve ushtarake
12 dhe veprimeve luftarake, të jenë përgjegjës për caktimin e
13 komandantit të përgjithshëm.

14 PY. Pak më herët thatë se Bislir Zyrapi ka qenë shefi i
15 Shtabit, i Shtabit të Përgjithshëm, kështu?

16 PË. Po, ka qenë deri në një periudhë - deri në periudhën e
17 fundit të luftës. Ka qenë shefi i Shtabit të Ushtrisë
18 Çlirimtare të Kosovës.

19 PY. Keni dijeni kush ka qenë përgjegjës për çështjet politike
20 brenda Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

21 PË. Po, atëherë kur janë bërë publike, nëse nuk gaboj, janë
22 ba publike në prill ose në maj, po sidomos me shkuarjen në
23 Rambuje, janë bërë publike e kush janë përgjegjës politikë, që
24 cilët i kemi njohur edhe publikisht, si përgjegjës politikë në
25 atë kohë. Përgjegjësi kryesor, përgjegjësi kryesor politik dhe

1 njeri më autoritativ politik, ka qenë z. Hashim Thaçi, në
2 kuadër të të cilit në delegacion kanë qenë edhe z. Jakup
3 Krasniqi, si -- ka qenë zëdhënës, në një -- i Ushtrisë
4 Çlirimtare të Kosovës. E pjesë e delegacionit kanë qenë pastaj
5 edhe njerëz të tjerë që për momentin nuk po më kujtohen. Po,
6 ka qenë edhe vëllai im, më falni.

7 PY. Me sa dini ju, kush ka qenë përgjegjës për policinë
8 ushtarake pranë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

9 PË. Realisht unë nuk kam qenë anëtar i Shtabit të
10 Përgjithshëm, dhe nuk e kam ditur zyrtarisht. Po e kam -- jam
11 njoftuar në momentin kur janë bërë publikë emrat e njerëzve të
12 anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm, të cilët i ka publikuar
13 vetë Shtabi i Përgjithshëm. E nëse nuk gaboj, Drejtor i
14 Drejtorisë së Policisë fillimisht është caktuar Fatmir Limaj.
15 Më vonë Rexhep Selimi. Po këto edhe mund të gaboj.

16 PY. Po vëllai juaj, Ramë Buja, a ka qenë ndonjëherë anëtar i
17 Shtabit të Përgjithshëm në ndonjë moment të caktuar?

18 PË. Sipas njoftimeve nga vetë vëllai im, në nëntorin e vitit
19 1998, është emëruar anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, edhe në
20 këtë publikim nëse nuk gaboj, ai ka qenë drejtori i drejtorisë
21 për administrim civil.

22 PY. A e dini çfarë nënkuptonte -- çfarë detyrash kishte
23 vëllai juaj në këtë pozicion që sapo përmendët ju?

24 PË. Këtë nuk mund ta sqaroj plotësisht po e di që është marrë
25 me organizimin e drejtorive civile, të cilat janë organizuar

1 në çdo zonë, dhe jemi munduar të organizojmë përmes drejtorive
2 civile në çdo -- në çdo vend apo në çdo qytet, të cilin e kemi
3 pas në zonat tona të përgjegjësisë.

4 PY. Me sa dini ju, këtë rol ai e ka marrë nga nëntori i vitit
5 1998, kur u emëruar, sipas jush?

6 PË. Jo, nga nëntori s'besoj, po kur është bërë publike
7 emërtimet në Shtab të Përgjithshëm, është ditë që Ramë Buja
8 është drejtori i drejtorisë të administrimit civil.

9 PY. Kur thoni që u bë publik, e keni fjalën për periudhën
10 prill ose maj?

11 PË. Po, në atë periudhë nuk më kujtohet saktë, po në atë
12 periudhë janë bërë publike emrat e drejtorëve të drejtorive.

13 PY. Me sa keni ju dijenu -- dijeni, më falni, vëllai juaj
14 Ramë, çfarë ka bërë nga nëntori i vitit 1998, kur ju thoni që
15 ai u emëruar, e deri nga prilli dhe maji kur u bënë publik
16 emrat e anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm? Në këtë
17 periudhë, pra, çfarë ka bërë ai?

18 PË. Këtë nuk e di saktë. Sepse unë kam qenë në zonën
19 operative të Nerodimes dhe territorialisht kemi qenë shumë
20 larg njëri-tjetrit.

21 PY. Po Kadri Veseli a ka qenë anëtar i Shtabit të
22 Përgjithshëm të UÇK-së me sa dini ju?

23 PË. Në prill dhe në -- fundit, pas publikimit, e kam kuptu se
24 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm ka qenë edhe Kadri Veseli.

25 PY. Me sa keni ju dijeni, çfarë roli kishte, çfarë cilësie?

1 PË. Në publikim është thënë që drejtor i drejtorisë së
2 zbulimit.

3 PY. Shtabi i Përgjithshëm së UÇK-së, apo më së paku një pjesë
4 e atij Shtabi, a ka qenë ndonjëherë e vendosur në zonën
5 operative të Nerodimes, ka pasur bazë në Nerodimë?

6 PË. Po, ka qenë i vendosur një pjesë e Shtabit të
7 Përgjithshëm e në kohën e fillimit të konsolidimit, apo të
8 emërimit të qeverisë së përkohshme.

9 PY. Të kujtohet në cilin muaj ose muaj, ose cilin vit ka qenë
10 kjo?

11 PË. Kjo ka qenë në muajin maj, nëse s'gaboj, e në këtë vitin
12 1999 dhe fillimi i qershorit.

13 PY. Ju thatë që një pjesë e Shtabit të Përgjithshëm ka qenë
14 në zonën operative të Nerodimes. Në këtë periudhë kohore,
15 cilët persona nga Shtabi i Përgjithshëm kanë qëndruar në
16 Nerodime?

17 PË. Nëse i kujtoj, ka qenë Hashim Thaçi, ka qenë vëllai im,
18 Ramë Buja, ka qenë Fatmir Limaj, ka qenë Kadri Veseli. Këta që
19 më kujtohen.

20 PY. Po Rexhem Selimi ka qe qenë një prej këtyre personave?

21 PË. Nuk më kujtohet që ka qenë aty, sepse nuk besoj që ka
22 qenë në këtë pjesë.

23 PY. Në cilën pjesë të zonës suaj kanë qenë këta anëtarë të
24 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së të vendosur?

25 PË. Po, në fillim të majit, kanë qenë të vendosur në fshatin

1 Dremjak, e pas ofensivës bukur tash për -- dhe mbas mundësisë
2 tonë që ta mbrojmë këtë fshat dhe tërheqjes së qytetarëve
3 bukur me mundim nga ushtarët tonë nga Dremjaku, janë tërhequr
4 edhe këta anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm dhe janë vendosur
5 në fshatin Petrov.

6 PY. Po ju personalisht keni takuar ndonjë anëtar të Shtabit
7 të Përgjithshëm kur kanë qenë në këtë vend?

8 PË. Po, normalisht që i takoja sepse ishin në territorin ku e
9 -- përgjegjësinë e komandimit e kisha unë dhe normalisht që
10 kam kontakt bukur shpesh sepse është dashtur edhe të kujdesem
11 për logjistikën e tyre, për vendqëndrimin e tyre dhe për
12 kushtet të cilat është dashur t'i kenë në kohën e luftës dhe
13 në rrethanat të luftës.

14 PY. Të kujtohet ku, në cilin vend i ke takuar?

15 PË. Po i kam takuar edhe në fshatin Dremjak, kur kanë qenë,
16 po më shumë kanë qëndruar dhe i kam takuar në fshatin Petrovë.

17 PY. Nga me -- për periudhën kohore, a jeni sikur për
18 periudhën kohore që po thoni, që vërtetë ka qenë rreth majit
19 të vitit 1999?

20 PË. Po, maji, fillimi i qershorit. Këtu kanë qenë.

21 PY. A ju kujtohet të keni thënë ndonjëherë që kjo mund të
22 ketë ndodhur nga fundi i marsit të vitit 1999?

23 PË. Fundi i marsit? S'besoj që e kam thënë, por ka mundësi ta
24 kem thënë fund të prillit, jo në fund të marsit. Nuk, nuk
25 besoj që ka mujt ta them.

1 PY. A ju kujtohet sa kohë kanë qëndruar ata në këtë territor
2 në zonën tuaj?

3 PË. Një pjesë e Shtabit të Përgjithshëm ka qëndruar përreth
4 një muaji, pra përreth një muaji, dhe kanë rrugëtuar për në
5 Berishë, në malet e Berishës, ndërsa një pjesë kanë qëndruar
6 në zonën time.

7 PY. Kush ka qenë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm që qëndroi
8 përreth një muaj, cilët prej Shtabit?

9 PË. Po anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm që kanë qëndruar
10 rreth një muaj kanë qenë z. Hashim Thaçi, ka qenë z. Fatmir
11 Limaj dhe një pjesë të cilët kanë ardh në zonën më vonë, po
12 këta e kanë qenë kryesisht të Shtabit të Përgjithshëm, Ramë
13 Buja i cili ne -- ndërkohë qenë në spital ushtarak, dhe z.
14 Kadri Veseli.

15 PY. A mbani mend çfarë ka bërë z. Hashim Thaçi gjatë
16 qëndrimit të tij në zonën tuaj?

17 PË. Po, gjatë qëndrimit në zonën time kryesisht është marrë
18 me mundësi të organizimit të Qeverisë së Përkohshme dhe ka
19 kontaktuar drejtpërdrejtë me telefona, me politikanë
20 ndërkombëtarë që unë nuk kam qenë kompetent as t'i di, as edhe
21 nuk e di se --

22 PY. Nga e dini ju që ai ka qenë në kontakt me ndërkombëtarët
23 në këtë periudhë kohore?

24 PË. Po, ka ndodh kur kam qenë prezent në vendin ku kanë
25 qëndruar anëtarët e Shtabit dhe ka kontaktuar me telefon me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 125

1 politikanë ndërkombëtarë, të cilët kanë thirr ose z. Thaçi i
2 ka thirr në telefon.

3 PY. Përveç këtyre thirrjeve telefona - telefonike, më falni,
4 të z. Thaçi, a ju kujtohet ndonjë detyrë tjetër konkrete që ka
5 kryer ai në kohën që ka qëndruar në zonën tuaj?

6 PË. Jo, këtë nuk kam mund ta di sepse ka qenë çështje e
7 nivelit tjetër.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace,
9 duhet të bëjmë pushimin.

10 Do bëjmë dhjetë minuta pushim, Dëshmitar. Njësoj, ju
11 lutem, si më herët, mos flisni me askënd për dëshminë tuaj.

12 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

13 --- Pauza fillon në orën 15.31

14 --- Seanca rifillon në orën 15.42

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

16 Asistente, ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, mund
19 të vazhdoni me pyetjet tuaja.

20 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

21 PY. Dëshmitar, përpara sesa të merrnim pushimin, unë ju pyeta
22 lidhur me veprimtari që, sipas asaj që dini ju, ka ndërmarrë
23 Hashim Thaçi kur e ka pasur bazën në zonën tuaj operative. Ju
24 përmendët gjithashtu që edhe Kadri Veseli e ka pas bazën aty
25 gjatë kësaj periudhe. A mund të na thoni ju lutem, mesa dini

1 ju, çfarë veprimtarish apo çfarë aktiviteteve ka bërë Kadri

2 Veseli gjatë kohës që ka qenë aty?

3 PË. Realisht nuk e di veprimtaritë. Po ato që i kam pa ka
4 qenë bashkë me Hashim Thaçin dhe me anëtarë tjerë të Shtabit
5 të Përgjithshëm. Po unë nuk kam dit se çfarë veprimtarish po
6 bëjnë aty sepse nuk kam qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm.

7 PY. Përmendët se e dinit që Hashim Thaçi bënte thirrje
8 telefonike, mesa thatë juve, ju besoni që kanë qenë persona
9 ndërkombëtarë. Me sa ju kujtohet ju a e ka bërë këtë gjë dhe
10 Kadri Veseli, Dëshmitar?

11 PË. Këtë nuk e kam pa. Po Hashim Thaçin e kam pa që ka
12 komunikuar sa kam qenë unë këto.

13 PY. A keni marrë pjesë ndonjëherë apo keni mësuar ndonjëherë
14 lidhur me ndonjë takim të Shtabit të Përgjithshëm ndërkohë që
15 Shtabi i Përgjithshëm e ka pas bazën në zonën tuaj?

16 PË. Kam mujt me marrë pjesë në ndonjë takim, po unë s'kam pas
17 të drejtën as të diskutimit, as të votimit aty.

18 PY. A ju kujtohet që keni marrë pjesë në një takim në atë
19 kohë kur Shtabi i Përgjithshëm e ka pas bazën në zonën tuaj?

20 PË. Takim zyrtar jo, po që është biseduar për çështje
21 politike kam qenë pjesë e takimit.

22 PY. Çfarë çështje politike është diskutuar në këtë takim që
23 keni parasysh ju?

24 PË. Po është biseduar për marrëveshjen e Rambujesë se ka qenë
25 bukur rëndë të vendoset sesi të veprohet, do të thotë, është

1 fol për Konferencën e Rambujesë.

2 PY. A ju kujtohet të keni marrë pjesë në ndonjë takim në
3 Petrovë në atë kohë kur Shtabi i Përgjithshëm e ka pas bazën
4 në zonën tuaj operative?

5 PË. Po kur fola për këtë takim, do të thotë, fola për kur e
6 ka pas bazën në Petrovë sepse në Petrovë ka qenë.

7 PY. A ju kujtohet të keni marrë pjesë në ndonjë takim ku
8 është diskutuar Operacioni Shigjeta?

9 PË. Jo, nuk më kujtohet.

10 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se më
11 lejoni dëshiroj t'i tregoj një pjesë të deklaratës së
12 mëhershme të dëshmitarit në pajtim me rregullin 143(2) (b) dhe
13 (c).

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
15 vazhdoni.

16 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem, paraqisni në ekran
17 dokumentin SITF00009397 deri në 00009417. Të shohim faqen që
18 përfundon me 9402 deri në faqen 9404. Në shqip do fillojmë me
19 të njëjtin dokument, megjithatë faqet që dua të paraqiten janë
20 9413 deri në 9414. Do të filloj leximin nga pyetja 57.

21 PY. Dëshmitar, teksti në shqip është në të majtë të ekranit,
22 ndërkohë që në anglisht janë në të djathtë. Këto janë pyetje
23 nga seanca në 2011 në çështjen Arben Krasniqi dhe të tjerët.
24 Do lexoj disa prej pyetjeve dhe përgjigjeve dhe pastaj do ju
25 bëj disa pyetje ju, Dëshmitar.

1 Pyetje: "Gjatë periudhës kur vëllai juaj dhe anëtarë të
2 tjerë të SHP-së kanë qenë aty a keni marrë pjesë ju në ndonjë
3 takim?"

4 "SB. Kam marrë pjesë vetëm në një takime në Petrovë."

5 Pyetje: "Cila ka qenë tema e takimit?"

6 "SB: Emërimi i komandantit të Operacionit Shigjeta."

7 Pyetje: "Kush është caktuar si komandant?"

8 "SB: Fatmir Limaj."

9 Pyetje: "A ju kujtohet se kush ka marrë pjesë në takim?"

10 "SB: Unë kam qenë aty megjithëse unë vetë nuk kam pas të
11 drejtën të flas. Plus kanë qenë Hashim Thaçi, Kadri Veseli,
12 Sylejman Selimi, Rexhep Selimi dhe Fatmir Limaj."

13 Pyetje: "Po Agim Çeku?"

14 Përgjigje: "Po."

15 Pyetje: "Po vëllai yt, Rama?"

16 Përgjigje: "Po".

17 Pyetje: "Jakup Krasniqi?"

18 Përgjigje: "Jo."

19 Pyetje: "Bislim Zyrapi?"

20 Përgjigje: "Jo."

21 Pyetje: "A kishte pjesëtarë të tjerë të SHP-së,
22 gjithashtu, në atë kohë?"

23 Përgjigje: "Po, ata kishin takime të tjera, përfshirë
24 fshatin Jezercë në të cilin unë nuk kam marrë pjesë."

25 Pyetje: "Si e dini ju këtë?"

1 Përgjigje: "Sepse si komandant i zonës unë kam qenë
2 përgjegjës për sigurimin e këtyre takimeve. Prandaj unë isha i
3 njoftuar paraprakisht kudo që ata mbanin takimet."

4 Dëshmitar, këtu shohim që ju në pjesën e parë flisni që
5 keni marrë pjesë në një takim në Petrovë lidhur me caktimin e
6 komandantit të Operacionit Shigjeta, pozicion në të cilin u
7 zgjodh Fatmir Limaj. A ju kujtohet ky takim, Dëshmitar?

8 PË. Jo, jo, nuk është tu mu kujtu, po ndoshta kam marrë
9 pjesë. S'është tu mu kujtu.

10 PY. Për ta sqaruar, Dëshmitar, "ndoshta ai ka marrë pjesë",
11 për kë e keni pas fjalën, për kë e kishit fjalën tani që thatë
12 që ndoshta "ai" ka marrë pjesë?

13 PË. Po them ndoshta kam marrë pjesë. Sepse e sqaroj dhe këtu,
14 nuk kam qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Ka mujt me qenë
15 prezent aty në kohën kur jam kujdesur për sigurinë e tyre që
16 ushtarët të jenë, do të thotë, në nivelin që duhej me qenë
17 sigurimi i tyre dhe kam mujt me qenë pjesë e këtij takimi për
18 një kohë apo një periudhë të shkurtër.

19 PY. Këtu shohim sa i takon këtij takimi që ju thoni që:

20 "Unë kam qenë aty megjithëse nuk kam pas të drejtë të
21 flas."

22 A përkon kjo me atë çfarë ju kujtohet ju për këtë
23 ngjarje, Dëshmitar?

24 PË. Po, po më kujtohet. Se unë s'kam qenë anëtar i Shtabit të
25 Përgjithshëm dhe e drejta ime për të folur apo për të

1 diskutuar aty nuk ka qenë, do të thotë, unë nuk e kam pas këtë
2 të drejtë. Dhe kam mujt me u prezantu për një periudhë të
3 shkurtë dhe me u largu pastaj.

4 PY. Në këtë fragment ne shohim që ju thoni:

5 "Gjithashtu që ata kanë pasur takime të tjera, përfshirë
6 këtu edhe në fshatin Jezercë ku unë nuk kam marrë pjesë."

7 Pastaj kur pyeteni si e dini ju këtë, ju thoni:

8 "Sepse si komandant zone unë kam qenë përgjegjës për
9 sigurimin e këtyre takimeve, prandaj unë isha i njoftuar
10 paraprakisht kudo që ata mbanin takimet."

11 A ju kujton diçka ju kjo që sapo lexova sa i takon
12 takimeve të organizuara nga Shtabi i Përgjithshëm në kohën kur
13 ata e kishin bazën në zonën tuaj?

14 PË. Po, kanë qenë dhe në Jezercë. Do të thotë, tash s'po më
15 kujtohet, po sigurisht kur e kam dhënë këtë deklaratë e kam
16 pas parasysh që kanë mbajtur takime dhe në Jezercë sepse janë
17 vendosë në një shtëpi të gjithë anëtarët e Shtabit të
18 Përgjithshëm për një natë dhe unë kam pas me e siguru atë, atë
19 shtëpi aty, kam pas për detyrë.

20 Z. PACE: [Përkthim] Vazhdojmë më tej. Mund ta heqim
21 dokumentin nga ekrani. Ndërkohë do kërkoja që të paraqitet në
22 ekran prova P01015 në anglisht dhe në shqip. Në versionin në
23 anglisht të shohim faqen 036807, ndërkohë që në shqip do
24 kërkoja që të shihnim dokumentin 07727. Në qoftë se e keni të
25 nevojshme mund të jap numrin e plotë ERN se ndoshta nuk e

1 dhashë të saktë numrin e provës. Në qoftë se është ky rasti
2 dokumenti është 03622. Ndërkohë që në shqip është 077039-
3 0770258. Sikurse e thashë dhe më herët në anglisht dua të
4 paraqitet faqja 036807, ndërkohë që në shqip 077227. Është
5 dokument që mund të transmetohet për publikun.

6 PY. Dëshmitar, faqja që do të shikojmë është nga libri që
7 pamë dhe më herët bashkë, pra, është ky libri që ju thatë që
8 ju jeni bashkërecensues i tij, që e përcaktuam më herët.

9 Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se e ndihmoj Sekretaren në
10 versionin në PDF në shqip dhe në anglisht dokumenti ka 186 në
11 anglisht dhe 189 në shqip. Faleminderit.

12 PY. Dëshmitar, keni disa fotografi në ekran. Në të majtë
13 shënimet në fund të fotografive janë në shqip, ndërkohë që në
14 të djathtë janë në anglisht. Ju lutem lexojini këto tekstet
15 poshtë fotografive dhe shikoni fotografitë.

16 Z. PACE: [Përkthim] Nëse është e mundur do i kërkoja
17 Sekretares ta zmadhojë pak fotografinë.

18 PY. Dëshmitar, a njihni ndonjë prej këtyre fotografive?

19 PË. Po. Po e shoh që është drejtori i drejtorisë politike të
20 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Thaçi. Po nuk ka qenë në
21 vizitë në komandën e Brigadës 162, po ka qenë, nëse nuk gaboja,
22 gjatë kalimit për konferencën e Rambujesë, në kthim ose ishin
23 në shkuarje. Nuk e di saktë.

24 PY. Nga e dini që Hashim Thaçi ka kaluar në atë zonë në atë
25 kohë?

1 PË. Kam qenë komandant i zonës dhe është normale që ta di,
2 një delegacion i lartë ushtarak me kalu nëpër zonën time, do
3 të thotë, është dashur ta di si komandant i zonës.

4 PY. Në këtë rast a ju kujtohet se kush tjetër ka qenë pjesë e
5 delegacionit në zonën tuaj?

6 PË. Po këtu shifet që ka qenë edhe Agim Çeku. Edhe sigurisht
7 që ka qenë edhe Agim Çeku i cili më vonë është emëruar shef i
8 shtabit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

9 PY. A mund të na thoni, pra, në qoftë se do shikojmë shqipen
10 në të majtë, Agim Çeku a është ndokund në këtë fotografi?

11 Domethënë, ndoshta në fotografitë e mesit, në fund, a mund të
12 na thoni në qoftë se shikoni Agim Çekun ndokund?

13 PË. Po më duket se është Agim Çeku ky ul. E ndërsa vëllai im,
14 Ramë Buja, është në këmbë.

15 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem zmadhojeni në fotografitë
16 mesit. Fotografinë në cep në të majtë. Këtë fotografinë që
17 keni këtu, ju lutem zmadhojeni pak më shumë që ta shohim më
18 qartë.

19 PY. Dëshmitar, për këtë fotografi e keni fjalën, kjo që është
20 e zmadhuar --

21 PË. Po. Po.

22 PY. -- në ekran që është vëllai juaj dhe Agim Çeku?

23 Thatë që Agim Çeku është i ulur ndenjtur, është personi në
24 mes Agim Çeku apo është ai që është në anë?

25 PË. Ky personi në mes është, së paku si po mund ta

1 identifikoj unë, është Agim Çeku. Ndërsa personi në këmbë
2 është vëllai im, Ramë Buja.
3 PY. Ky është personi i parë, Ramë Buja, domethënë, vëllai
4 juaj është personi që qëndron në këmbë dhe që është personi i
5 parë nga e majta, kështu?

6 PË. Po, e para nga e majta.

7 PY. Tani, zmadhojmë fotografinë që është ngjitur me këtë
8 fotografi. Këtu shohim që në tekstin poshtë fotografisë në
9 librin e Hajrush Kurtajt thuhet:

10 "Delegacioni i SHP-së së UÇK-së gjatë qëndrimit në
11 Brigadën 162 'Agim Bajrami' më 5 prill 1999 në malet e
12 Kaçanikut."

13 Mesa ju kujtohet juve a është ky vendi i saktë dhe a
14 është kjo ngjarja e saktë?

15 PË. Jo, këtu nuk mund të them me saktësi sepse nuk e di në
16 fakt. Nuk kam qenë në atë kohë aty dhe nga fotografia nuk mund
17 ta identifikoj se ku është saktë kjo fotografi.

18 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim nga ekrani dokumentin.

19 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet në qoftë se gjatë kësaj periudhe
20 ka pasur një pjesë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së që ka
21 qenë me bazë në zonën tuaj, nëse ka pasur sulme në zonë gjatë
22 kësaj periudhe kur një pjesë e Shtabit të Përgjithshëm e ka
23 pas bazën në zonën tuaj?

24 PË. Kur ka arrit delegacioni nga Maqedonia në territorin e
25 Brigadës 162 dhe në territorin e komanduar nga Zona Operative

1 e Nerodimës dhe në Brigadën 161, unë kam qenë ende në
2 Shqipëri. Duhet thënë dhe pa hyrë në Kosovë dhe realisht nuk e
3 kujtoj, do të thotë, nuk mund ta potencoj qartë se çka vërtetë
4 ka pasur në atë periudhë.

5 PY. Ju vetë a jeni plagosur në ndonjë kohë në vitin 1999, ka
6 ndodhë që të jeni plagosur gjatë këtij viti?

7 PË. Kanë qenë plagë të lehta që nuk i kam trajtuar fort.

8 PY. Çfarë jua ka shkaktuar plagët?

9 PË. Ka qenë kryesisht nga copat e predhave të plumbave dum-
10 dum që i kam marrë në këmbë, në këmbën e djathtë.

11 PY. Ku keni qenë ju kur keni pësuar këto dëmtime ose këto
12 plagosje?

13 PË. Kam qenë bashkë me Fatmir Limën dhe vëllaun tim, Ramë
14 Bujën, në inspektim të vijës së frontit kur jemi sulmuar nga
15 forcat serbe vëllai im ka marrë plagë në kokë apo në pjesën e
16 përparme të kokës, unë i kam marrë plagë të lehta që nuk i kam
17 trajtuar në spital ushtarak. Vetëm m'i kanë shikuar mjekët dhe
18 më kanë këshilluar që t'i lidhi deri sa të grumbullohen këto
19 fragmentet të plumbave dum-dum. Ndërsa vëllai im është
20 trajtuar në spitalin ushtarak për plagët që ka marrë.

21 PY. Ju përmendët linjën e frontit. A mund të na e thoni
22 konkretisht se për cilin fshat bëhet fjalë ose në cilën zonë?

23 PË. Nëse nuk gabo, nëse s'e kam harruar tamam, ka qenë në
24 pjesën mes Reçakut dhe Petrovës, do të thotë, kanë qenë
25 bjeshkët të cilat kanë qenë para komandës së zonës e cila në

1 fund të luftës është vendosur në Petrovë.

2 PY. A ju kujtohet data kur jeni plagosur, kur jeni lënduar?

3 PË. Jo, nuk e kujtoj datën.

4 PY. Përveç Fatmir Limës dhe vëllait tuaj a ju kujtohet në
5 qoftë se ka qenë ndonjë person tjetër me ju kur keni qenë duke
6 inspektuar pozicionet dhe kur ka ndodhur ky sulmi?

7 PË. Nuk më kujtohet që ka pas ndonjë tjetër përveç ushtarëve
8 që kam pas në përcjellje unë drejtpërdrejt. Dhe në momentin e
9 plagosjes, do të thotë, kemi shpejtuar që sa më shpejt ta
10 përcjellmi anëtarin e Shtabit të Përgjithshëm për në spitalin
11 ushtarak e sepse kemi menduar që ka plagë tepër të rënda dhe
12 vdekjeprurëse. Po pas operimit mjekët na kanë njoftuar se nuk
13 ka fraksione të thyerjes së nofullës as të kokës dhe plumbi ka
14 depërtuar lehtë përmes gojës.

15 PY. Përmendët "transportin e anëtarit të Shtabit të
16 Përgjithshëm", a mund të na e thoni si quhej ky person?

17 PË. Edhe një herë të lutem?

18 PY. Përmendët që u siguruat që të transportonit anëtarin e
19 Shtabit të Përgjithshëm në spitalin ushtarak. A mund të na e
20 thoni si quhej ky person, kush ishte ky person ose këta
21 persona që keni shoqëruar ju?

22 PË. Po kanë qenë shoferi im Agim Buja, që ka qenë shofer
23 zyrtar i imi. Kanë qenë edhe truprojat e mia. Nëse nuk gaboj
24 ka qenë Naim Beka dhe -- jo Naim Beka, më falni, Lulzim Buja
25 dhe Azis Mustafa.

1 PY. A ju kujtohet ndonjë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të
2 UÇK-së që ka marrë pjesë në luftime në Zonën Operative të
3 Nerodimës?

4 PË. Jo, jo, nuk më kujtohen që kanë marrë pjesë
5 drejtpërdrejtë në luftime, po se kanë qenë në territorin e
6 luftës, do të thotë, kanë qenë në Dramjak dhe në Petrovë kur
7 kemi pas luftime shumë të ashpra.

8 PY. Ky rast ku u lënduat a ka ndodhur kjo në periudhën kur ka
9 qenë dhe një pjesë e Shtabit të Përgjithshëm në zonën tuaj, në
10 të periudhë jeni plagosë?

11 PË. Po, në periudhën kur kanë qenë anëtarë të Shtabit të
12 Përgjithshëm në pjesën ku kam komanduar unë.

13 PY. Sa kohë e keni pasur rolin e komandantit të Zonës
14 Operative të Nerodimës, për sa kohë?

15 PË. Prej momentit kur ka filluar organizimi në nënzona jam
16 emëruar komandant i nënzonës dhe gjatë transformimit të
17 komandës apo ristrukturimit të gjithë Ushtrisë Çlirimtare të
18 Kosovës, e kam marrë rolin e komandantit të zonës deri në fund
19 të luftës.

20 PY. Nga prilli deri në shtator të 1999, ku keni qenë i
21 vendosur?

22 PË. Në prill të 1999-s deri në qershor kur është bërë
23 marrëveshja e tërheqjes së forcave serbe me forcat
24 ndërkombëtare kam qenë në Mollopolc edhe Petrovë. Ndërsa pas
25 kësaj date, nëse nuk gaboj, 13 deri më 15 qershor jemi

1 transferuar në qytetin e Ferizajt.

2 PY. Të fokusohemi në periudhën prill-qershor kur keni qenë në
3 Mollopolc dhe Petrovë në 1999. Në këtë periudhë kohore çfarë
4 detyrash kishit ju?

5 PË. Po unë komandoja Zonën Operative të Nerodimës dhe ishte
6 normale që të konsolidoja sa më mirë shtabin e zonës për aq sa
7 kishim mundësi. Dhe të kujdesesha përmes shefit të shtabit të
8 zonës që të funksionojnë sektorët të cilët po ashtu kishin
9 shumë vështirësi për shkak se kishin pak mjete për këta
10 sektorë, kishim pak municion dhe kishim pak armatim. E ndërsa
11 për spitalin ushtarak duhej të kujdesej përgjegjësi i spitalit
12 ushtarak dhe shefi i sektorit të logjistikës, z. Fehmi
13 Hajrullahu. Dhe kujdesesha për brigadat që të funksionojnë si
14 duhet dhe në këtë periudhë kemi marrë edhe një urdhër nga
15 shefi i shtabit që brigadat të rriten në kuptimin e zgjerimit
16 të brigadave që Brigada 162 dhe 161 ta ndajmë në dy pjesë dhe
17 të formojmë dhe dy brigada. Pavarësisht se kapaciteti i
18 ushtarëve dhe i personelit ishte shumë i kufizuar, po për
19 shkaqe të ndikimit ma shumë propagandistik, ne bëmë edhe dy
20 brigada të reja. Një brigadë ka funksionuar mjaft mirë, do të
21 thotë, Brigada 164, ndërsa Brigada 163 ka qenë brigadë e cila
22 nuk ka arritur, nuk ka arritur që të funksionalizohet.

23 PY. A mund ta sqaroni emrin, kush, si e ka emrin ky personi
24 që thatë ju ishte shefi i shtabit që lëshoi urdhëresën për
25 zgjerimin e brigadave, mund të na e thoni emrin?

1 PË. Po në momentin kur është dhënë urdhri për mobilizim ka
2 qenë edhe urdhri që ne të zgjerohemi me struktura, do të
3 thotë, urdhri për mobilizim është dhënë nga shefi i shtabit,
4 nëse s'gabo, ka qenë ende Bislir Zyrapit.

5 PY. Po flasim për periudhën prill deri para 13, 15 qershorit.
6 A ju kujtohet më me saktësi kur e keni marrë këtë urdhër?

7 PË. Nuk e di saktë se kur është dhënë urdhri për mobilizim të
8 përgjithshëm, po periudha e fund prillit. E majit ka qenë
9 periudha kur ne jemi munduar të strukturojmë brigadat të cilat
10 mendonim se do të funksionalizohen. Brigada 161 të jetë në dy
11 pjesë. Të jetë dhe Brigada e formime 163. Dhe Brigada 162 të
12 formohet dhe Brigada 164. Brigada 164 ka arritur të
13 funksionalizohet deri diku. Ndërsa brigada 163 nuk ka arritur
14 të funksionalizohet deri në përfundim të luftës.

15 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem të vendosim në ekran
16 materialin me numër 943900-044239 bashkë me përkthimin në
17 anglisht që ka të njëjtin numër thjesht përfundon me ET dhe
18 duhet të shohim faqen që përfundon me numrin 044181.

19 PY. Dëshmitar, që të kuptoni kontekstin do t'ju tregoj një
20 faqe të një libri tjetër të Hajrush Kurtaj, jo libri që pamë
21 më përpara. Ballinën e keni në ekran aktualisht. Do të shohim
22 një faqe të këtij libri.

23 Dëshmitar, në të majtë të ekranit mund ta shihni
24 dokumentin në shqip. Dhe do të vendosim dhe anglishten.

25 Z. PACE: [Përkthim] Anglishtja në fakt e ka numrin 04 --

1 se e kisha dhënë gabim numrin, më falni. E ka numrin 044174-
2 044186-ET. Faleminderit.

3 PY. Dëshmitar, pra, thamë që është një faqe e një libri të
4 Hajrush Kurtaj, jo ai libri që pamë më përpara.

5 Z. PACE: [Përkthim] E zvogëlojmë pak, ose shkojmë më
6 poshtë që të shihni nënshkrimin, tani dua shikojmë dhe kryen e
7 faqes. Po, kështu. Ju lutem të njëjtën gjë edhe për
8 anglishten.

9 PY. Dëshmitar, dokumenti në shqip në të majtë të ekranit
10 tuaj, e njihni?

11 PË. Më duket se po.

12 Z. PACE: [Përkthim] E zmadhojmë pak nënshkrimin ju lutem.

13 PY. Dëshmitar, a është ky nënshkrimi juaj?

14 PË. Po, nënshkrimi im është.

15 PY. Shkojmë prapë sipër ju lutem dhe shohim që këtu thotë
16 është Zona Operative e Nerodimës, 27 maj 1999, ju thatë që
17 është nënshkrimi juaj dhe e shikojmë që lënda është urdhëresë
18 për plotësimin e formacionit. A ju kujtohet të keni lëshuar
19 një urdhëresë në këtë periudhë, pra, më konkretisht më 27 maj
20 1999?

21 PË. Nuk po më kujtohet si urdhëresë. Po e thashë edhe më
22 herët, që ne në atë kohë jemi marrë me strukturimin dhe
23 plotësimin e strukturës e cila ishte e përshtatshme për atë
24 kohë, në kohë të luftës. Dhe kemi pas edhe batalionin gardist
25 të organizohej dhe sipas kësaj urdhërese që po e shoh, do të

1 thotë, është urdhëruar Brigada 162 që të na përcjellë 30
2 ushtarë për ta plotësuar batalionin gardist, do të thotë duket
3 se është dokument autentik.

4 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.
5 PY. Pak më përpara ju përmendët faktin që pas datës 13 ose 15
6 qershor jeni larguar nga Mollopolci ose Petrova për të shkuar
7 në Ferizaj. Tani, në atë periudhë kohore në qershor të 1999,
8 në cilën pjesë të Ferizajt shkuat ju?

9 PË. Pas qershorit, pas 15 qershorit të 1999-s, unë, po, jam
10 vendosur në një lagje të Ferizajt e cila ka qenë në rrugën e
11 Nerodimës.

12 PY. Cila ishte arsyeja e largimit tuaj nga Mollopolci dhe
13 Petrova për të shkuar në këtë lagje të Ferizajt?

14 PË. Po realisht ne kishim detyra që të çlirojmë qytetin e
15 Ferizajt nga forcat ushtarake dhe policore serbe, të
16 kujdeseshim që të mos na helmojë ujti i cili ishte me
17 rezervuar në Pleshinë dhe të fillojmë të vendosemi në qytetin
18 e çliruar të Ferizajt.

19 PY. Kush ua komunikoi këto detyra në atë kohë?

20 PË. Realisht unë kam urdhëruar njësitet e Zonës Operative të
21 Nerodimës, Brigadën 162 dhe 161, që të fillojnë operacionet e
22 lëshimit nëpër qytete që të marrin nën kontroll qytete të
23 cilat duhet të çliroheshin dhe t'i jepet mundësia popullatës
24 civile - e cila ishte larguar nga Kosova shumica e tyre e
25 ishin vendosur në Maqedoni - dhe të fillonim të përgatiteshim

1 për t'i pritur civilët, të cilët, ne e dinim se ata nuk do të
2 presin parapërgatitjet të organizatave ndërkombëtare, po do të
3 vërshojnë nëpër shtëpitë e tyre të cilat ishin shumica të
4 djegura.

5 Dhe ne kemi filluar e jemi lëshuar nëpër qytete me
6 urdhrin tim që të marrim nën kontroll qytetet në mënyrë që të
7 presim qytetarët të cilët do të hyjnë në Kosovë.

8 PY. Në këtë periudhë kohore, siç thoni ju, nga 13, 15
9 qershor i 1999, njësitet tuaja a kanë pasur ndonjë luftim me
10 forcat serbe?

11 PË. Po, kanë pasur luftime dhe pse forcat serbe veç e filluan
12 tërheqjen. Ka pas luftime brenda në qytet, ku ka qenë njësiti,
13 njësiti special i vendosur. Dhe intensiteti i luftimeve pas 10
14 qershorit ka rënë bukur, bukur shumë. Ndërsa në territorin ku
15 ishim ende, deri më 15 qershor nuk ka pas luftime.

16 PY. A e kuptova drejt, thatë nuk ka pasur luftime deri më 15
17 qershor?

18 PË. Thashë ka pas intensitet të ulët të luftimeve, por në
19 pjesën e territorit ku kemi qenë të vendosun në Mollopolc,
20 Petrovë nuk ka pasur luftime.

21 PY. Po pas 15 qershorit a ndryshoi situata?

22 PË. Po, ndryshoi situata. Sigurisht, nuk ka pasur luftime.
23 Kemi filluar me i përcjellë pjesën më të madhe të plagosurve
24 sepse kishim bukur shumë të plagosur në spitalin ushtarak. I
25 kemi përcjellë dhe jemi vendosur në spitalin në qendrën e

1 mjekësisë familjare në atë kohë në Ferizaj, i cili, me urdhër
2 timin, është shndërruar në spital ushtarak dhe kanë filluar,
3 do të thotë, t'i trajtojnë mjekët, të cilët edhe filluan të
4 ktheheshin nga Maqedonia dhe një pjesë e mjekëve të cilët veç
5 ishin në qytet. Dhe kemi filluar të funksionalizojmë përmes
6 drejtorive civile, të funksionalizojmë disa fusha jetike për
7 qytetarët të cilët po ktheheshin siç ishte ujësjellësi, ma
8 vonë është funksionalizuar edhe postë telekomi dhe me i ruajt
9 objektet të cilat ishin bukur me peshë në Ferizaj dhe në
10 Kaçanik.

11 Z. PACE: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë në
12 ekran materialin me numër P00526.

13 PY. Këtë dokument e kemi vetëm në anglisht, Dëshmitar, por un
14 do ta lexoj tekstin dhe mund ta merrni përmes përkthimit. Ju
15 mund ta shihni vetë që është një artikull i BBC-së, datën e ka
16 12 qershor 1999 dhe teksti është si në vijim:

17 "Testi i raportit nga agjencia e lajmeve KosovaPress për
18 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

19 "Shtime ... 11 qershor: Përvjetori i 121 i Lidhjes së
20 Prizrenit u festua nga një program kulturor dhe artistik i
21 organizuar nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës ... Ushtria
22 Çlirimtare e Kosovës ... në Zonën Operative të Nerodimës.

23 "Përpara programit, oficerët, ushtarët dhe qytetarët e
24 kësaj zone operative të UÇK-së i bënë homazhe varrezave të
25 Mollopolcit të ushtarëve që ishin vrarë gjatë 17 muajve të

1 fundit në këtë zonë operative nga Gryka e Kaçanikut e deri në
2 Grykë e Caralevës ... të cilët sakrifikuan jetën e tyre në
3 luftimet me armikun serb për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

4 "Shukri Buja, komandanti i Zonës Operative të Nerodimës
5 së UÇK-së tha: 'Do të luftojmë deri në lirinë e plotë të
6 Kosovës.' Kadri Veseli, shefi i shërbimit informativ të UÇK-së
7 mbajti po ashtu një fjalë. Po ashtu edhe Agim Çeku, shefi i
8 Shtabit të Përgjithshëm përcolli një mesazh të tij.

9 "Burimi: Agjencia e lajmeve Kosovapress në shqip 11
10 qershor 1999."

11 Dëshmitar, a ju kujtohet ngjarja që është përshkruar në
12 këtë artikull?

13 PË. Ky artikull nuk më kujtohet, po ngjarja si ngjarje më
14 kujtohet.

15 PY. A mbani mend që keni mbajtur një fjalë ju, në këtë rast
16 siç thuhet kështu?

17 PË. Po, kemi mbajtur një manifestim më 10 qershor, o 11, në
18 përvjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ku ka pas pak
19 popullatë, ajo popullatë që kishte mbetur në këto terrene e
20 ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që kanë përformuar,
21 grupin muzikor dhe kemi qenë dhe eprorët e zonës dhe bashkë me
22 ne edhe një pjesë e anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm.

23 PY. Thatë që ka pasur anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm. Në
24 artikull përmendet Kadri Veseli dhe Agim Çeku, të kujtohet dhe
25 ty të kenë qenë këta?

1 PË. Kadri Veseli ka qenë prezent, ndërsa Agim Çeku sipas

2 kësaj ka çu telegram për ta përshëndetur këtë tubim.

3 PY. Ju kërkoj ndjesë, e thashë unë gabim për Agim Çekun. Po,

4 këtu thotë që Kadri Veseli ka mbajtur një fjalë. Mesa kujtoni

5 ju ka folur Kadri Veseli para ose pas jush në këtë rast?

6 PË. Nuk më kujtohet.

7 PY. Por ama të kujtohet që ka qenë i pranishëm?

8 PË. Ka qenë i pranishëm dhe besoj që dhe e ka mbajtur një fjalë

9 rasti, po a ka fol para meje apo pas meje nuk e di.

10 PY. Mund ta heqim dokumentin nga ekрани.

11 PY. Dëshmitar, a njihni një komandant të UÇK-së i cili njihej

12 ose të tjerët i drejtoheshin si Dula, Dula?

13 PË. Ose s'po e kuptoj ose nuk e njoh.

14 PY. Ka pasur, atëherë ka pasur ndonjë në UÇK që mund të ketë

15 pasur ndonjë nofkë që ngjason me këtë Dulën?

16 PË. Nuk po më kujtohet që ka pas.

17 PY. Dulla. Po një person me emrin Abdulla Rama?

18 PË. Jo, s'po më kujtohet.

19 PY. Po ndonjë vend Guri i Bagdashit?

20 PË. Po, Guri i Bagdashit ka qenë në pjesën mbi Reçak, do të

21 thotë, është një pozicion i cili ka qenë një bjeshkë dhe ka

22 atë që është i identifikum me emrin Guri i Bagdashit. Kështu e

23 kanë quajtur në terren aty.

24 PY. Ka qenë në zonën e përgjegjësisë së Nerodimës?

25 PË. Po, Guri i Bagdashit mbi Reçak, Reçaku komplet e Petrova

1 kanë qenë në Zonën Operative të Nerodimës

2 PY. Cila brigadë ka qenë atje?

3 PË. Ka qenë Brigada 162 -- më falni, 161 e Ahmet Kaçiku.

4 Z. PACE: [Përkthim] Do lutesha të shfaqej në ekran
5 materiali me numrin U001-1533-U001-1533. Përbri edhe materiali
6 në anglisht që ka të njëjtin numër ERN thjesht përfundon me -
7 ET *Revised*.

8 PY. Dëshmitar, në të majtë është një dokument me shkrim dore
9 në shqip, në të djathtë është përkthimi në anglisht. Duke e
10 parë këtë dokument kështu në pamje të parë a e njihni?

11 PË. Jo.

12 Z. PACE: [Përkthim] Zmadhojmë nënshkrimin tek shqipja, ju
13 lutem.

14 PY. Mos e njihni këtë nënshkrim?

15 PË. Jo, nuk e njoh.

16 Z. PACE: [Përkthim] Zvogëloheni sërish materialin.

17 PY. Dëshmitar, ky dokument është i Zonës Operative të
18 Nerodimës, Brigada 161, Batalioni 2, datë 29 prill 1999 edhe
19 përmendet dhe Petrova këtu. Dhe thotë, do ju lexoj vetëm
20 pjesën e parë:

21 "Raport Ditor

22 "- Nga ora 4.00 e mëngjesit ushtarët e Batalionit të Dytë
23 ishin në pozicion.

24 "- Pasi u larguan nga Guri i Bagdashit ... në orën 4.00
25 të mëngjesit u kthyen sërish në pozicionet e tyre.

1 "- Komandant Dulla urdhëroi që të dilnin në orën 12.00 të
2 drekës - më falni - në orën 12.00 që të ruanin Gurin e
3 Bagdashit, por kompania e Rancës dhe Reçakut ishin vonë. Në
4 mëngjes, u krye një sulm nga afër në Kershinat ... dhe pas
5 përdorimit të armëve 12.7 ... shkijet, serbët ... u detyruan
6 të largoheshin nga Guri i Bagdashit.

7 "- Komandant Dulla u takua me komandant Sokolin dhe
8 komandant Dulla e informoi për gjendjen e batalionit."

9 Dëshmitar, a ju kujtohet që të keni qenë ju ose a jeni ju
10 ky komandant Sokoli më saktë që përendeni në këtë dokument?

11 PË. Në fakt nuk e di se në atë kohë nuk kam pas pseudonim,
12 kam qenë me emër e mbiemër, komandant i zonës Shukri Buja. Dhe
13 këtu është paksa jo logjike kjo.

14 PY. Përpara nënshkrimit është ky tekst:

15 "Ne kërkojmë ushtarin Paquku të vijë, i kërkojmë ushtarit
16 Paquku të vijë të raportoi në brigadë sepse ai nuk po sillet
17 mirë si ushtar dhe policia, PU-ja më saktë, u informua për
18 sjelljen e tij."

19 A keni njohur ndonjë ushtar me emrin Paquku?

20 PË. Ju lutem, kjo është një dokument në qoftë se është
21 dokument i batalionit dhe është raportuar, nuk është raportuar
22 tek komanda e zonës, po është dorëzuar si raport te komandanti
23 i brigadës. Do të thotë, nuk kam muj me e pa as me pas unë
24 sepse batalionit i kanë raportu komandantët e brigadës.

25 PY. Keni pasur dijeni që të ketë pasur situata si kjo që po

1 shohim këtu, që më konkretisht, që një ushtari i kërkoi të
2 shkonte të raportonte në brigadë se nuk kishte sjellje të
3 hijshme si ushtar?
4 PË. Ka mundur të ketë sjellje jo të mira të ushtarëve dhe
5 normalisht që e kanë sugjeruar që të shkojë të raportojë në
6 brigadë dhe të paraqitet në brigadë për sjelljet e tij. Po si
7 rast, do të thotë, nuk më kujtohen, apo ku rast nuk më
8 kujtohet.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace,
10 vajti ora për ta përfunduar sot.

11 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin nga ekrani
12 dhe po përfundoj pyetjet për sot.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
14 përfunduat për sot do të duhet të voni sërish nesër në orën
15 9.00. Mos flisni me askënd për dëshminë tuaj jashtë sallës së
16 gjyqit.

17 Ju urojmë një pasdite të këndshme. Shihemi nesër.

18 DËSHMITARI: Faleminderit.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z. Pace.

21 Z. PACE: [Përkthim] Një përditësim sa i takon pyetjeve
22 mbasi ju ndihmon. Besoj se do të përfundoj brenda seancës së
23 parë nesër, mbase dhe brenda orës së parë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 Ka diçka tjetër.

1 Në rregull. Shihemi nesër në ora 9,00.

2 --- Seanca mbyllet në orën 16.31

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25